



FONDAZIONE SANTAGATA
per l'ECONOMIA della CULTURA

ArtCloudNetwork
international

(DRAFT) PLANI I MENAXHIMITTË ISH BURGUT TË SPAÇIT

Nëntor 2023

Ky dokument u përgatit nga

Fondazione Santagata per l'Economia della Cultura

Corso Duca degli Abruzzi 43, 10129, Torino

Web: www.fondazionesantagata.it

Në bashkëpunim me

ArtCloud Network International

Via Arbia, 5, 00199 Roma RM

Web: <https://artcloudnetworkinternational.com/>

Përbërja e ekipit

Paola Borrione, Drejtuese e Konsorciumit dhe Eksperte e Planifikimit të Biznesit

Alessandro Bianchi, Drejtues Ekipi

Odhise Zoto, Koordinator Projekti

Giulia Avanza, Eksperte për përvojën e vizitorëve dhe zhvillimin e zonës

Anisa Rrumbullaku, Eksperte Ligjore

Artan Puto, Specialist mbështetës

Federica Comes, Specialiste mbështetëse

Etlea Demollari, Specialiste mbështetëse

Afrida Domnori, Specialiste mbështetëse

Martina De Gennaro, Mbështetëse me shqyrtimin e dokumentacionit

Ekipi dëshiron të falënderojë të gjithë palët e interesuara që ndanë bujarisht njohuritë e tyre duke marrë pjesë në takimet konsultative.

Imazhi i kopertinës u realizua nga artistja Ina Elezi dhe Kujto.al

PËRMBLEDHJE

1. Përmbledhje ekzekutive	4
2. Hyrje	7
3. Përshkrimi i pasurisë kulturore	10
4. Vlerësimi i vlerës së pronës	20
5. Aspekte të tjera lidhur me pronën	31
6. Vizioni dhe objektivat	33
7. Administrimi i pasurisë kulturore të paluajtshme	46
8. Plani i veprimit	51
9. Zbatimi dhe monitorimi	67
10. Anekset:	80
Aneksi A: Informacioni dhe të dhënat kartografike të ndërtesave	80
Aneksi B: Vlerësimi i opsioneve të skenarëve të menaxhimit	84
Aneksi C: Evidenca nga konsultimet me grupet e interesit.	102
Aneksi D: Skenarët e analizuar të memorializimit	111
Aneksi E: Udhërrëfyese i konservimit	117
Aneksi F: Vlerësimi i veprimeve të propozuara në “Unlocking Dialogue & Action. A concept for Spaç Prison”	129
Aneksi G: Plani i biznesit	139
Aneksi H: Analiza krahasuese.	154
Aneksi I: Certifikata e pronësisë	169

I. Përmbledhje ekzekutive

Ish-burgu dhe kampi i punës së detyruar i Spaçit është vendi më simbolik i kujtesës së mizorisë së regjimit komunist në Shqipëri dhe të akteve të shumta të rezistencës së qytetarëve shqiptarë. Ndonëse është më i paprekuri ndër ish-njësitë ekzistuese të riedukimit dhe i vetmi që mbrohet si monument kulture, ai ndodhet në një gjendje alarmante degradimi që mund ta bëjë të pamundur ruajtjen e këtij kujtimi të vështirë dhe kërkon zbatimin urgjent të masave të shtuara të ruajtjes.

Vende të ndryshme që kanë përjetuar regjime autoritare po merren me trashëgiminë materiale të të kaluarës së tyre të vështirë dhe nismat për të shndërruar ish-burgjet në muze, memorialë apo qendra kulturore po rezultojnë të frytshme për shoqërinë civile dhe institucionet për të kuptuar, përpunuar dhe përballur me të kaluarën që kjo lloj trashëgimie përfaqëson. Një rast emblematic që kohët e fundit ka tërhequr vëmendjen ndërkombëtare është ai i Muzeut dhe Sitit të Kujtesës ESMA, në Buenos Aires, një ish-qendër klandestine e ndalimit, torturës dhe shfarosjes që në vitin 2004 u shndërrua në një hapësirë për kujtesën dhe të drejtat e njeriut dhe në vitin 2023 u shpall si një vend i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Duke pasur parasysh rëndësinë e tij të jashtëzakonshme, ka ardhur koha që Spaçi t'u kthehet qytetarëve shqiptarë dhe ky dokument do të paraqesë planin e menaxhimit, zbatimin e të cilit do të mundësojë ndryshimin dhe realizimin e vizionit për të ardhmen e Spaçit.

Mbi të gjitha, plani i menaxhimit, është konceptuar pas një analize të detajuar të pasurisë kulturore, të vlerave dhe statusit të saj të ruajtjes, si dhe pas një raundi konsultimesh me grupet e interesit që përfshinin më shumë se 50 individë: ish të burgosur politikë; profesionistë të institucioneve të ruajtjes së kujtesës, advokimit dhe kërkimit në Shqipëri; drejtorë të muzeve dhe zonave muzeale brenda dhe jashtë vendit, përfaqësues dhe anëtarë të komunitetit të Mirditës, artistë dhe profesionistë të kulturës, mësues e profesorë historie.

Pronësia e pasurisë kulturore - monument kulture e Kategorisë II - t'i kalojë Ministrisë së Kulturës, si institucioni publik më legjitim dhe më i aftë që mund të përmbushë pritshmërinë e menaxhimit aktiv të Spaçit për ta bërë atë pjesë aktive të trashëgimisë kulturore të kombit, të ruajtur me kujdes si dëshmi e një të shkuare të vështirë.

Pas shqyrtimit të hollësishëm të skenarëve të mundshëm të menaxhimit, doli se modeli i menaxhimit që përshtatet më mirë në aspektin e qëndrueshmërisë dhe funksionalitetit është ai i një Fondacioni të krijuar nga një institucion i specializuar për trashëgiminë kulturore, pra që mund

të jetë Fondacioni për kujtesën e rezistencës në Spaç. Organi themelues do të jetë vetë Ministria e Kulturës. Menaxhimi i pasurisë kulturore do t'i transferohet fondacionit të krijuar për këtë qëllim, i cili do të administrojë, ruajë, mbrojë pasurinë, rregullojë aksesin dhe shërbimet për publikun dhe promovojë pasuritë kulturore dhe veprimtaritë studimore dhe kërkimore sipas ligjit. Në faqet në vijim vëmendja jonë do të rikthehet te ish-burgu dhe kampi i punës i Spaçit (i referuar shkurtimisht edhe si Spaç ose Siti), duke pasur parasysh se zona e mbrojtur sipas urdhrit nr. 241, 23/06/2015, përbëhet nga 3 zonat kryesore të ndërtesave të kompleksit të burgut, si dhe komponenti më i gjerë i peizazhit, që përfshin galeritë e minierave, elementë thelbësorë për të mundësuar një kuptim të plotë të vlerave të Zonës muzeale.

Përmes përafrimit me *Objektivin specifik 2 – Rehabilitimi i trashëgimisë arkitekturore dhe peizazhit duke rritur numrin e monumenteve të rehabilituara* i Strategjisë Kombëtare të Kulturës, si dhe kontribimit në *Objektivin specifik 3 – Ndërkombëtarizimi i vlerave të artit dhe trashëgimisë kulturore* dhe *Objektivin specifik 5 – Edukimi përmes kulturës*, vizioni është që Spaçi të vazhdojë të jetë një vend i kujtesës dhe reflektimit personal dhe kolektiv. Qëllimi në lidhje me ndërtesat e ish-burgut është ruajtja e tyre në gjendjen aktuale, duke ndalur përkeqësimin e shpejtë të tyre, duke i ruajtur ato në mënyrë të tillë që të dëshmojnë këto tre dekada në të cilat shoqëria shqiptare është përpjekur të pajtohet me historinë e saj të fundit dhe të dhimbshme, në të cilën shenjat e kalimit të kohës mbi ndërtesa janë gjithashtu një metaforë për një distancim nga kujtesa e vendit, ose rrezik për humbje të kësaj kujtese. Detaje të mëtejshme mbi ndërhyrjet e sugjeruara të ruajtjes, rikrijimin e mundshëm të elementëve kyç, rikuperimin e shtigjeve dhe hyrjeve në tunelin e minierave dhe strategjitë e interpretimit të trashëgimisë kulturore do të paraqiten në dokument.

Fondacioni përgjegjës për menaxhimin indirekt të Spaçit do të ndërmarrë gjithashtu procedurat e nevojshme për ngritjen e Muzeut të Burgut dhe Kampit të Punës së Detyrueshme, një muze autonom i specializuar me person juridik privat dedikuar rezistencës ndaj diktaturës komuniste. Fokusi i muzeut do të jetë në përpjekjet dhe historitë e rezistencës që kanë ndodhur në Spaç, që nga episodi themelor i Revoltës së Spaçit në 1973, deri te aktet dhe gjestet e shumta të përditshme të rezistencës kundër humbjes së njerëzimit, dinjitetit dhe solidariteti që iu imponua të burgosurve. Vendndodhja gjeografike e Muzeut është parashikuar në Bashkinë Mirditë, në Reps, në afërsi të daljes së autostradës kombëtare dhe në një pozicion të saktë që ende nuk është përcaktuar. Vendndodhja është rezultat i vlerësimeve që kanë marrë parasysh mundësinë e tërheqjes së vizitorëve, rritjen e qëndrueshmërisë financiare të muzeut të ardhshëm dhe respektimin e autenticitetit dhe integritetit të zonës muzeale. Informacione të mëtejshme mbi koleksionin e parashikuar të Muzeut, mbi hapat

e nevojshëm për krijimin e tij dhe mbi strategjinë specifike të funksionimit do të paraqiten në dokument.

Edhe pse në Kapitullin 6 do të trajtohen në dy paragrafë të ndryshëm vizionet për zonën muzeale dhe për Muzeun e ardhshëm, arseja lidhet vetëm me afatet e ndryshme kohore dhe metodat e zbatimit. Të dy vendet duhet të shihen si komponentë të një bërthame të menaxhuar nga të njëjtat organizata, duke ofruar mundësi për kujtesë, reflektim dhe mësim, dhe përvoja të vizitorëve që plotësojnë dhe pasurojnë njëra-tjetrën.

Fondacioni - i pari në Shqipëri që do të krijohet nga një institucion i specializuar për trashëgiminë kulturore - do organizohet në tre nivele drejtimi (një Bord Administrimi, një Bord Nderi dhe një Bord Shkencor) dhe do të nënshkruajë një marrëveshje bashkëpunimi të vazhdueshëm me Bashkinë Mirditë, për të siguruar bashkëpunimin e ndërsjellë dhe menaxhimin e integruar të trashëgimisë kulturore për zhvillimin e territorit. Financimi i Fondacionit do të sigurohet nga mbështetja nga buxheti publik, si dhe nga fonde të tjera kombëtare apo ndërkombëtare, publike apo private.



Për të arritur këtë vizion ambicioz, plani i menaxhimit parashikon zbatimin e aktiviteteve për ndjekjen e tre objektivave të qarta gjatë një harku pesë vjeçar, ku secila prej tyre lidhet ngushtësisht me një fazë kohore dhe lejon të bëhet një hap specifik përpara drejt arritjes së funksionimit të plotë dhe Spaçit.

Plani i menaxhimit do të detajojë grupin e veprimeve për arritjen e këtyre tre objektiva, si dhe një plan biznesi për të ilustruar kostot dhe të ardhurat e pritshme. Përmbledhja e plotë e dokumentit do të paraqitet në kapitullin vijues.

2. Hyrje

A. Nevoja për një plan menaxhimi

Përgatitja e këtij plani menaxhimi bëhet në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit 08/11/2018, Prot. 8400 ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe CHwB Albania dhe synohet t'i ofrojë Ministrisë së Kulturës elemente të dobishme për të vlerësuar qëndrimin e saj në lidhje me propozimin e marrë për transferimin e të drejtave të menaxhimit dhe pronësisë së ish-burgut dhe kampit të punës të Spaçit.

Gjithashtu, ky plan menaxhimi synon të adresojë thirrjet dhe kërkesat për përkushtim ndaj kujtimit të Spaçit që janë shprehur në më shumë se tre dekada që nga fundi i diktaturës komuniste në Shqipëri, nga individë - kryesisht ish të burgosurit politikë dhe familjet e tyre, shoqëria civile dhe grupet fetare, organizatat dhe institucionet. Shpeshherë në debatin publik është deklaruar se Spaçi paraqet rastin e fundit për të nderuar kujtimin e atyre që humbën lirinë, ndonjëherë edhe jetën, në sistemin e burgjeve dhe të punës së detyruar të ngritur nga regjimi komunist: më e paprekura ndër ish repartet ekzistuese të riedukimit (duke përjashtuar ato burgje, si Tirana apo Burrel, të cilat janë ende sot në përdorim), e vetmja që mbrohet si monument kulture, e megjithatë ndodhet në një gjendje shqetësuese degradimi që komprometon mundësinë e transmetimit të kësaj kujtese të vështirë, nëse nuk zbatohen urgjentisht masa të mirëfillta për ruajtjen e saj. Ashtu siç kanë bërë edhe shtete e vende të tjera, ka ardhur koha që edhe Spaçi t'u kthehet qytetarëve shqiptarë si dëshmi dhe vend emblematic i një momenti të vështirë historik. Në hartimin e këtij dokumenti janë marrë në konsideratë të gjitha këto çështje dhe pyetje, dhe vizioni, objektivat dhe veprimet e paraqitura këtu janë një përpjekje e saktë për t'i adresuar ato me përgjegjësi morale, profesionalizëm dhe përkushtim serioz.

B. Kuadri ligjor

Konteksti i përgatitjes për këtë plan menaxhimi përbëhet nga një sërë aktesh legislative dhe dokumentesh strategjike. Referenca kryesore është Ligji Nr. 27/2018 *Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë* dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij në lidhje me menaxhimin e trashëgimisë kulturore dhe planifikimin e biznesit, në veçanti Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 169, datë

20.2.2020 “Për shtrirjen, strukturën, përmbajtjen, metodologjinë e përgatitjes dhe procedurën e diskutimit publik të planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme”. Përmbajtja, metodologjia dhe procedurat e pasqyruara në planet e menaxhimit të përgatitura dhe të miratuara deri më tani në vend, kanë përcaktuar rrugën dhe kanë ofruar një referencë të dobishme. Objektivat dhe veprimet e paraqitura në këtë plan menaxhimi u zhvilluan në përputhje me dokumentet kryesore strategjike me interes për sektorin, konkretisht Strategjinë Kombëtare të Kulturës 2019-2025 dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023.

C. Metodologjia e përgatitjes

Paragrafët që vijojnë paraqesin planin e menaxhimit të pasurisë kulturore duke ndjekur me vëmendje udhëzimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 169, datë 20.2.2020, “Për shtrirjen, strukturën, përmbajtjen, metodologjinë e përgatitjes dhe procedurën e diskutimit publik të planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme”.

Metodologjia e përgatitjes ka përfshirë:

- Një shqyrtim të thelluar të legjislacionit përkatës;
- Analizën e pasurisë kulturore, nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit të mëparshëm, vizitave në terren dhe anketimeve, të paraqitura në Kapitullin 3 dhe në Aneksin A;
- Vlerësimin e vlerave pronës, një hartë të grupeve të interesit dhe identifikimin e iniciativave kryesore që demonstrojnë këto vlera, të paraqitura në Kapitullin 4;
- Studimi i kontekstit socio-ekonomik ku ndodhet prona, duke analizuar të dhënat ekonomike, ofertën turistike dhe infrastrukturën lokale, të paraqitur në kapitullin 5;
- Një analizë e standardeve ndërkombëtare krahasuese, për të cilën flitet më shumë në paragrafin vijues dhe në aneksin H;
- Përpunimi i një strategjie të angazhimit të grupeve të interesit, që ka parashikuar konsultime në grup, takime individuale, intervista të thelluara dhe organizimin e një raundi të parë konsultimesh të kryera me synimin për të dëgjuar dhe gjetur një sintezë të përbashkët midis diversitetit të pikëpamjeve, ndjeshmërisë dhe ekspertizës që mund të dëshmohen rreth Spaçit, të paraqitura në Aneksin C;
- Zhvillimi i një vizioni për të ardhmen e Spaçit, si sintezë e këndvështrimeve, ndjeshmërive dhe ekspertizës së shumëllojshme – dhe herë-herë disonante – që mund të dëshmohen rreth Spaçit, paraqitur në Kapitullin 6;

- Propozimi i një kuadri pronësor dhe administrativ, që pasqyron në mënyrë solide strategjinë më efektive dhe të qëndrueshme për të realizuar vizionin për të ardhmen e Spaçit dhe i bazuar në krahasimin solid të skenarëve të mundshëm të menaxhimit, të paraqitur në *Aneksin B: Vlerësimi i opsioneve të skenarëve të menaxhimit* dhe në kapitullin 7;
- Përgatitja e një udhërrëfyese konservimi bazuar në sondazhet në terren dhe analizën e dokumentacionit të ndërhyrjeve të mëparshme, të paraqitur në Aneksin E;
- Artikulimi i një plani veprimi, i paraqitur në Kapitullin 8, dhe përvijimi i ardhshëm i një strategjie zbatimi dhe monitorimi, që do të paraqitet në Kapitullin 9;
- Shtjellimi i një plani biznesi për kostot identifikuese dhe burimet e nevojshme të të ardhurave, financimin dhe investimet kapitale, duke u përpjekur të socializojë mundësitë dhe përfitimet socio-ekonomike midis palëve të interesuara, të paraqitura në Aneksin G.

D. Rastet e referencës

Ligji Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, ka zgjeruar qasjet e mundshme për menaxhimin e trashëgimisë kulturore në Shqipëri dhe sot muzetë dhe vendet arkeologjike funksionojnë përmes një sërë skenarësh të mundshëm menaxhimi. Ato janë vlerësuar përmes një analize krahasuese (*Aneksi B: Vlerësimi i opsioneve të skenarit të menaxhimit*) si të implikimeve teorike ashtu edhe të rasteve të zbatimit në arenën kombëtare dhe referenca të ngjashme në nivel ndërkombëtar.

Për momentin, në nivel evropian, ka një vëmendje të madhe për kontributin që trashëgimia kulturore mund të sjellë në pajtimin social dhe të mësuarit ndër breza. Si pjesë e procesit të hartimit të Axfordës së re Urbane për Bashkimin Evropian, një grup pune ekspertësh pjesë e Veprimit 10 të Partneritetit për Kulturën dhe Trashëgiminë Kulturore ka hetuar gjendjen e trashëgimisë disonante në qytetet më të vogla dhe zonat e thella në Evropë, duke adresuar çështjen se çfarë lloji vëmendjeje publike dhe mbështetjeje politike kërkojnë këto objekte të trashëgimisë për t'u ofruar qytetarëve një vend dhe mjete për t'u angazhuar në shqyrtimin kritik të së kaluarës, për të forcuar kohezionin demokratik dhe për të kontribuar në zhvillimin rajonal. Mësimet e nxjerra nga studimet e rasteve të paraqitura kanë qenë të dhëna të vlefshme për praktikatat e mira të transferueshme për Spaçin.

Përveç kësaj, u krye një analizë krahasuese e rasteve ndërkombëtare për të shqyrtuar se si në vende të tjera në mbarë botën u ndërmorën hapa për shndërrimin e ish-burgjeve në muze, memorialë ose qendra kulturore për të ruajtur kujtesën e ngjarjeve të së kaluarës duke promovuar ndërgjegjësimin për trashëgiminë historike si një element i zhvillimit kulturor dhe social. Janë

shqyrtuar rastet e mëposhtme ndërkombëtare: Muzeu Ndërkombëtar Patarei për Viktimat e Komunizmit, Estonia; Burgu kombëtar përkujtimor de Montluc, Francë; Burgu i Sighet, Rumania; Rivesaltes Camp Memorial, Francë; La Risiera di San Sabba, Itali; ESMA - Escuela Superior de Mecánica de la Armada, Argjentinë; Kilmainham Gaol, Irlandë; Robben Island, Afrika e Jugut; Auschwitz-Birkenau, Poloni; Tuol Sleng Genocide Museum, Kamboxhia; Hohenschönhausen Memorial, Gjermani.

Informacioni u mbledh nëpërmjet intervistave të thelluara me Drejtorët, në tre raste, dhe nëpërmjet analizës së dokumentacionit, për 7 raste të tjera dhe është paraqitur në *Aneksin H: Analiza krahasuese*. Me rëndësi të veçantë është rasti i Muzeut dhe Sitit të Kujtesës ESMA, në Buenos Aires, një ish-qendër klandestine e ndalimit, torturës dhe shfarosjes që në vitin 2004 u shndërrua në një hapësirë për kujtesën dhe të drejtat e njeriut dhe në vitin 2023 u shpall si një vend i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s.

3. Përshkrimi i pasurisë kulturore

A. Koordinatat gjeografike dhe të dhënat kartografike




Figura 1: Vendndodhja e sitit. Bashkia Mirditë, Shqipëria Veriore

Spaçi ndodhet në një zonë malore në jugperëndim të malit të Munellës, në Bashkinë Mirditë. Pllaja e kampit të parë me pamje nga lumi i vogël i Fanit është e aksesueshme nga dalja Reps e autostradës kombëtare.

B. Histori e shkurtër e Spaçit

Nga vitet 1930 deri në vitet 1960, siti ishte një minierë aktive për nxjerrjen e bakrit dhe piritit. Në prill të vitit 1968, Reparti i Riedukimit 303 i krijuar në vitin 1951 dhe e shfrytëzuar më parë si repart shëtitës pune për punime të ndryshme ndërtimi në Shqipëri, u vendos në Spaç, një zonë e largët që kombinonte funksionet e burgut dhe të kapit të punës së detyruar në minierë. Siti, i vendosur në një shpat me tarraca, ishte aq i largët saqë nuk nevojitej asnjë mur rrethues për të siguruar kompleksin, vetëm një gardh me tela me gjemba i ndërprerë aty-këtu nga poste roje dhe një portë kryesore.

Në momentin e hapjes, Reparti i Riedukimit 303 i Spaç-Mirditës priste vetëm të burgosur politikë, numri i të dënuarve luhatej ndër vite dhe deri në fillim të viteve 1980 varionte nga 900 deri në 1200 të dënuar.

Një nga ngjarjet kryesore në historinë e kampit dhe gjithashtu në historinë e rezistencës ndaj diktaturës komuniste në Shqipëri ishte Revolta e Spaçit. Përgjatë ditëve nga data 21 maj deri më 23 maj të vitit 1973, të burgosurit morën kontrollin e kampit, duke ngritur flamurin shqiptar të zhveshur nga ylli i tij komunist, duke brohoritur parulla antikomuniste në unison dhe duke brohoritur në favor të demokracisë perëndimore. Autoritetet e shtypën Revoltën, duke ekzekutuar krerët e saj – Pal Zefin, Skënder Dajën, Dervish Bejkon dhe Hajro Pashain, të cilët u pushkatuan dhe trupat e tyre janë ende të zhdukur edhe sot – dhe duke vendosur dënime të ashpra dhe vite të tjera burgimi për të burgosurit e tjerë. Kjo ngjarje e pozicionoi Spaçin si një vend rezistence në imaginatën kolektive të vendit.

Nga viti 1984 në Spaç u ndaluan edhe të burgosur të zakonshëm. Reparti i Riedukimit vazhdoi të funksiononte për të dënuarit politikë deri në vitin 1990, ndërsa pas qershorit 1990 dhe deri në korrik 1991 qëndruan aty të burgosurit e zakonshëm. Nga prilli i vitit 1991, ai u vu në dispozicion të Kompanisë së Nxjerrjes së Mineralit dhe fabrika ishte në përdorim deri në vitin 1995, kur u braktis plotësisht.

Që nga vitet 1990, Spaçi ka qenë në një gjendje degradimi dhe shkatërrimi dhe, megjithëse në mars të vitit 2009 u miratua një projekt për restaurimin e tij, ky ende nuk është zbatuar. Në vitin 2017 janë kryer disa ndërhyrje emergjente stabilizimi nga organizata e pavarur CHwB Albania, me mbështetjen financiare të Suedisë.

Në paragrafin e mëposhtëm jepet informacion i mëtejshëm në lidhje me klasifikimet dhe masat e mbrojtjes që siti ka gëzuar që nga viti 2007, ndërsa në paragrafin 5.E jepen hollësi të mëtejshme lidhur me lejen e shfrytëzimit të minierave të bakrit të Spaçit që i është dhënë një kompanie të huaj në vitin 2018.

C. Statusi ligjor dhe kuadri ligjor që mbron pronën




Figura 2: Hartë e përgatitur nga CHwB Albania, që tregon 3 zonat kryesore të kompleksit të burgut dhe zonën e mbrojtur (me vijë të kuqe) sipas urdhrit nr. 241, 23/06/2015

Pas një vlerësimi të zonës dhe të të gjitha dokumenteve përkatëse legjislative, një klasifikim i plotë sugjeron se është një pronë kulturore historike (ndërtesa, instalime dhe struktura të tjera që lidhen

me ngjarje dhe figura historike) me rëndësi kombëtare (përfshin vendet arkeologjike dhe vlera të tjera kulturore me rëndësi të jashtëzakonshme për kulturën dhe historinë e vendit).

Prona është komplekse (një larmi brenda një ansambli, elementët e të cilit janë të ndërlidhura funksionalisht) dhe vlerat e tyre kulturore përkufizohen si të rrezikuara (nën kërcënim real të dëmtimit, vandalizmit, shkatërrimit ose dëmtimit të rëndë të integritetit të tyre si rezultat i: i) përkeqësimit të shpejtë të substancës së tyre origjinale që çon në ndryshime thelbësore në strukturën e tyre; ii) përkeqësimit të shpejtë të mjedisit; iii)

humbjes vizuale të pamjes së tyre autentike.)

Në vitin 2007 Spaçi u shpall monument kulture i Kategorisë II (vendim nr. 656, datë 05.12.2007 i Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve) dhe nisën përpjekjet sensibilizuese me synimin për të mbrojtur zonën dhe për të ndalur shkatërrimin e tij. Në vitin 2015 (me urdhër nr. 241, datë 23.06.2015) u krijua zona e mbrojtur e monumentit, e cila përfshin të paktën 9 ndërtesa dhe 8 rrënojat e mbetura: godinat e burgut, ato të personelit të administratës së minierës dhe ato të punëtorëve të lirë. Sipërfaqja e zonës së mbrojtur është rreth 140 000 m².

D. Përshkrimi dhe veçoritë e sitit

Burgu i Spaçit dhe ndërtesat që janë pjesë e kompleksit, ndodhen në anën perëndimore të luginës së thepisur të lumit të Fanit të Vogël. Është një kompleks i përbërë nga ndërtesa dhe struktura në gjendje të ndryshme degradimi për shkak të faktorëve njerëzorë dhe natyrorë. Zona e rrethuar e ish-burgut, e cila përfshinte edhe galeritë e minierave, është e paqartë për shkak të mungesës së provave në terren dhe mungesës së informacionit arkivor. Informacionet e pakta që gjenden dhe dëshmitë e ish të burgosurve tregojnë se kompleksi i burgut ishte i ndarë në 3 zona kryesore: 1) Zona që i përket punimeve minerare, duke përfshirë galeritë ku kryhej puna e detyruar; 2) Zona e burgut duke përfshirë konviktet, infermierinë, mensën, komandën ushtarake dhe ndërtesat e tjera të kontrollit; dhe 3) zona e administratës minerare ku ishin akomoduar edhe punëtorët e lirë.



Figura 3: Harta ortofoto e zonës ku ndodhen 2 grupet e ndërtesave, e përgatitur nga CHwB Albania. Zona e burgut në të majtë (3 deri në 6a), zona e administratës në të djathtë (1 dhe 2)

Ndërtesat janë të vendosura në 2 grupe, në një distancë prej rreth 150 metrash. Ato ndodhen midis rrugës që i lidh dhe kalon në mes të kampit dhe rrugës lokale poshtë luginës. Rruga që lidh grupet e ndërtesave ka një gjerësi nga 5-7 metra, është e paasfaltuar dhe paraqet rrezik rrëshqitjeje. Gjithashtu, argjinaturat përgjatë rrugës janë në gjendjen e tyre natyrore, me shumë pak punime të kryera për të parandaluar ndonjë rrëshqitje dheu dhe gurësh. Ndërtesat janë ndërtuar në periudha të ndryshme midis viteve 1970 dhe 1980, sipas nevojave të burgut dhe minierës. Ato janë me lartësi dhe vendndodhje të ndryshme në shpatin e malit. Variojnë nga 1 deri në 5 kate dhe janë ndërtuar me mure mbajtëse me tulla prej balte ose silikate dhe pllaka betoni të armuar me tulla të shpuara (SAP), monolite ose blloqe betoni të parafabrikuara. Janë të mbuluara me tarraca të tipologjive të ndryshme: me parapet, pa parapet, me një ose më shumë pjerrësi. Informacioni fotografik i ndërtesave jepet në *Aneksin A: Informacioni dhe të dhënat kartografike të ndërtesave*, lidhur me çdo funksion të ndërtesave, mund të përmbledhen si më poshtë:

Ndërtesat e administratës së minierës

“Administrata e minierës” përbëhet nga tre ndërtesa: e para është 5-katëshe dhe ndahet nga një ndërtesë 2-katëshe me një mur të përbashkët me dy dritare komunikimi të brendshëm; e treti është një ndërtesë e izoluar 5-katëshe.

Struktura përbëhet nga shtylla dhe trarë betoni të armuar dhe tulla. Tarracat janë të tipit të sheshta me ose pa rrethim, me pjerrësi të ulët.

Komanda e Burgut

Kompleksi i “Komandës së Burgut” përbëhet nga tre godina të ulëta të cilat funksiononin së bashku. Struktura përbëhet nga shtylla dhe trarë betoni të armuar dhe tulla. Tarracat janë të tipit të sheshta me ose pa rrethim.

Infermiera

“Infermiera” është një ndërtesë 2-katëshe, e vendosur në një shpat dhe në kontakt me tokën, struktura e së cilës përbëhet nga mure mbajtëse tullash dhe trarë me panele betoni të parafabrikuara. Tarraca është e sheshtë pa rrethim.

Mensa e të burgosurve

Jo shumë larg infermierisë ndodhet një ndërtesë 1-katëshe e përdorur si mensë për të burgosurit sipas dëshmime arkivore dhe dëshmitare. E vendosur në një shpat dhe në kontakt me tokën, struktura e saj është realizuar nga trarë betoni të armuar dhe kolona murature.

Kapanonet e fjetjes për të burgosurit

“Kapanonet e fjetjes për Burgosurit” janë dy ndërtesa të ndërtuara pranë njëra-tjetrës midis viteve 1970 dhe 1980. Të dyja janë 3-katëshe, strukturat e tyre janë të ngjashme: tulla dhe pllaka betoni. Për njërën prej tyre themeli është prej guri dhe për tjetrën prej betoni të armuar.

E. Statusi i ruajtjes dhe integriteti

Që nga mbyllja e tij si Burg e deri në ditët e sotme, Siti ka pësuar degradim të vazhdueshëm dhe gradual për shkak të faktorëve njerëzorë dhe natyrorë.

Të 9 ndërtesat ekzistuese duken të plota në vëllim, por kanë nivele të ndryshme dëmtimi për sa i përket strukturës dhe elementëve të tjerë të ndërtimit, si pasojë e braktisjes ose dëmtimit të qëllimshëm. Shumica e problemeve janë të ngjashme për të gjitha ndërtesat, por secila ka problemet e veta specifike. Dëmi kryesor lidhet me depërtimin e ujit dhe shembjen e pjesëve të strukturës. Infiltrimi i ujit vjen kryesisht si pasojë e dëmtimit të hidroizolimit nga mungesa e mirëmbajtjes afatgjatë dhe dëmtimi i qëllimshëm. Infiltrimi i ujit është qartë i dukshëm në tavanet e kateve të sipërme; ka shkaputje të suvasë, dëmtim të tullave dhe korrozion të fibrave të çelikut. Në disa prej ndërtesave pjesë të muraturës mbajtëse janë shembur duke rrezikuar dëmtime të mëtejshme serioze të strukturës. Dëme të tjera të pranishme në të gjitha ndërtesat përfshijnë:

- heqja e të gjitha dyerve dhe dritareve, kangjellave, rrethimeve, etj.
- heqja, dëmtimi i të gjitha barrierave të ballkoneve dhe shkallëve
- dëmtimi i një pjese të madhe të pllakave dhe shtresave të dyshemesë
- dëmtimi dhe heqja e të gjitha instalimeve elektrike dhe hidraulike

Në vitin 2016, Fondi Botëror i Monumenteve futi Burgun e Spaçit në [Watch](#), një listë e vendeve të trashëgimisë kulturore që kanë nevojë për mbrojtje, duke deklaruar se "është në një gjendje jashtëzakonisht të avancuar të përkeqësimit dhe meriton të shndërrohet në një vend modern përkujtimi".

Në vitin 2017 CHwB Albania përgatiti dhe zbatoi, me mbështetjen financiare të Suedisë, një sërë ndërhyrjesh emergjente stabilizuese për të forcuar stabilitetin strukturor të ndërtesave të mbetura, për të ndaluar degradimin e madh dhe për të dhënë një sinjal të parë të fortë të vullnetit të mirë për të shpëtuar këtë monument nga shkatërrim total. Para së gjithash ndërhyrja përfshinte një pastrim të përgjithshëm dhe një organizim e dokumentim të rrënojave. Më pas është bërë hidroizolimi i tarracave për pesë objekte, të cilat janë pastruar dhe tharë nga xhepat e lagështisë dhe ujit. U krye një kontroll dhe pastrim i përgjithshëm tubacioneve dhe kanaleve kulluese ekzistuese dhe vendosja e të rejave.

Disa ndërhyrje stabilizuese kishin të bënin me gjashtë ndërtesa: rindërtimi i pjesëve të muraturës nëse është e nevojshme për strukturën e përgjithshme dhe instalimi i mbështetësve të kryera me elementë skele që mbështesin trarët prej druri.

Këto mbeten të vetmet ndërhyrje të realizuara në vend që nga shpallja e tij monument në vitin 2007. (Për më shumë detaje, ju lutemi të shihni *Aneksin A: Informacioni dhe të dhënat kartografike të ndërtesave*).

F. Autenticiteti

Atributet e prekshme të pronës - struktura, planimetria, fasadat - pasqyrojnë stilin e ndërtimit origjinal si dhe ndërhyrjet e mëvonshme, dhe mundësojnë përçimin në mënyrë të besueshme të vlerave të sitit. Autenticiteti i strukturave fizike vërtetohet nga dëshmitë e shumta të ish-të burgosurve politikë, të cilët janë gjithashtu në gjendje të konfirmojnë, përmes rrëfimeve të tyre personale, lidhjen ndërmjet elementeve të prekshme të pronës dhe ngjarjeve të ndodhura në këto hapësira në të kaluarën. Dëshmitë janë të mbështetura nga kërkime historike akademike dhe përpjekjet e shumë subjekteve juridike të pavarura dhe publike të Republikës së Shqipërisë. Masat emergjente të konsolidimit të zbatuara në vitin 2017 ishin në përputhje me protokollet e

konservimit sipas standardeve ndërkombëtare dhe u miratuan nga zyrat e ngarkuara në Ministrinë e Kulturës.

G. Kuadri aktual i pronësisë dhe administrimit

Pas kryerjes së gjithë kontrollit të dokumentacionit (due diligence) brenda kompetencave dhe mundësive të shqyrtuara (Shihni Aneksin I: *Certifikatat e pronësisë*), në dokumentacionin e siguruar mungon certifikata e pronësisë për të gjithë sitin në shqyrtim. Në bazë të vendimit të Ministrisë së Kulturës të vitit 2015 për shpalljen e zonë të mbrojtur për objektin Monument Kulture kategoria II “Burgu i Spaçit”, rezulton se e gjithë zona është e regjistruar si pronë shtetërore (d.m.th. në pasaportën e monumentit bashkëlidhur këtij vendimi shënohet pronësia shtetërore). Duhet bërë kujdes i mëtijshëm nga Ministria e Kulturës përpara veprimeve të sugjeruara të paraqitura në këtë plan menaxhimi.

Disa nga tokat dhe ndërtesat (pasuritë) brenda perimetrit të Burgut të Spaçit administroheshin nga Alb Baker, një ndërmarrje shtetërore minerare që më vonë u shndërrua në një shoqëri tregtare shtetërore (në vitin 1999). Sipas dokumenteve të disponueshme publikisht të Alb Baker të publikuara pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Shqipëri (kërkim në QKB për shoqërinë ALB BAKRI SHA me NUIS nr. J81920006K), qeveria shqiptare ka dhënë një kontribut në natyrë për kapitalin e Alb-Baker, që në atë kohë përbëhej nga ‘Miniera e Bakrit Reps’. Aksionari i vetëm i Alb Baker është Ministria e Financave dhe Ekonomisë (si përfaqësuese e shtetit, përgjegjëse për administrimin e të gjitha pronave/aseteve të shtetit).

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 533, datë 28.08.1998 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të shoqërive tregtare të krijuara nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore”, pasuritë e paluajtshme që janë në pronësi të shtetit dhe që kontribuohen në natyrë në kapitalin e shoqërisë shtetërore të krijuar nga transformimi i ndërmarrjeve të mëparshme shtetërore, do të regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme si prona të këtyre shoqërive. Megjithatë, certifikatat e rishikuara të pronësisë (të vitit 2004 dhe të disponueshme në Aneksin I: *Certifikata e pronësisë* - verifikimi i pavarur i të cilit nuk ishte i mundur) dhe dokumentacion tjetër që tregon statusin e mëposhtëm në lidhje me asetet e Alb Baker që janë pjesë e burgut të Spaçit:

Nr.	Pasuria nr.	Pronari i regjistruar	Sipërfaqja tokës m2	Sipërfaqja e ndërtesës m2	Emri i ndërtesës
I	685	Miniera Bakrit Reps	170	105	Ndërtesa e Magazinës së Sektorit

2	682	Miniera Bakrit Reps	400	199	Kapanone fjetje + kantina 5 katëshe
3	680	Miniera E Bakrit Reps	385	96	Kapanone fjetje për punëtorët 5 katëshe
4	674	Miniera E Bakrit Reps	1346	442	Kapanone fjetje për të burgosurit 5 katëshe
5	671	Miniera E Bakrit Reps	675	273	Ndërtesa e administratës
6	670	Miniera E Bakrit Reps	106	49	Ndërtesa e ambulancës
7	666	Miniera E Bakrit Reps	731	230	Spital + dhomë leximi (për të burgosurit)
8	Pa certifikatë				Kabinë elektrike në vendin e fjetjes 5 katëshe
9	Pa certifikatë		3019		Rrugë të brendshme plus mure mbajtëse

Pasuria 8 paraqitet si pjesë e aktiveve të hequra nga kapitali i Alb Baker; Pasuria 9 paraqitet si pjesë e aktiveve të hequra nga kapitali i Alb Baker, por nuk ka asnjë certifikatë pronësie.

Bazuar në dokumentet e pronësisë të paraqitura në tabelën e mësipërme, pronari i regjistruar i pronave të mësipërme (nga 1 – 7) është Miniera Bakrit Reps, ndërmarrja e vjetër shtetërore që administronte minierat në Spaç përpara se të transformohej më vonë në një shoqëri tregtare shtetërore e njohur sot si Alb Baker. Pavarësisht mospërputhjeve formale, mund të supozohet se pronari ligjor i pronave të sipërpërmendura, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 533, është në fakt Alb Baker SHA.

H. Çështjet lidhur me menaxhimin dhe udhëzime për adresimin e tyre

Për momentin, nuk mund të merret vendim për menaxhimin e siti nëse nuk trajtohen në radhë të parë çështjet në lidhje me pronësinë dhe të drejtat e administrimit.

Alb Baker SHA ka kaluar në likuidimin prej vitit 2004. Gjatë procesit të likuidimit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si përfaqësuese e Republikës së Shqipërisë, pronare e Alb Baker, ka njoftuar me shkresë, datë 24 gusht 2018, Ministrinë e Kulturës, se disa nga pasuritë e shoqërisë në likuidim janë objektet që mund të bien në perimetrin e mbrojtur të Spaçit; këtij njoftimi i është bashkangjitur një listë e të gjitha pasurive/pronave. Si dhe, ka kërkuar nga Ministria e Kulturës që të identifikojë një më një, të gjitha pasuritë e zonës së mbrojtur. Në vijim të komunikimeve të

ndryshme mes ministrive të ndryshme dhe Alb Baker, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (ministria e linjës përgjegjëse për aktivitetet minerare) i ka siguruar në datën 30 korrik 2019 Ministrisë së Kulturës listën e pronave të administruara nga Alb Baker, që sipas konstatimeve të Alb Baker, bien brenda perimetrit të zonës së mbrojtur. Disa nga këto prona (por jo të gjitha) mbulohen nga certifikata e pronësisë e shënuar në tabelën e mësipërme. E njëjta shkresë sqaron se 2 ndërtesat e shënuara përkatësisht në vendimin e Ministrisë së Kulturës të vitit 2015 për shpalljen e zonë të mbrojtur për objektin Monument Kulture kategoria II “Burgu i Spaçit” nuk administrohen nga Alb Baker (d.m.th. Ndërtesa e Këndit të Kuq dhe Ndërtesa e Togës së Ushtarëve të Burgut). Nuk ka asnjë informacion të bazuar në dokumentet e disponueshme për pronësinë e këtyre pronave – por mund të supozohet (në varësi të verifikimit të mëtejshëm me Agjencinë Kombëtare të Kadastrës nga Ministria e Kulturës) se këto janë gjithashtu prona shtetërore.

Më 27 nëntor 2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka urdhëruar me Urdhrin nr. 401, datë 27.11.2019, zvogëlimin e kapitalit të Alb Baker, duke hequr truallin dhe objektet e shënuara në tabelën I. Për këtë qëllim është marrë vendimi i aksionarit të vetëm të Alb Baker më datën 23 qershor 2020, pas një raporti të përgatitur nga eksperti i autorizuar i shoqërisë në lidhje me vlerën e këtyre asetëve.

Pas zvogëlimit të kapitalit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka kërkuar nga Ministria e Kulturës që të autorizojë personat që do të marrin në dorëzim asetet dhe të përpilojnë dokumentet e nevojshme për kalimin e tyre Ministrisë së Kulturës. Me kalim kuptojmë kalimin e të drejtave të administrimit dhe jo të drejtave të pronësisë, të cilat pas zvogëlimit të kapitalit të Alb Baker i kthehen Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si përfaqësuese e shtetit shqiptar.

Ministria e Kulturës është përgjigjur se kalimi i të drejtave të administrimit do të kryhet pasi të jetë finalizuar plani i menaxhimit të burgut të Spaçit. Bazuar në korrespondencën e disponueshme, shkresa e fundit e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë drejtuar Ministrisë së Kulturës me të cilën kërkohet kalimi i asetëve, daton më 9 shtator 2023. Sipas Ligjit për Trashëgiminë Kulturore, Ministria e Kulturës propozon kalimin e pasurive kulturore të paluajtshme që gëzojnë statusin “me rëndësi universale, vendore ose kombëtare” në pronësi shtetërore, në administrim institucioneve publike të qeverisjes qendrore, të qeverisjes vendore dhe subjekteve juridike të themeluara prej tyre, me qëllim që këto të fundit të vlerësojnë dhe kryejnë veprimtaritë përkatëse konservuese e mbrojtëse të vlerave kulturore.

Procedura e kalimit përcaktohet në një udhëzim të posaçëm të Ministrisë së Kulturës (Udhëzim nr. 583, datë 14.10.2019) dhe kalimi në administrim miratohet nga Këshilli i Ministrave.

4. Vlerësimi i vlerës së pronës

A. Analiza e vlerave

Ish-burgu dhe kampi i punës së detyruar të Spaçit mishëron një mori vlerash, disa prej të cilave ndahen në mënyrë kolektive dhe rezonojnë thellë në aspekte të ndryshme të shoqërisë. Midis këtyre vlerave, shumë janë të ndërlydhura dhe kontribuojnë në një rëndësi të shumëanshme të sitit. Në trajtimin e mëposhtëm të këtij seksioni, secila vlerë do të shqyrtohet në mënyrë gjithëpërfshirëse individualisht:

- Vlerat historike/dëshmuuese;
- Vlerat politike/shoqërore;
- Vlerat kulturore;
- Vlerat lokale/komunitare;
- Vlerat evropiane/ndërkombëtare;
- Vlerat e raritetit/unicitetit;
- Vlerat edukative;
- Vlerat natyrore/peizazhore;
- Vlerat ekonomike;
- Vlerat shkencore;

Vlerat historike/dëshmuuese;

Ish-burgu dhe kampi i punës së detyruar të Spaçit qëndron si një nga vendet më emblematike të persekutimit dhe shkeljes së të drejtave të njeriut gjatë diktaturës komuniste në vend, duke shërbyer si një kujtesë për vështirësitë e duruara dhe qëndrueshmërinë e shfaqur nga ata që vuajtën brenda mureve të tij. Gjendja aktuale e konservimit dhe izolimi fizik i Zonës i bëjnë jehonë gjallërisht vuajtjeve të përjetuara në Spaç, si dhe vështirësisë kolektive të pajtimit me periudhën komuniste të historisë së Shqipërisë. Edhe historia e fundit e braktisjes që ka duruar Spaçi siguron që ai të mbetet një testament i pandryshuar i karakterit të tij origjinal si një vend i vuajtjeve të thella.

Rëndësia historike e Spaçit nënvizohet më tej nga mbajtja e asaj që konsiderohet gjerësisht si një nga revoltat politike më me ndikim kundër diktaturës komuniste të Shqipërisë - Revolta e Spaçit.

Në maj të vitit 1973, për dy ditë, të burgosurit morën kontrollin e kampit, duke ngritur flamurin shqiptar të zhveshur nga ylli i tij komunist, duke brohoritur parulla antikomuniste në unison dhe brohoritur në favor të demokracisë perëndimore. Edhe pse autoritetet shtypën Revoltën, duke ekzekutuar krerët e saj dhe duke vendosur dënime të ashpra dhe vite të tjera burgimi për të burgosurit e mbetur, kjo ngjarje arriti të pozicionojë Spaçin si një vend rezistence në imagjinatën kolektive të vendit.

Vlerat politike/shoqërore

Vlerat kryesore politike dhe shoqërore të ish-burgut dhe kampit të punës së detyruar të Spaçit pasqyrohen më së miri në rolin e tij të dyfishtë për të na edukuar mbi mekanizmat e persekutimit politik dhe shtypjes, por edhe qëndrimin si një dëshmi e fuqisë së rezistencës aktive për ta thyer atë cikël të shtypjes. Ai e bën këtë duke shërbyer si një simbol për ideale si liria, pluralizmi dhe një shoqëri demokratike, duke mishëruar gjithashtu parimet e respektit dhe humanizmit, dinjitetit dhe shprehjes artistike. Nëpërmjet ruajtjes dhe interpretimit të tij, Spaçi bëhet një platformë për veprim dhe dialog ku brezat e rinj mund të mësojnë të marrin përgjegjësi individuale për ruajtjen e shëndetit demokratik të shoqërisë sonë sot.

Vlerat kulturore

Krahas të qenit i vetmi vend i këtij lloji që renditet si një zonë e mbrojtur e trashëgimisë kulturore në Shqipëri, vlera kulturore e ish-burgut dhe kampit të punës së detyruar të Spaçit gjen shprehje në rolin e tij si burim frymëzimi për vepra të ndryshme artistike, letrare, piktura, ilustrime dhe më shumë. Shumë prej këtyre krijimeve burojnë nga puna e ish të burgosurve politikë, mes të cilëve kishte artistë dhe intelektualë të shumtë. Brenda këtij konteksti, prodhimi artistik merr rolin e një mjeti për rezistencë dhe aktivizim, duke hapur dyert për aktivizimin e sitit si një vend kulturor i angazhuar shoqërisht që fton në eksplorimin e rëndësisë së tij kulturore të shumëanshme.

Vlerat lokale/komunitare

Spaçi është kthyer në një simbol shpirtëror të vuajtjes brenda dhe jashtë burgut, duke vazhduar gjatë dhe përtej periudhës komuniste. Kjo simbolikë e qëndrueshme është e vërtetë për komunitetin e individëve që pësuan persekutim politik.

Për më tepër, Spaçi ka një rëndësi të madhe për komunitetet e ndryshme fetare në Shqipëri, pasi aty u ekzekutuan dënimet për figura të shquara fetare. Ai ka një rëndësi të veçantë edhe për komunitetin lokal të Bashkisë Mirditë.

Vlerat evropiane/ndërkombëtare

Evropa përjetoi një sërë regjimesh totalitare në vitet 1900 që ndikuan shumë në jetën e qytetarëve të saj. Diktatura e parë e Evropës u vendos në Rusi nga Revolucioni Bolshevik i vitit 1917. Dy vjet pas Revolucionit Rus, më 1919, Benito Mussolini themeloi partinë fashiste në Itali: regjimi i tij, i vendosur pjesërisht në 1924 dhe i rrëzuar në 1928-29, zgjati në fakt deri në fund të Luftës së Dytë Botërore. Format e fashizmit zunë rrënjë edhe në vende të tjera evropiane: në Spanjë me de Rivera fillimisht dhe më pas Franko, në Portugali me Salazar dhe pas Luftës së Dytë Botërore në Greqi. Gjermania naziste ishte totalitarizmi më i zhvilluar në Evropë: Hitleri dhe diktatura e tij do të mbahen mend gjithmonë si një nga periudhat më të këqija në historinë botërore, me Luftën e Dytë Botërore si lufta më shkatërruese në histori, si për shkatërrimin e betejave ashtu edhe për kampet e vdekjes.

Fundi i Luftës së Dytë Botërore la një tjetër trashëgimi të vështirë për Evropën, ndarja midis Perëndimit dhe Lindjes për disa dekada dhe që i pa vendet e Evropës Lindore të vazhdojnë të vuajnë nën një seri regjimesh totalitare që ranë rreth viteve 1990. Që nga ajo kohë, e aq më tepër pas luftës shkatërruese në ish-Jugosllavi, filloi një proces i zgjerimit të BE-së, të cilit ndërkohë i kishin lindur kombet e Evropës Perëndimore, i cili po vazhdon edhe sot e kësaj dite.

Ndaj është thelbësore që Evropa e kombeve dhe e qytetarëve të kujtojë periudhën e errët historike të totalitarizmit, pasi ato regjime ndikuan brutalisht në historinë e saj dhe jetën e njerëzve. Spaçi, si vendet e tjera të shkeljes së të drejtave të njeriut dhe persekutimit të një regjimi autoritar, zotëron një vlerë të përbashkët në nivel evropian, pasi dëshmon një epokë historike dhe mban gjallë paralajmërimin ndaj mekanizmave kontrollues që çojnë drejt regjimeve të tilla.

Vlerat e raritetit/unicitetit

Spaçi është një nga të paktat burgje apo kampe komuniste në Shqipëri që i ka mbijetuar shkatërrimit total. Sot Spaçi është e vetmja mbetje e rrjetit të dikurshëm të persekutimit që është zyrtarisht nën mbrojtjen e shtetit shqiptar (si “monument kulture” i listuar) dhe nga të gjitha institucionet e represionit është më i larti në kujtesën kolektive të shqiptarëve. Për më tepër, Spaçi ishte skena e asaj që shumë e konsiderojnë si një nga revoltat politike më me ndikim kundër diktaturës komuniste në historinë e Shqipërisë. Kjo ngjarje shënoi një pikë kthese në historinë e Zonës, me dy faktorë kyç që kontribuan në shpërthimin e revoltës. Njëra ishte një lëvizje liberalizuese që Partia Komuniste e inkurajoi shkurtimisht në fillim të viteve 1970, vetëm për ta tërhequr dhe denoncuar pak kohë më vonë. Tjetra ishin kushtet çnjerëzore të punës në minierë, me të

burgosurit që punonin pa u lodhur nën tokë, duke punuar me dorë në temperatura që mund të ngriheshin deri në 40 gradë.

Vlerat edukative

Duke qenë një nga burgjet apo kampet e pakta në Shqipëri që ka arritur t'i rezistojë shkatërrimit të plotë, ish-burgu dhe kampi i punës së detyruar të Spaçit ka një vlerë të lartë edukative, pasi ofron një dritare të prekshme në historinë e shtypjes politike të vendit. Ajo që ka mbetur nga ndërtesat mban gjurmët e funksionimit të kampit dhe i bën jehonë dëshmive të atyre që u burgosën atje, duke ofruar mundësi për edukim formal dhe joformal mbi çështjet e kaluara dhe të sotme që lidhen me persekutimin politik, lirinë, barazinë, të drejtat dhe demokracinë. Ndërsa ka vlerë për individët e të gjitha moshave dhe nxit mundësitë e edukimit ndër breza, Spaçi merr një rëndësi të veçantë për brezat e rinj, duke shërbyer si një burim i rëndësishëm për t'i ndihmuar ata të kuptojnë se si lind shtypja në shoqëri dhe i motivon ata të ndërmarrin veprime proaktive si individë dhe anëtarë të shoqërisë. Vlera edukative e Spaçit është më tej e evidente përmes aktiviteteve të ndryshme të organizuara nga disa OJQ vitet e fundit, të cilat janë përpjekur të mbështesin interesin publik në Spaç dhe të përfshijnë aktivisht të rinjtë përmes aktiviteteve të tilla si shkollat verore dhe turne me guida të udhëhequra nga ish të burgosur, ndër të tjera.

Vlerat natyrore/peizazhore

I ndodhur në një luginë të izoluar, ish-burgu dhe kampi i punës së detyruar i Spaçit dallohet për mjedisin e tij natyror të ruajtur mirë. Vendndodhja e kompleksit të ish-burgut dhe minierës, që shtrihet deri në shpatin e malit, është një tipar i rëndësishëm peizazhi. Vlera e peizazhit shënjohe nga izolimi i luginës shkëmbore ku ndodhet kampi, gjë që e shtonte ndjenjën e veçimit dhe izolimit të përjetuar nga ish të burgosurit e tij; sot, kjo vlerë është në kontrast me kampin e ri minerar të sapondërtuar dhe objektet e përpunimit, të cilat janë një prani e dukshme mbi Spaç.

Vlerat ekonomike

Ndërsa pranohet se fokusi aktual është në prioritizimin e restaurimit dhe ruajtjes së Spaçit për të mbështetur vlerat e tij kulturore, sociale, historike dhe edukative, një Zonë Muzeale dhe një Muze i menaxhuar mirë mund të sjellin përfitime ekonomike direkte dhe indirekte. Është gjithashtu thelbësore të njihet vlera e mundshme ekonomike që ofron afërsia e burimeve minerale, një pjesë e të cilave tani është pjesë e një kontrate koncesioni. Në perceptimin e disa aktorëve të konsultuar,

përfitimet ekonomike që rrjedhin nga aktivitetet minerare nuk përputhen plotësisht me imperativin e ruajtjes së integritetit historik dhe kulturor të sitit.

Vlerat shkencore

Spaçi shërben edhe si një rast studimor i teorive, teknikave dhe materialeve të përdorura në ndërtimin e komplekseve industriale gjatë regjimit komunist shqiptar. Vetë mjedisi natyror përreth ofron njohuri mbi efektet e minierave dhe materialeve të përdorura ose të nxjerra në shëndetin e komuniteteve të afërta dhe ekosistemit.

B. Aktorët kryesorë

Një identifikim i aktorëve kryesorë të sitit u krye për të siguruar pjesëmarrjen më të gjerë të mundshme gjatë përcaktimit të një vizioni për Spaçin dhe në fazat përkatëse të përgatitjes së planit të menaxhimit. U identifikuan aktorët dhe grupet e mëposhtme të interesit (në rend alfabetik):

- Akademia e Shkencave
- Alb-Baker sh.a.
- Shoqata për Muzeun e Burgut të Spaçit
- Shoqata e ish të përndjekurve politikë
- Shoqata e Mësuesve të Historisë
- Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit
- Kisha Katolike
- Arkivi Qendror i Shtetit
- Cultural Heritage without Borders Albania
- Ish të burgosur
- Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë
- Instituti për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit
- Instituti i Studimeve Politike
- Instituti i Integritetit të Ish të Përndjekurve Politikë
- Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë
- Portali Kujto.al - Arkiva Online e Viktimave të Komunizmit
- Fondacioni Konrad Adenauer
- Komuniteti lokal i Mirditës
- Fondacioni Maximilian Kolbe
- Ministria e Kulturës

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Bashkia Mirditë
- Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore
- Zona të tjera muzeale në Shqipëri (Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës, Shtëpia e Gjetheve)
- Zona të tjera muzeale jashtë Shqipërisë
- Shkollat në Shqipëri
- OJQ Tek Bunkeri
- TETE Albania Tunnel & Mining Sh.A.
- Universiteti i Tiranës

Strategjia për angazhimin e grupeve të interesit, si dhe kalendari i takimeve konsultative, listat e pjesëmarrësve në takime dhe një pasqyrë e gjetjeve kryesore janë paraqitur në Aneksin D: *Evidenca nga konsultimet me grupet e interesit.*

C. Vlera për shoqërinë shqiptare

Ndër vite, disa nisma të organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të kujtesës janë drejtuar drejt Spaçit, duke treguar se siti ka një rëndësi emblematike në imagjinatën shqiptare si përfaqësues i vuajtjeve dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut të kryera nga diktatura komuniste.

Disa faktorë tregojnë se si rrënojat e ish-burgut dhe kampit të punës së detyruar tashmë shihen si zonë muzeale:

- shumëllojshmëria e veprimtarive të kryera për ruajtjen e kujtesës, duke filluar nga kërkimet historike, vizitat e shoqëruara, edukimi i brezave të rinj, fushatat mediatike, prodhimet artistike;
- prania e vazhdueshme e sitit në prodhimtarinë letrare shqipe;
- këmbëngulja dhe vazhdimësia me të cilën kryhen këto iniciativa, që shpesh përsëriten periodikisht ose çdo vit;
- fakti që të gjitha aktivitetet e promovuara nga organizata të pavarura ishin të vetëfinancuara ose kanë marrë mbështetje kryesisht nga burime ndërkombëtare.

Edhe pse një prezantim i plotë i aktiviteteve rreth Spaçit që nga mbyllja e regjimit është përtej qëllimit në këtë fazë, paragrafët e mëposhtëm paraqesin ato më të fundit që u promovuan nga disa prej aktorëve kryesorë:

Një historik i shkurtër i repartit të riedukimit nr. 303 të Spaç-Mirditë

Në vitin 2023, nën drejtimin e profesor Artan Pulos, u përgatit një botim për historinë e repartit të riedukimit nr. 303 të Spaç-Mirditë, që nga krijimi e deri sa u zhvendos në kampin e Spaçit. Teksti shqyrton dokumentacionin arkivor, drejton dëshmitarët dhe mas median të rijetëzojnë një pamje gjithëpërfshirëse të organizimit dhe administrimit të Kampit, kushteve të vështira të jetesës dhe punës së të dënuarve, si dhe kontekstin më të gjerë të regjimit komunist në Shqipëri. Publikimi u mundësua nga CHwB Albania me mbështetjen e Suedisë.

Procedura hetimore administrative për verifikimin e vendvarrimeve të dyshuara për zbardhjen e fatit të dyzet e katër personave të zhdukur në burgun e Spaçit

Që nga qershori 2023, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), i krijuar me një ligj të posaçëm nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2015, ka hapur një procedurë për hetimin e vendvarrimeve të dyshuara të 44 ish-të dënuarve që besohet se të jenë ekzekutuar, vrarë ose vdekur nga torturat dhe sëmundjet gjatë vuajtjes së dënimit, aksidentet në punë ose në tentativa arratisjeje në burgun e Spaçit.

Mbledhja e rreth 60 dëshmime të ish të burgosurve të Burgut të Spaçit

Me kalimin e kohës, ka gjithnjë e më pak ish të burgosur të Spaçit që janë ende në gjendje të japin dëshmi të drejtpërdrejtë të historive të tyre. Për të mbështetur transmetimin e kësaj pjese të rëndësishme të historisë kombëtare dhe për të garantuar të drejtën e qytetarëve për informim, Autoriteti për Informim mbi Dosjet e Ish-Sigurimit të Shtetit po mbledh dëshmitë e të burgosurve të Burgut të Spaçit, me qëllim publikimin e tyre.

Përkujtim i 50-vjetorit të Revoltës së Spaçit

Përkujtimi i 50-vjetorit të Revoltës së Spaçit (21-23 maj 1973) ishte rasti për të përkujtuar katër heronjtë e kësaj revolte - Pal Zefi, Skënder Daja, Dervish Bejko dhe Hajro Pashai - të cilët u pushkatuan dhe trupat e tyre vazhdojnë të zhdukur edhe sot, dhe për të gjithë ata që kanë vuajtur dënimin në këtë kamp-burg gjatë diktaturës komuniste. Aktiviteti u organizua nga Dioqeza e

Urëshenit në bashkëpunim me organizata dhe institucione të shumta, mes të cilave IDMC, ISKK, Kujto.al, Shoqata për Muzeun e Burgut të Spaçit dhe AIDSSH, të cilat për këtë rast përgatitën ekspozita dhe evente të veçanta.

Kultura për Zhvillimin e Qëndrueshëm: Potenciali i pashfrytëzuar

Projekti, i promovuar nga OJQ Tek Bunkeri, do t'i japë një vlerë të shtuar artistike Burgut të Spaçit përmes instalimit, në vjeshtën e vitit 2023, të 49 skulpturave portrete të ish të burgosurve politikë të krijuar nga artistë të rinj, prodhimit të podkasteve që tregojnë historitë e tyre, si dhe do të rrisë interesin për të vizituar këtë Sit, duke organizuar panaire kulturore lokale, ekspozita dhe festivale. Projekti financohet nga Bashkimi Evropian, pjesë e programit EU4Culture, zbatuar nga UNOPS në partneritet me Ministrinë e Kulturës.

Rikonstruktimi dixhital i Burgut të Spaçit

Meqenëse largësia dhe gjendja e avancuar e përkeqësimit të Spaçit ndërhyjnë drejtpërdrejt në aftësinë e Spaçit për të përmbushur potencialin e tij si një memorial i së kaluarës së vështirë të Shqipërisë, një prototip rindërtimi dixhital u zhvillua dhe u bë lirisht i aksesueshëm në internet nga CHwB Albania dhe Instituti Politeknik Worcester, me mbështetje financiare nga Suedia.

Dokumentari “Revolta që tronditi diktaturën” dhe filmografi të tjera

Me rastin e 50-vjetorit të Revoltës së Spaçit, Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit ka bashkëpunuar me regjisorin Ergys Mertiri për nxjerrjen e dokumentarit "Revolta që tronditi diktaturën", premiera e të cilit u dha në ditën e Revoltës, në Spaç, më 21 maj. Ndër vite, organizata të shumta kanë realizuar videoproduksione për Spaçin, më i fundit është dokumentari “Revolta e Spaçit”, i prodhuar nga Fondacioni Kujto me mbështetjen e Ambasadës Zvicerane.

FRAKTURA

E konceptuar nga artistët Ardian Isufi dhe Fatos Lubonja me kurator Elton Koritarin dhe me mbështetjen e Konrad Adenauer Stiftung Albania, FRAKTURA u zhvillua në vitin 2023 si një ndërhyrje artistike alternative - e shoqëruar me një diskutim publik. Ajo e ka paraqitur Spaçin si një nga emblemat e mizorisë, vendin e të cilit në kujtesën kolektive shqiptare dhe kushtet fizike po

e degradon koha dhe harresa. Gjithashtu promovoi diskutimin publik për muzeizimin e Spaçit dhe vendeve të ngjashme në Shqipëri.

Jeta në Spaç

Jeta në Spaç është një ekspozitë që ndërthur artin dhe kërkimin dhe synon të kujtojë vizualisht ditët dhe aktivitetin e të burgosurve përmes vizatimeve, duke ilustruar jetën e përditshme në këtë kamp, punën në minierë, kushtet e të burgosurve. Skicat u ekspozuan në një nga godinat e burgut gjatë Përkujtimit të 50-vjetorit të Revoltës së Spaçit dhe janë të disponueshme online, të shoqëruara me një tekst në sfond. Projekti u ideua nga Fondacioni Kujto.al, në bashkëpunim me Fondacionin Konrad Adenauer dhe me mbështetjen e Ambasadës së Zvicrës.

Ditët e Kujtesës

Në kuadër të misionit të tij, Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë organizon dhe promovon çdo vit Ditët e Kujtesës, për të mbajtur gjallë debatin dhe kujtesën shoqërore mbi pasojat e regjimit komunist në Shqipëri, duke i kushtuar vëmendje edhe ish-burgut dhe kampit të punës së detyruar të Spaçit. Nisma kujdeset veçanërisht për ndërgjegjësimin e brezave të rinj dhe ka krijuar konkurset e saj vjetore për shkollat si një mjet efektiv për promovimin e njohurive mbi diktaturën komuniste shqiptare. Ditët e Kujtesës organizohen në partneritet me Fondacionin Konrad Adenauer.

Kampi Veror Ndërkombëtar në Ish-Burgun Komunist të Spaçit

Kampi veror bashkon të rinj nga vende të ndryshme evropiane ish-komuniste për të marrë pjesë në një kamp veror në Spaç me objektivin e dyfishtë për të kontribuar në ndërgjegjësimin e shoqërisë shqiptare për të kaluarën komuniste dhe promovimin e shkëmbimit dhe rrjetëzimit të përvojave midis vendeve me histori dhe sfida të ngjashme, për të rritur kapacitetet e tyre për t'u përballur me dhunën e rënduar në të kaluarën në interes të një të ardhmeje më të mirë. Ai organizohet çdo vit nga Shoqata për Muzeun e Burgut të Spaçit, Komisioni i Drejtësisë dhe Paqes i Shqipërisë dhe Fondacioni Maximilian Kolbe dhe mbështetet nga Renovabis.

Përgatitja e Planit të Menaxhimit të ish-burgut të Spaçit

Për të konsoliduar dhe sqaruar kuadrin për ngritjen e zonës muzeale, në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Ministrinë e Kulturës (dt. 08.11.2018, nr. 8400 Prot.) CHwB Albania ka shpallur fitues me tender publik Fondacionin Santagata për përgatitjen e Planit të Menaxhimit. Që

nga viti 2014, OJQ-ja Trashëgimia Kulturore pa Kufij-Shqipëri (CHwB Albania) ka angazhuar shumë grupe interesi në një proces afatgjatë për të zhvilluar Burgun e Spaçit në një vend dialogu. Të gjitha nismat u mbështetën nga Suedia.

Punime të tjera letrare

Rreth Spaçit janë prodhuar vepra të shumta letrare, herë pas here nga përvoja në vetë të parë e ish të burgosurve politikë, të tjera që mbledhin rrëfime historike mbi sistemin e terrorit dhe kontrollit të ushtruar nga diktatura komuniste. Një përzgjedhje e veprave letrare përfshin:

- Bedri Blloshmi, Revolta e Qaf-Barit dhe terrori komunist 1943-1990, Shtëpia botuese "Geer", Tiranë 2012
- Bedri Blloshmi, Plumba në ferr, Shtëpia botuese "Mirgecalb", Tiranë 2016
- Fatos Lubonja, Ridënimi, Botimet Përpjekja, Tiranë 1994
- Fatos Lubonja, Jete burgu, Botimet Skanderbeg, Tiranë 2021
- Femi Sufaj, Historia e burgjeve të Shqipërisë gjatë shekullit XX. Shtëpia botuese Albi, Tiranë 2000
- Gezim Çela, Klithma e një nëne, Shtëpia botuese "Globus R", Tiranë 2006
- Kastriot Dervishi, Internimi dhe burgimi komunist në Shqipëri, Shtëpia botuese "55", Tiranë 2016
- Kastriot Dervishi, Burgjet dhe kampet e Shqipërisë komuniste, Instituti i Studimit të Krimeve dhe
- Luan Myftiu, Nen terrorin komunist, Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Tiranë 2014
- Marenglen Kasmi, 45 vjet nga revolta e Spaç, ngritja krye e një kurajoje që hyri në histori si beteja me diktaturën, në Zani i Malsisë, Maj 2018
- Maks Velo, Thesi i burgut, Shtëpia botuese "Phoenix", Tiranë 1996
- Maks Velo, Palltoja e burgut, Shtëpia botuese "Letrat", Tiranë 1995
- Maks Velo, Spaçi, Shtëpia botuese "55", Tiranë 2010
- Pasojat e Komunizmit (Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit). Tiranë 2015
- Visar Zhiti, Rugët e ferrit, Shtëpia botuese Onufri, Tiranë 2001
- Visar Zhiti

- Zef Pllumi, Rrno vetëm për me tregue: libri i kujtimeve / 1 1944-1951, Tiranë: Hylli i Dritës, 1995 me parathënie nga Aurel Plasari; Shkodër: Botime Françeskane, 2015.

D. Analiza e pikave të forta, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve të faktorëve që ndikojnë në integritetin dhe autenticitetin e ruajtjes së këtyre vlerave

Pikat e forta

- Një nga vendet më emblematike të persekutimit dhe shkeljes së të drejtave të njeriut gjatë diktaturës komuniste në vend;
- Advokim, veprim dhe prodhime kulturore për Spaçin nga ish të burgosurit politikë;
- Vlera e Spaçit është e njohur ndër shtetasit shqiptarë, organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet;
- Nisma të shumta studimi, edukimi dhe promovimi të sitit të kryera me financime private ose të palëve të treta nga organizata të pavarura.

Pikat e dobëta

- Të drejtat e pronësisë dhe administrimit mbahen aktualisht nga një subjekt që nuk ka një mision kulturor;
- Integriteti në rrezik për shkak të përkeqësimit të konsiderueshëm të strukturave;
- Deri në vitin 2023, asnjë investim nga organet publike për ruajtjen e Monumentit të Kulturës;
- Integriteti i peizazhit është dëmtuar nga prania e impianteve minerare të ndërtuara së fundmi;
- Në rrugën që kalon në pronën e mbrojtur kalojnë vazhdimisht kamionë.

Mundësitë

- Disponueshmëria e ekspertizës së avancuar nga organizata kombëtare dhe praktikant;
- Ndjeshmëria dhe vëmendja në nivel evropian dhe ndërkombëtar për vendet e potencialit të kujtesës për të qenë vende të promovimit të të drejtave të njeriut dhe paqes;

Risqet

- Interpretimi i ardhshëm duhet të shmangë rindërtimin masiv ose dramatizimin e hapësirave, pasi kjo do të minonte origjinalitetin e sitit;
- Perceptimi si një vend i largët dhe mundësia për të qenë një vend kujtimi dhe reflektimi kërcënohet nga

- Ndikim i lartë potencial i konservimit në sit dhe zhvillimin vendas;
- Analiza krahasuese konfirmon praninë e burimeve të financimit për të mbështetur punimet e restaurimit dhe aktivitetet edukative në vend.

aktivitetet e fabrikës minerare aty pranë.

5. Aspekte të tjera lidhur me pronën

A. Konteksti territorial

Ish-burgu dhe kampi i punës së detyruar i Spaçit ndodhet në Bashkinë Mirditë, në Qarkun e Lezhës, në veriperëndim të Shqipërisë. Bashkia u krijua pas reformës administrative të vitit 2015 nga shkrirja e bashkive Fan, Kaçinar, Kthellë, Orosh, Rrëshen (qendra e Bashkisë), Rubik, Selitë. Bashkia shtrihet në një sipërfaqe prej 870,26 km² dhe sipas censit të vitit 2011, popullsia është rreth 22.000 banorë.

Bashkia Mirditë ndodhet në një zonë malore me pyje të dendur dhe pjesërisht ende të paprekura; është pjesë e një rajoni më të gjerë të njohur historikisht si Mirditë dhe i kufizuar nga lumi i Fanit të Vogël në jug, nga lumi Drin në lindje dhe veri dhe i aksesueshëm në perëndim.

Krahina e Mirditës, për shkak të emrit të saj nga popullsia që e ka banuar historikisht, ka një identitet kulturor të njohur dhe të gjatë, i lidhur, në imagjinatën kombëtare, me rezistencën kundër pushtimit të huaj dhe me statusin autonom që ruajti zona gjatë periudhës së sundimit osmane në Shqipëri, gjë që kontribuoi edhe në ruajtjen e fesë katolike romake, ende mbizotëruese ndër banorët e sotëm të Komunes.

B. Ekonomia lokale dhe turizmi

Sipas të dhënave të INSTAT të vitit 2021 për Prodhimin e Brendshëm Bruto sipas Rajoneve Statistikore në Shqipëri, Qarku i Lezhës është qarku i dytë i fundit në Shqipëri për nga PBB për frymë, me një mesatare vjetore PBB prej 461 000 lekë, dukshëm më e ulët se PBB-ja kombëtare për frymë, e cila është 660 000 lekë.

Sa i përket aktiviteteve ekonomike, në fund të vitit 2022 ishin aktive 482 ndërmarrje, nga të cilat 76 prodhues mallrash dhe 372 prodhues shërbimesh. Agrokultura ushtrohet në pjesët më të mëdha të luginave, ndërsa në kullotat e tokave më të larta blegtoaria është një profesion i përhapur. Turizmi mbetet një sektor me potencial të lartë të pashfrytëzuar për Mirditën, me mbështetje të

konsiderueshme në zhvillimin e saj të nxitur edhe nga bashkëpunimi midis Bashkisë dhe "Albania Austria Partnership - Marianne Graf (AAP)", një organizatë ndihme private, jopartiake me qendër në Austri. Ndër ndërhyrjet e shumta, AAP ka financuar hapjen e Info-Kullës, një zyrë informacioni turistik dhe muze me vendndodhje në Rubik, i cili menaxhohet nga Bashkia Mirditë, me bashkëpunimin dhe mbështetjen e AAP. Nisma të tjera kanë synuar pozicionimin e Mirditës si një destinacion ekoturizmi dhe deri më tani kanë arritur të sigurojnë shtigje ecjeje, të vendosin shenja dhe sinjalistikë, të ndërtojnë strehëza dhe të prodhojnë harta të shtigjeve. Oferta gjendet në faqen e internetit <https://hikingMirdite.com/> (e disponueshme në 4 gjuhë), ku mund të gjeni informacione edhe për akomodimet lokale, të përbëra aktualisht nga 6 struktura që variojnë nga hotelet ekologjike, kullat, shtëpitë e pritjes dhe kampe. Modeli i ekoturizmit ndiqet edhe në përpjekjen për të ndarë përfitimet e këtij aktiviteti ekonomik mes banorëve, duke luftuar papunësinë në zonë dhe duke mbështetur bujqësinë e vogël në zonë.

C. Perspektiva për zhvillimin e komunitetit

Industritë kulturore dhe krijuese mund të konsiderohen si një burim kyç për nxitjen e një lloji të ri të rritjes ekonomike, sepse ato janë shtytëse të vendeve të punës, inovacionit dhe kohezionit social. Ekonomia kreative ka potencialin të kontribuojë në rritje dhe prosperitet nëse zbatohen politika të përshtatshme publike për të tërhequr investime, teknologji dhe biznese kreative. Ndërthurja e duhur e politikave publike dhe zgjedhjeve strategjike është thelbësore për shfrytëzimin e potencialit të ekonomisë krijuese dhe lidhjen e vizioneve të nivelit të lartë me zhvillimin territorial.

Lidhja më e drejtpërdrejtë mes territorit dhe investimit për ruajtjen dhe hapjen e Spaçit si një Sit kujtese dhe muze është turizmi: Spaçi do të jetë një burim për më shumë vende pune dhe të ardhura tregtare, veçanërisht në sektorët e turizmit dhe hotelerisë. Për më tepër, siç është studiuar në literaturë, shpenzimet për punët fillestare ashtu edhe shpenzimet e vazhdueshme kontribuojnë në krijimin e cikleve të reja të shpenzimeve nëpërmjet një efekti shumëfishues, i cili, në kontekstin kulturor, është afërsisht trefish. Kjo do të thotë se shpenzimet e institucionit të kulturës dhe atyre që e vizitojnë zakonisht kanë efekte ekonomike direkte, indirekte dhe të nxitura në zonën ku ndodhet prona, të cilat janë tre herë më të larta se në ciklin e parë të shpenzimeve. Gjithashtu, ka një sërë aktiviteteve të tjera kulturore dhe krijuese që fuqizohen nga prania e një institucioni kulturor: interpretimi, komunikimi, dixhitalizimi, projektimi dhe organizimi i eventeve, kurimi i

ekspozitave të përkohshme, shërbimet që mund të ofrohen nga jashtë ose të zhvilluara në nivel lokal falë investimit të sipërmarrësve vendas ose bizneseve të reja.

D. Infrastruktura

Ish-burgu dhe kampi i punës së detyruar i Spaçit është i aksesueshëm nga dalja Reps e autostradës kombëtare, dhe vazhdohet më pas edhe për rreth 7,5 km në një rrugë të paasfaltuar dhe të pjerrët. Ky segment i fundit është kritik për sa i përket mundësisë së udhëtimit të sigurt me mjete të zakonshme dhe nuk ka barriera mbrojtëse. Përveç kësaj, sipërfaqja e rrugës është e paniveluar dhe e pasigurt në rast të shiu ose bore, që janë fenomene të shpeshta të motit nga vjeshta në pranverë në rajon. Aktualisht, duket se mirëmbajtja e rrugës kryhet nga kompania minerare TeteAlb.

E. Koncesioni minerar

Që nga viti 2018, kompania TeteAlb, një kompani e regjistruar në Shqipëri, në pronësi 100% të kompanisë Tete Turkey, është marrëse e një leje për shfrytëzimin e minierave të bakrit në Spaç. Sipas informacionit të disponueshëm në internet (Qasja e fundit më 24 nëntor 2023 - <http://tetealb.com/spac.php> and http://www.port724.com:8080/images/site/198384/documents/1415238071/TETE_ALBANIA_consultant_report.pdf), Spaçi është “një nga minierat më produktive në zonë me një tunel aktiv prej 12 km dhe rreth 3 milionë tonë rezerva të rikuperueshme për nxjerrje”, ku kompania planifikon të nxjerrë 3,6 milionë tonë minerale. Për kryerjen e operacioneve minerare, TeteAlb ka kryer punime tokësore për kampin dhe ka ngritur objekte të kryerjes së proceseve, që janë të dukshme nga zona monumentale e Spaçit.

Hyrja në kantierin e operacioneve minerare dhe transporti i materialeve dalëse kërkon kalimin e karrexhatës që përkrah zonën e mbrojtur me urdhrin nr. 241, 23/06/2015 të Ministrisë së Kulturës, duke paraqitur kështu një problem potencial nëse trafiku i aksesit të vizitorëve në kantier do të rritet pa u organizuar mirë.

Që nga marrja e lejes, TeteAlb ka kryer aktivitete mirëmbajtjeje në rrugën e pashtuar që lidh impiantet e saj me daljen Reps të autostradës.

6. Vizioni dhe objektivat

Takimet konsultative të zhvilluara zbuluan një mbizotërim të konsiderueshëm të aspekteve dhe pritshmërive të përbashkëta në lidhje me mënyrat e konservimit të ndërtesave dhe rrënojave të

mbetura dhe vizionin për të ardhmen e zonës së mbrojtur; u vlerësuan dhe u morën në konsideratë edhe opinione më pak të përhapura. Të gjitha provat e mbledhura u analizuan dhe u peshuan nga grupi i punës sipas ekspertizës së tij në një sërë sektorësh (legjislacioni, arkitektura, menaxhimi kulturor, interpretimi i trashëgimisë, administrata publike, historia, bashkëpunimi ndërkombëtar), përvoja e mëparshme krahasuese në fushën e menaxhimit të trashëgimisë dhe zhvillimit, si dhe gjykimi në lidhje me fizibilitetin, cilësinë dhe potencialin e ndikimit.

Përfundimisht, tre opsione të memorializimit rezultuan të zbatueshme dhe iu nënshtruan diskutimit dhe shqyrtimit të thellë, siç paraqitet në *Aneksin D: Skenarët e analizuar të memorializimit*. Paragrafët që vijojnë paraqesin vizionin dhe objektivat që i referohen opsionit të memorializimit, duke u dëshmuar si më i përshtatshmi për të pozicionuar Spaçin si një Sit aktiv kujtese dhe edukimi.

A. Deklarata e vizionit

Ish-burgu dhe kampi i punës së detyruar i Spaçit, i perceptuar tashmë si një Sit kujtese për shkak të rëndësisë së tij të jashtëzakonshme në përkujtimin e persekutimit dhe shkeljes së të drejtave të njeriut gjatë diktaturës komuniste në Shqipëri, do të ruhet në mënyrë aktive për brezat e ardhshëm përmes aktiviteteve konservuese që do të lejojnë vizita të sigurta dhe të informuara të zonës së mbrojtur.

Muzeu i Spaçit do të kontribuojë më tej në ruajtjen e kujtesës së rezistencës gjatë diktaturës komuniste. Ai do të tregojë përpjekjet dhe historitë e rezistencës që kanë ndodhur në Spaç, që nga episodi themelor i Revoltës së Spaçit në 1973, deri te aktet dhe gjestet e shumta të përditshme të rezistencës kundër humbjes së njerëzimit, dinjitetit dhe solidariteti që iu imponua të burgosurve. Muzeu do të shërbejë si një platformë për aktivitete edukative, programe publike dhe rrjete ndërkombëtare.

B. Përafrimi me Strategjinë Kombëtare të Kulturës

Rehabilitimi i Spaçit shpaloset në koherencë me Strategjinë Kombëtare të Kulturës 2019-2025, dokumenti strategjik më i rëndësishëm i hartuar nga Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë. Në veçanti, projekti ambicioz i rikuperimit të monumentit të braktisur dhe të zonës përreth do të kontribuojë në *Objektivin Specifik 2 – Rehabilitimi i trashëgimisë arkitekturore dhe peizazhit duke rritur numrin e monumenteve të rehabilituara, të lidhura me Objektivin e Politikës 2: ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimi kulturore materiale dhe jomateriale*.

Aktivizimi i ardhshëm i Spaçit si një vend dialogu dhe veprimi do të mundësojë gjithashtu adresimin e:

- *Objektivit specifik 3 – Ndërkombëtarizimi i vlerave të artit dhe trashëgimisë kulturore:* falë aktiviteteve të shumta me rezonancë ndërkombëtare kushtuar ndërgjegjësimit, pjesëmarrjes së të rinjve dhe prodhimit kulturor që po zhvillohen tashmë në Spaç dhe do të forcohet për të promovuar vlerën e sitit si platformë për promovimin e të drejtave të njeriut dhe kuptimin e tipareve të përbashkëta të historisë së vendeve që kanë vuajtur gjatë regjimeve komuniste, kryesisht në Evropën Qendrore dhe Lindore.
- *Objektivit specifik 5 – Edukimi përmes Kulturës:* që në vitet në vijim synohet të përmirësohet shtrirja gjeografike e programit duke zgjeruar mundësitë që ofrojnë institucionet kulturore jashtë kryeqytetit të Tiranës.

C. Vizioni për ruajtjen e Monumentit

Spaçi tashmë perceptohet dhe do të vazhdojë të jetë një vend kujtimi dhe reflektimi personal dhe kolektiv.

Do të ndërmerren veprime për të ndalur përkeqësimin e shpejtë si pasojë e viteve të neglizhencës, ekspozimit ndaj elementeve dhe vjedhjeve dhe dëmtimeve të shpeshta të pronës.

Për sa i përket modus operandi, do të ndërmerren veprime për të rikthyer ndërtesat në gjendjen e mëparshme, siç kanë qenë kur u mbyll reparti i riedukimit në vitin 1991 (p.sh. restaurimi i dyerve dhe dritareve, rindërtimi i ballkoneve, etj.), por do të kryhen punime konservimi, për t'i ruajtur ato në mënyrë të tillë që të dëshmojnë këto tre dekada në të cilat shoqëria shqiptare është përpjekur të pajtohet me historinë e saj më të fundit dhe të dhimbshme, në të cilën shenjat e kalimit të kohës mbi ndërtesa janë gjithashtu një metaforë për një distancim nga kujtesa e vendit, ose rrezik për humbje të kësaj kujtese.

Në këtë kuptim, ish kompleksi i burgjeve që mbrohet sipas urdhrit nr. 241, 23/06/2015 do t'i nënshtrohet masave stabilizuese për të shmangur humbje të mëtejshme fizike dhe masave konsoliduese për të siguruar aksesin e duhur dhe të sigurt në ndërtesat e mbetura - ose një pjesë të tyre. Më shumë detaje mbi masat e sugjeruara janë raportuar në *Aneksin E: Udhërrëfyesi i konservimit*.

Vizitorët e synuar të mundshëm mendohet se bëjnë pjesë në kategoritë e mëposhtme:

- Grupet e shkollave lokale/kombëtare;

- Familje, grupe të organizuara lokale/kombëtare
- Grupe të organizuara të huaja, turistë kulturorë individualë

Të gjithë ata që kanë interes për historinë e fundit ose ndërgjegjësim për rëndësinë e ruajtjes së kësaj trashëgimie si një paralajmërim për brezat e ardhshëm.

Lidhur me disa nga elementët që besohet se janë kyç për të kuptuar se si ndihej jeta në Spaç për ata që do të humbnin lirinë dhe ndonjëherë edhe jetën e tyre, atje, do të rindërtohen pjesërisht: në ndërtesat e fjetjes, një nga qelitë e burgut do të rikrijohet në formën e një kapanoni fjetje trekatëshe me 54 shtretër kashte, organizimi i qelive që mbahet mend më së shumti në rrëfimet e ish-të burgosurve, megjithëse aspekti i tyre ndryshoi me kohën.

Gjithashtu do të rikrijohet edhe peizazhi zanor i kampit: do të vendosen dhe aktivizohen folësit me raste të veçanta dhe në rastin e tureve me guidë, për të transmetuar propagandën politike dhe lajmet festive që u vendoseshin të dënuarve.

Do të vendoset edhe një tabelë me përshkrime, për të informuar vizitorët, ku jepet informacion kontekstual dhe historik. Mjete të tjera informuese që do të zhvillohen përfshijnë një udhëzues audio, që mund të shkarkohet lirisht, me Kode QR të vendosura në tabelë, që të jep informacion më të thelluar dhe një aplikacion Realiteti i Shtuar i krijuar për të shfaqur pjesët e munguara të sitit dhe evoluimin e tij me kohën, si pjesë të gardhit me tela me gjemba, kullat e vrojtimit, porta e kampit dhe qelitë e izolimit.



Figura 4: Shembujt e interpretimit në Sitin e kujtesës të Spaçit

Grupi i ndërtesave në zonën punëtorëve të lirë do të jetë objekt i aktiviteteve të konservimit duke mundësuar vizita të sigurta, dhe pjesë të katit përdhës do t'i dedikohen krijimit të tualeteve për vizitorët dhe një strehe në rast moti të pafavorshëm. Gjithashtu, këtu mund të krijohet një venddepozitimi i materialeve për mirëmbajtje periodike.

Në përgjithësi, për të siguruar mbrojtjen e pronës nga bagëtia dhe faktorë të tjerë të mundshëm dëmtues, do të vendoset një rrethim.

Përtej zonës së mbrojtur, dy elementë të tjerë janë të rëndësishëm për të mundësuar një kuptim të plotë të Spaçit dhe ruajtjen e vlerave të tij. E para është zona e minierave, e cila dikur përfshinte disa galeri dhe zona shfrytëzimi, në të cilat të burgosurit mbërrinin duke ecur në një shteg direkt nga kampi; Falë disponueshmërisë së treguar nga kompania koncesionare e impianteve minerare, do të nënshkruhet një marrëveshje për të kaluar përgjegjësinë e galerisë më të afërt nga Tete Mining tek Ministria e Kulturës dhe për ta bërë pjesën hyrëse të galerisë të aksesueshme për vizitorët, nën mbikëqyrje.

E dyta është rruga që të çon nga Repsi deri në Sit, e cilësuar shpesh si "itinerari i dhimbjes dhe keqardhjes", ose "rruga e lotëve", e cila do të mbahet në gjendjen e një rruge të pashtuar, me dhe,

në segmentin e saj të fundit (rreth 1 km), për të transmetuar një pjesë të asaj ndjenje që do të përjetonin të dënuarit e ardhshëm dhe familjet e tyre duke iu afruar Spaçit.

Të gjitha zgjedhjet e detajeve në lidhje me aktivitetet e konservimit dhe rikonstruktimit të elementeve kyç dhe interpretimin e sitit do të jenë objekt i tenderave specifik, siç do të ilustruhet më tej në kapitullin 8. *Plani i veprimit.*

Hyrja në zonën muzeale do të jetë falas për të gjithë vizitorët, për dy arsye kryesore:

- Socio-politike: Siti i kujtesës Spaç është një trashëgimi e përbashkët; pas shumë vitesh neglizhence, ekziston një kërkesë e përbashkët për të stimuluar dhe lehtësuar vizitën në vend si një mjet për të mësuar rreth historisë së fundit të Shqipërisë dhe për të nderuar kujtimin e ish të burgosurve;
- Ekonomike: duke qenë se Siti ndodhet në një zonë të largët, vizitorët potencial duhet të planifikojnë shpenzime të konsiderueshme udhëtimi për të realizuar një vizitë në Spaç. Kjo do të thotë që, nëse do të vendosej një biletë hyrëse në Sit, vlera e saj duhet të jetë e përmbajtur dhe e ulët (maksimumi 2 euro).

Mundësia e të ardhurave kundrejt kostove nuk lejon të parashikohet një pikë barazimi midis të ardhurave nga shitja e biletave dhe kostos së biletave.

Përlllogaritja e të ardhurave është 8000 euro (4000 vizitorë që paguajnë në vit, me 2 euro për biletë) ndërsa përlllogaritja e kostove të biletave është 12 500 euro (kostoja e personelit, plus kostot e trajtimit të shërbimeve të biletave).

D. Vizioni për krijimin e Muzeut të Spaçit.

Krijimi i një Muzeu të Spaçit është përkrahur për shumë vite nga disa aktorë të shoqërisë civile shqiptare, në radhë të parë nga ish-të burgosurit. Ngritja e këtij Muzeu, e lidhur ngushtë me detyrimin e konservimit të godinave të ish-burgut, vlerësohet si një angazhim dhe përgjegjësi e rëndësishme e institucioneve publike të Shqipërisë në përkujtimin dhe transmetimin e së shkuarës. Vizioni që do të ndiqet parashikon krijimin e një muzeu kushtuar rezistencës gjatë diktaturës komuniste, me fokus jetën dhe dëshmitë e të burgosurve ose të vdekurve dhe familjeve të tyre. Edhe pse një reflektim mbi dhunën dhe vuajtjen do të jetë thelbësor, fokusi i muzeut do të jetë në përpjekjet dhe historitë e rezistencës që kanë ndodhur në Spaç, që nga episodi themelor i Revoltës së Spaçit në 1973, deri te aktet dhe gjestet e shumta të përditshme të rezistencës kundër humbjes së njerëzimit, dinjitetit dhe solidariteti që iu imponua të burgosurve. Në të gjitha fazat e zhvillimit të Muzeut, siç ilustruhet më tej në Kapitullin 8. *Plani i veprimit*, ish të burgosurit do të përfshihen në

mënyrë aktive, qoftë për shkak të një detyrimi morale, pasi përfaqësimi i një pjese të së kaluarës së tyre është në rrezik, por dhe sepse miratimi prej tyre i projektit do të përbëjë një ndryshim thelbësor në mënyrën se si do të funksionojë Muzeu, në atë që do të shfaqë, në aktivitetet që do të promovojë.



Figura 5: vendndodhja e Muzeut të ardhshëm të Spaçit dhe lidhja me Sitin e kujtesës të Spaçit

Vendndodhja gjeografike e Muzeut është parashikuar në Bashkinë Mirditë, në Reps, në afërsi të daljes së autostradës kombëtare dhe në një vendndodhje e cila do të përcaktohet me saktësi në vijim të diskutimeve mes Ministrisë së Kulturës dhe Bashkisë Mirditë. Do të përdoret toka shtetërore për të shmangur kostot e blerjes. Këshillohet që të vendoset një shërbim autobusi midis Muzeut dhe Sitit, për të mundësuar udhëtimin e sigurt të vizitorëve dhe për të bërë të mundur që Muzeu të ofrojë vizita të shoqëruara me guidë.

Kjo vendndodhje në Reps, që lindi nga sugjerimi i një dyshe aktorësh të konsultuar (shihni *Aneksin D: Dëshmi nga konsultimet me grupet e interesit*), duket se ka përparësi të shumta në krahasim me ngritjen e një muzeu në vetë Sitin e Spaçit:

- Vizibilitet dhe kapacitet më i mirë i tërheqjes së vizitorëve;

- Mundësi aksesit edhe për ata vizitorë që për shkak të kushteve të rrugës nuk do të ndiheshin rehat të shkonin me makinë deri te ish-burgu i Spaçit. Dhe ky mund të jetë edhe rasti i grupeve të shkollave, të cilët do të kenë vështirësi për të hyrë në zonë me autobus;
- Ndikim më i ulët në integritetin e përgjithshëm të pronës së Spaçit;
- Mundësia për të shërbyer si pikë informimi dhe edukimi edhe për ish-burgun e Qafë-Bari dhe për të qenë pjesë e itinerareve të vizitorëve në atraksione të tjera në Mirditë;
- Mundësia e ofrimit të shërbimit adekuat të transportit nga muzeu (i aksesueshëm nëpërmjet rrugës së asfaltuar) deri në Spaç, duke reduktuar kështu përdorimin e automjeteve private dhe duke organizuar fluksin e trafikut në një mënyrë të përputhshme me mjetet e transportit të minierës;
- Mundësi për të kryer një ndërhyrje arkitekturore të nivelit të lartë, që gjithashtu mund të përbëjë atraksion për vizitorët.

Ndaj, vendosja e muzeut të ardhshëm në Reps është rezultat i vlerësimeve që kanë marrë parasysh mundësinë e tërheqjes së vizitorëve, rritjen e qëndrueshmërisë financiare të muzeut të ardhshëm dhe respektimin e autenticitetit dhe integritetit të zonës muzeale. Megjithatë, paragrafët e mëposhtëm përshkruajnë elementë që lidhen me muzealizimin dhe përvojën e vizitorëve që janë gjithashtu të zbatueshëm nëse muzeu ndodhet diku tjetër.

Tre tipologji objektesh do të jenë pjesë e koleksionit të muzeut:

- Material historik dhe kontekstual për të rrëfyer historinë e burgut dhe kampit të punës së detyruar të Spaçit, evolucionin e tij ndër vite dhe faktet dhe shifrat kryesore që lidhen me të, duke përfshirë rrëfimet për Revoltën e Spaçit;
- Dëshmi nga ish të burgosurit, në formën e regjistrimeve video dhe audio, vizatime ose forma të tjera të rrëfimeve personale, të mbledhura gjerësisht me kalimin e kohës nga institucionet dhe organizatat e kujtesës që kanë shprehur paraprakisht vullnetin për t'ia dhuruar muzeut të ardhshëm;
- Punime artistike dhe artizanale (fletore të shkruara me dorë, piktura, artefakte, etj.) të krijuara nga ish të burgosur politikë, të cilët dëshirojnë t'i dhurojnë këto objekte si dëshmi se si ndikoi burgosja dhe u pasqyrua në veprat e tyre personale.

Forma e shfaqjes do të integrojë objekte origjinale fizike me dokumentacione ose riprodhime dixhitale, duke tërhequr audiencën më të larmishme. Një projekt i detajuar për muzealizim duhet të jetë objekt i një konkursi konceptual, siç do të ilustruhet më tej në *Kapitullin 8. Plani i veprimit*.

Për të hyrë në muze duhet të blihet biletë e plotë prej 7 euro për të rriturit mbi 25 vjeç dhe një biletë e pjesshme prej 3 euro për të rinjtë e moshës 18 deri në 25 vjeç; hyrja për fëmijët dhe të rinjtë nën 18 vjeç dhe për ish të burgosurit do të jetë falas. Një udhëzues audio i shkarkueshëm lirisht duhet të ofrohet si pjesë e biletës së hyrjes.

Për të siguruar që Muzeu të përmbushë misionin e tij edukativ, do të ofrohen aktivitete të posaçme, veçanërisht për atë që perceptohet se do të jetë një nga grupet kryesore të vizitorëve: shkollat. Këto do të marrin formën e seminareve në terren, aktiviteteve përgatitore në internet, si dhe rasteve të takimeve dhe dëshmime të drejtpërdrejta me ish të burgosurit.

Muzeu do të ofrojë në baza të rregullta (gjatë fundjavave) vizita me guidë, duke rritur kështu potencialin edukativ të ofruar nga muzeu. Një shërbim i mëtejshëm që do të ofrohet, është një vizitë e kombinuar e Muzeut dhe ish-burgut të Spaçit, duke përfshirë transportin deri në zonë. Parashikimi ekonomik i lidhur me këto shërbime është paraqitur në *Aneksin G: Plani i biznesit*.

Muzeu i ardhshëm i Burgut dhe Kampit të Punës së Detyruar të Spaçit do të pozicionohet në rrjete të shumta kombëtare dhe ndërkombëtare, formale dhe informale. Brenda vendit, ai do të krijojë bashkëpunim me muzetë e tjerë kushtuar përkujtimit të komunizmit, kryesisht Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës, që ndodhet në Shkodër dhe Muzeu i Shtëpisë së Gjetheve, që ndodhet në Tiranë. Ai gjithashtu do të ofrojë bashkëpunim për aktivitete kërkimore, ndërgjegjësuere dhe edukative që do të zhvillohen me institucione dhe organizata të specializuara. Siç shpjegohet më mirë në paragrafin 4.C *Vlera për shoqërinë shqiptare*, këta aktorë janë shumë aktivë në organizimin e iniciativave periodike që rrisin kuptimin dhe njohuritë e qytetarëve për Spaçin: Muzeu do të funksionojë si promovues dhe organizues i aktiviteteve, për të favorizuar vazhdimësinë dhe rritjen e tyre me kalimin e kohës.

Pozicionimi në nivel ndërkombëtar do të ketë të bëjë potencialisht me rrjetin e Siteve të Ndërgjegjes, Itinerarin e Çertifikuar Kulturor të Këshillit të Evropës ATRIUM - Arkitekturën e Regjimeve Totalitare në Memorian Urbane të Evropës, Rrjetin Evropian të Kujtimit dhe Solidaritetit. Muze të ndryshëm në të gjithë Evropën ndodhen në ndërtesat e ish-burgut, në ish-kampet e punës së detyruar ose në afërsi të tyre, duke ofruar kështu mundësi të gjera për zhvillimin e projekteve të përbashkëta, financimin dhe aktivitetet shkencore. Në rast të bashkëpunimit të gjerë të ish-të burgosurve për të dhuruar vepra arti dhe artizanale që dëshmojnë për historinë e tyre personale në koleksionin e muzeut, muzeu mund të konsiderojë gjithashtu aplikimin në programin e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s.

E. Vizioni i zhvillimit territorial

Zhvillimi i ardhshëm i Spaçit si një zonë muzeale dhe një muze i mirëadministruar ofron mundësi për zhvillimin territorial të Mirditës, ku Bashkia ka investuar, e mbështetur nga donatorë ndërkombëtarë, në nismat për rritjen e turizmit të qëndrueshëm. Në këtë këndvështrim, është e rëndësishme të adoptohet një qasje e menaxhimit të integruar që lidh trashëgiminë kulturore me zhvillimin e qëndrueshëm territorial dhe turistik, duke identifikuar mundësitë e përforcimit dhe kontributit të ndërsjellë midis këtij plani menaxhimi dhe dokumenteve të tjera strategjike dhe veprimeve me interes për zonën.

Tre mundësi duken veçanërisht të rëndësishme:

- Promovimi i vizitave në ish-burgun dhe kampin e punës të Qafë Barit, i cili ka disa elementë të përbashkët me Spaçin: ai u ngrit në një zonë të thellë për të shfrytëzuar punën e të burgosurve politikë dhe ishte vendi i një Revolte të të burgosurve, më 22 maj 1984, që u shtyp me gjak. Qafë Barit ndodhet afërsisht 20 kilometra larg Spaçit, mund të shkohet përmes një rruge të pashtuar (kushtet e së cilës duhet të përmirësohen) ose duke rihapur shtegun e ecjes që lidh dy kampet, duke vendosur shenja dhe sinjalistikë dhe duke prodhuar harta. Në veçanti, duke marrë parasysh vlerën e madhe natyrore dhe peizazhore të zonës, mund të krijohet dhe promovohet një Itinerar i Kujtesës dhe Rezistencës;
- Meqenëse eko-turizmi është në rritje në Mirditë, shtigjet e ecjes apo çiklizmit që lidhin Spaçin me monumentet e tjera natyrore mund të merren në konsideratë, pasi mali i Munellës mund të jetë objekt promovimi specifik, në bashkëpunim me akomodimet në zonë;
- Kombinimi i vizitës në Spaç me vizita në atraksione të tjera të zonës, në veçanti vende kulti dhe me interes historik e artistik si Manastiri i Rubikut dhe Kisha e Shën Aleksandrit të Oroshit. Këto vende janë tashmë një destinacion për besimtarët katolikë, të cilët shpesh marrin pjesë në vizita në grup të promovuara nga dioqezat, aktorë që janë treguar aktivë në ruajtjen e gjallë të kujtimit të Spaçit dhe të klerikëve që u burgosën atje.

F. Vizioni i zhvillimit të kapacitetit

Zbatimi i përgjithshëm i këtij vizioni për ruajtjen dhe zhvillimin kërkon kompetenca të shumta dhe të avancuara, që mbulojnë detyrat ligjore, administrative, konservuese, menaxhuese kulturore, si dhe planifikimin me pjesëmarrje, menaxhimin e integruar dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

Të gjitha këto kompetenca tashmë i kanë institucionet kombëtare shqiptare të kulturës dhe transferimi i tyre tek organi drejtues i sapokrijuar duhet të shoqërohet nga një rrugë specifike për

zhvillimin e kapaciteteve, e cila do të jetë objekt i një planifikimi të detajuar pas krijimit të fondacionit, siç ilustrohet më tej në *Kapitullin 8. Plani i veprimit*.

Tre drejtime të ndërtimit të kapaciteteve duken veçanërisht të rëndësishme:

- Një drejtim për stafin praktikues të menaxhimit kulturor të Fondacionit, me qëllim rritjen e potencialit për mbledhjen e fondeve për aktivitetet e bashkëpunimit trans-kombëtar ose rrjetëzimit, për sa i përket hartimit të projekteve për pjesëmarrje në thirrjet ndërkombëtare për financim, zhvillimin e kanaleve të drejtpërdrejta të komunikimit me donatorët, menaxhimin e projektit, raportimin teknik dhe financiar;
- Një drejtim për stafin e dedikuar për pritjen e vizitorëve, aktivitetet edukative dhe për prodhimin e ngjarjeve kulturore, të cilët ka të ngjarë të punësohen nga popullsia vendase e Mirditës. Nevoja për një ngritje të tillë kapacitetesh u theksua nga institucionet vendore si një hap themelor për përgatitjen e anëtarëve të komunitetit lokal për t'u bërë punonjës dhe bashkëpunëtorë të përshtatshëm të ardhshëm të organit drejtues;
- Një drejtim për individët dhe bizneset vendase që operojnë në sektorin e turizmit dhe aktivitetet e lidhura ngushtë me të, për të rritur ndikimet ekonomike të lidhura me praninë e Spaçit duke ofruar shërbime cilësore dhe duke qenë ambasadorë aktivë, nëpërmjet punës së tyre dhe marrëdhënieve të tyre me vizitorët, në territorin e Mirditës.

G. Objektivat



Për të arritur këtë vizion ambicioz, plani i menaxhimit parashikon zbatimin e aktiviteteve për ndjekjen e tre objektivave të qarta gjatë një harku pesë vjeçar, ku secila prej tyre lidhet ngushtësisht me një fazë kohore dhe lejon të bëhet një hap specifik përpara drejt arritjes së funksionimit të plotë dhe Spaçit.

H. Përmbledhje

Për ta përmbledhur, vizioni për ruajtjen dhe zhvillimin e ish-burgut dhe kampit të punës së detyruar të Spaçit parashikon veprimet e mëposhtme:



MONUMENTI

- Spaçi të mbetet një vend kujtimi dhe reflektimi
- Ruajtja e statusit të konservimit në gjendjen "siç është"
- Diskutim dhe ftesë për projektim, për rindërtimin e pjesshëm të disa prej elementeve kyç
- Rikrijimin i njërës prej qelive
- Krijimi i rrethimit të perimetrit
- Rikuperimi i shtegut që çon në miniera dhe i njërës prej hyrjeve të tunelit
- Mirëmbajtja në gjendjen aktuale të pjesës së fundit të rrugës hyrëse
- Krijimi i një sinjalistike me ndriçim dhe me shpjegime interpretuese në vend
- Përdorimi i AR për të shfaqur pjesët e munguara të sitit dhe evoluimin e tij me kohën
- Hyrja falas.



MUZEU

- Muze i vogël kushtuar rezistencës ndaj diktaturës komuniste
- Në të gjitha fazat e zhvillimit duhet të përfshihen në mënyrë aktive ish të burgosurit
- Vendndodhja në Reps
- Koleksion që përfshin tre tipologji objektesh: material historik, kontekstual dhe sfond; dëshmitë e ish të burgosurve; vepra artistike dhe artizanale të krijuara nga ish të burgosurit politikë;
- Konkursi ndërkombëtar për dizajnin e muzeut
- Hyrja në muze me kategori të ndryshme bilete dhe falas për ish të burgosurit dhe fëmijët
- Oferta e aktiviteteve edukative: workshope në terren, vizita me guidë, etj. ...
- Ofrimi i shërbimit të transportit për në Sitin e Spaçit
- Bashkëpunimi me muzetë e tjerë kombëtarë kushtuar kujtimit të komunizmit
- Bashkëpunim për aktivitete kërkimore, ndërgjegjësuere dhe edukative me institucione dhe organizata të specializuara duke promovuar dhe lehtësuar aktivitetet e tyre
- Anëtarësimi në rrjetin e Siteve të Ndërgjegjes, Itinerarin e Çertifikuar Kulturor të Këshillit të Evropës ATRIUM - Arkitekturën e Regjimeve Totalitare në Memorian Urbane të Evropës, Rrjetin Evropian të Kujtimit dhe Solidaritetit.
- Marrja në konsideratë e aplikimit në programin e UNESCO-s Memory of the World.



ZHVILLIMI I TERRITORIT

- Metoa e manexhimit të integruar
- Promovimi i vizitës në ish-burgun dhe kampin e punës së detyruar të Qafë Barit, duke përmirësuar rrugën ekzistuese të pashtuar ose duke rihapur shtegun e ecjes në këmbë; krijimi i një itinerari të kujtesës dhe qëndresës
- Kujdesi për eko-turistët duke ofruar shtigje për ecje në këmbë ose me biçikletë që lidhin Spaçin me monumentet e tjera natyrore
- Kombinimi i vizitës në Spaç me vizita në atraksione të tjera të zonës, në veçanti vende kulti dhe me interes historik dhe artistik si Manastiri i Rubikut dhe Kisha e Shën Aleksandrit, Orosh.



NGRITJA E KAPACITETEVE

- Rritja e kapaciteteve për mbledhjen e fondeve për praktikuesit e menaxhimit të kulturës
- Përgatitja e anëtarëve të komunitetit lokal për t'u bërë në të ardhmen punonjës dhe bashkëpunëtorë të përshtatshëm të organit drejtues
- Rritja e ndikimeve ekonomike në turizëm dhe sektorët e lidhur me të.

7. Administrimi i pasurisë kulturore të paluajtshme

A. Pronësia e ardhshme

Sipas Ligjit për Trashëgiminë Kulturore ("TK"), Ministria e Kulturës propozon kalimin e pasurive kulturore të paluajtshme që gëzojnë statusin "me rëndësi universale, vendore ose kombëtare" në pronësi shtetërore, në administrim institucioneve publike të qeverisjes qendrore, të qeverisjes vendore dhe subjekteve juridike të themeluara prej tyre, me qëllim miratimin, vlerësimin dhe kryerjen e veprimtarive përkatëse konservuese e mbrojtëse të vlerave kulturore.

Procedura e kalimit përcaktohet në një udhëzim të posaçëm të Ministrisë së Kulturës (Udhëzim nr. 583, datë 14.10.2019) dhe kalimi në administrim miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Palët e interesuara që morën pjesë në raundin e parë të procesit të konsultimit kanë këshilluar kryesisht që prona t'i kalojë Ministrisë së Kulturës.

B. Modeli i menaxhimit të qëndrueshëm dhe funksional

Menaxhimi i Zonës

Modeli i menaxhimit indirekt

Pas shqyrtimit të hollësishëm të skenarëve të mundshëm të menaxhimit, të paraqitur në *Aneksin B: Nga vlerësimi i opsioneve të skenarëve të menaxhimit njëkohësisht me legjislacionin përkatës të zbatueshëm*, rezultoi se modeli i menaxhimit që përshtatet më mirë në aspektin e qëndrueshmërisë dhe funksionalitetit është ai i një Fondacioni të krijuar nga një institucion i specializuar për trashëgiminë kulturore, pra që mund të jetë Fondacioni për kujtesën e rezistencës në Spaç.

Veprimi A.3.4	Punësimi i personelit për detyrat fillestare, duke përfshirë personelin administrativ për tenderët, arkitektët për të mbikëqyrur punimet e konsolidimit dhe mirëmbajtjes	Punësimi i personelit me aftësitë dhe përvojën e kërkuar përkatëse për secilin rol përkatës brenda harkut kohor të caktuar Fillimi i suksesshëm i aktiviteteve në lidhje me punimet e konsolidimit dhe pjesëmarrjen në tendera ndërkombëtarë Respektimi i programeve dhe buxheteve të përcaktuara nga Fondacioni për konsolidimin e sitit dhe hapjen e ardhshme të muzeut.	- Numri i stafit të punësuar; - Përqindja e pozicioneve të zëna nga persona me aftësitë dhe përvojën e kërkuar; - Numri i aktiviteteve të konsolidimit të filluara - Norma e respektimit të planeve dhe buxheteve të konsolidimit
Veprimi A.3.5	Identifikimi i vendndodhjes për zyrat operative, të cilat mund të shërbejnë gjithashtu si një zyrë e përkohshme në pritje të hapjes së muzeut	Identifikimi i suksesshëm i vendndodhjes së zyrës që plotëson kërkesat operationale brenda harkut kohor të caktuar.	- Zyra operationale e disponueshme

		REZULTATET E PRITSHME	TREGUESIT
Veprimi A.3.6	Planifikimi i iniciativave për ngritjen e kapaciteteve	- Identifikimi i përfituesve të synuar - Përcaktimi i objektivave të ngritjes së kapaciteteve - Sigurimi i burimeve - Përcaktimi afateve kohore të detajuara	- Numri i përfituesve të synuar të identifikuar; - Numri i objektivave të përcaktuara; - Shkalla e suksesit të sigurimit të burimeve; - Numri i mekanizmave të përcaktuar të monitorimit dhe vlerësimit
FAZA E ZHVILLIMIT			
<i>Objektivi B</i>	Promovimi i frekuentimit të sitit dhe hapja e Muzeut		
Komponenti B.1:	Interpretimi dhe përvoja e vizitorëve në Spaç		
Veprimi B.1.1	Kryerja e tenderit ndërkombëtar	Përzgjedhja e suksesshme dhe në kohë e organizatave të kualifikuara përmes procesit të tenderit të hapur për të siguruar zhvillimin e përvojës më tërheqëse dhe informative të mundshme të vizitorëve	- Numri i propozimeve novatore të pranuar; - Numri i organizatave të kualifikuara të përzgjedhura; - Përqindja e pajtueshmërisë së organizatave pjesëmarrëse me kriteret e paracaktuara
Veprimi B.1.2	Përzgjedhja e projektit përmes procesit konsultativ	Rritja e angazhimit të palëve të interesuara dhe përfaqësimi i balancuar i perspektivave dhe ekspertizës së ndryshme midis pjesëmarrësve	- Numri i konsultimeve me palët e interesuara; - Numri i grupeve të palëve të interesuara të përfaqësuara
Veprimi B.1.3	Vendosja e mjeteve informuese në sit	- Vendosja e instalimeve dhe shënuesve në mënyrë strategjike në të gjithë sitin për të udhëhequr vizitorët përgjatë itinerarit të caktuar dhe për të përmirësuar informimin e tyre mbi pikat kyçe të interesit; - Përkthimi i materialeve interpretuese në shumë gjuhë për t'iu përgjigjur një audience me diversitet, duke siguruar akses dhe një përvojë më të pasur për të gjithë vizitorët; - Krijimi i versioneve të përmbajtjes interpretuese që janë të arritshme për individët me aftësi ndryshe, duke përfshirë ekranet me prekje, udhëzuesit	- Numri i instalimeve dhe shënuesve të vendosur; - Numri i versioneve të përmbajtjes së aksesueshmërisë të zhvilluara; - Numri i elementeve interaktiv të instaluar; - Respektimi i afatit të përfundimit

		REZULTATET E PRITSHME	TREGUESIT
		audio dhe materialet braille; - Integrimi i elementeve interaktive si ekranet me prekje, prezantimet multimediale ose stacionet interaktive që u mundësojnë vizitorëve të përfshihen në mënyrë aktive me përmbajtjen.	
Veprimi B.1.4	Rikrijimi i hapësirave/elementeve kyçe	- Përvoja e zgjeruar e vizitorëve dhe kuptimi dhe vlerësimi më i madh i rëndësisë së tij historike; - Rindërtimi i hapësirave/elementeve kyçe në përputhje me pritshmëritë e ish të burgosurve dhe integritetin historik të vendit.	Numri i elementeve kyçe të rindërtuara
Veprimi B.1.5	Krijimi i udhëzuesve audio dhe aplikacioni i realitetit të shtuar	- Krijimi i skripteve audio-udhërrëfyes që përputhen me rrëfimet e turit, regjistrimi i narratorëve profesionistë dhe/ose ish të burgosurve dhe redaktimi i përmbajtjes audio me cilësi të lartë për t'u përdorur në turet me guidë; - Ofrimi i përkthimit dhe mbështetjes për shumë gjuhë si në udhëzuesit audio ashtu edhe në aplikacionin AR për t'u kujdesur për vizitorë me kombësi të ndryshme	- Numri i narrativave të zhvilluara në udhëzuesit audio; - Numri i elementeve interaktive AR; - Përqindja e mbulimit të Sitit në aplikacionin e realitetit të shtuar; - Numri i gjuhëve audio të ofruara
Veprimi B.1.6	Promovimi i Sitit përmes filmave dhe dokumentarëve	- Perceptimi i rritur i publikut për sitin dhe vlerën e tij historike dhe kulturore; - Rritja e interesit turistik; - Krijimi i mundësive për partneritete dhe bashkëpunime me kineastët, kompanitë e prodhimit ose organizatat kulturore	- Numri i filmave dhe dokumentarëve të prodhuar; - Numri i partneriteteve dhe bashkëpunimeve të krijuara me kineastët, kompanitë e prodhimit ose organizatat kulturore; - Mbulimi gjeografik i përmbajtjes promovuese
Komponenti B.2:	Projektimi dhe zhvillimi i Muzeut		
Veprimi B.2.1	Kryerja e tenderit ndërkombëtar	Përzgjedhja e suksesshme dhe në kohë e organizatave të kualifikuara përmes procesit të tenderit të hapur për të siguruar që zhvillimi i Muzeut të vazhdojë siç është planifikuar	- Numri i propozimeve novatore të pranuara; - Numri i organizatave të kualifikuara të përzgjedhura; - Përqindja e

		REZULTATET E PRITSHME	TREGUESIT
			pajtueshmërisë së organizatave pjesëmarrëse me kriteret e paracaktuara
Veprimi B.2.2	Përzgjedhja e projektit përmes procesit konsultativ	Rritja e angazhimit të palëve të interesuara dhe përfaqësimi i balancuar i perspektivave dhe pritshmërive të ndryshme	- Numri i konsultimeve me palët e interesuara; - Numri i grupeve të palëve të interesuara të përfaqësuar
Veprimi B.2.3	Ndërhyrjet infrastrukturore	Përfundimi me sukses dhe në kohë i të gjitha ndërhyrjeve të nevojshme infrastrukturore, duke siguruar akses, siguri dhe komoditet të përgjithshëm për vizitorët	- Numri i ndërhyrjeve infrastrukturore të përfunduara; - Numri i përmirësimeve të sigurisë; - Respektimi i afatit të përfundimit
Veprimi B.2.4	Zhvillimi i koleksionit të Muzeut	Zhvillimi i suksesshëm i një koleksioni muzeor gjithëpërfshirës dhe të larmishëm, i kuar për të siguruar që ekspozitat e muzeut të jenë të pasura, të larmishme dhe përfaqësuese të kontekstit historik dhe perspektivave të përfshira	- Numri i artefakteve të mbledhura; - Indeksi i diversitetit të koleksionit; - Numri i palëve të interesuara të përfshira në zhvillimin e koleksionit të muzeut
Veprimi B.2.5	Punësimi i stafit shtesë	Kapaciteti i rritur operacional	Numri i stafit të ri të punësuar
Veprimi B.2.6	Zhvillimi i strategjisë së detajuar të muzeut, në koherencë me Planin e Menaxhimit	Zhvillimi i suksesshëm i një strategjie të detajuar muzeale që integrohet lehtësisht me Planin e Menaxhimit, duke siguruar një qasje të harmonizuar për arritjen e misionit dhe objektivave të muzeut	- Numri i objektivave strategjike të përcaktuar; - Numri i konsultimeve me palët e interesuara; - Respektimi i afatit për përgatitjen e strategjisë
Komponenti B.3:	Ngritja e kapaciteteve		
Veprimi B.3.1	Aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve për stafin e Fondacionit	Ekspertizë e zgjeruar në aktivitetet e lidhura me mbledhjen e fondeve dhe aftësi e rafinuar në hartimin e projekteve, e provuar nga një historik me propozime të suksesshme të projekteve dhe aplikimeve për grante; - Rrjeti i zgjeruar i partnerëve financues dhe mbështetja e shtuar nga një grup i ndryshëm donatorësh ndërkombëtarë; - Rritja e numrit të marrëveshjeve	- Numri i anëtarëve të trajnuar të stafit; - Shkalla e suksesit të projekt propozimeve; - Numri i aplikimeve të suksesshme për financim

		REZULTATET E PRITSHME	TREGUESIT
		dhe partneriteteve të bashkëpunimit të krijuara me subjektet ndërkombëtare; Njohje më e mirë e mekanizmave efektivë të monitorimit, së bashku me përmirësimin e aftësive të raportimit teknik dhe financiar.	
Veprimi B.3.2	Aktivitete për ngritjen e kapaciteteve për stafin lokal të angazhuar në shërbimet për vizitorët, aktivitetet edukative dhe ngjarjet kulturore	Rritja e angazhimit të komunitetit dhe ndjenjë më e madhe përkatësie për Spaçin në komunitetin lokal.	- Numri i seancave të zhvilluara për ngritjen e kapaciteteve; - Numri i stafit vendas të trajnuar; - Numri i aktiviteteve/programeve edukative të zbatuara dhe ngjarjeve kulturore të organizuara nga pjesëmarrësit
Veprimi B.3.3	Aktivitete për ngritjen e kapaciteteve për subjektet turistike vendase	Rritja e të ardhurave nga shërbimet e lidhura me turizmin dhe futja e shërbimeve të reja, përvoja unike, demonstrimi i kreativitetit dhe inovacionit në përbushjen e kërkesave dhe preferencave të vizitorëve	- Numri i seancave të zhvilluara për ngritjen e kapaciteteve; - Përqindja e pjesëmarrjes së subjekteve turistike vendase; - Numri i praktikave më të mira të ndara gjatë aktiviteteve të ngritjes së kapaciteteve që zbatohen me sukses nga subjektet vendore
FAZA OPERACIONALE			
Objektivi C	Pozicionimi i Spaçit si hapësirë për dialog dhe veprim		
Komponenti C.1:	Mirëmbajtja dhe aksesueshmëria e zonës muzeale		
Veprimi C.1.1	Mirëmbajtja e Zonës	Qëndrueshmëria afatgjatë e sitit dhe kushte të përmirësuara të sigurisë për të gjithë vizitorët	- Respektimi i planit të mirëmbajtjes
Veprimi C.1.2	Ndërhyrjet konservuese parandaluese	Qëndrueshmëria afatgjatë e sitit dhe kushte të përmirësuara të sigurisë për të gjithë vizitorët	- Numri i ndërhyrjeve parandaluese, konservuese, të zbatuara; - Ulja e kostos së mirëmbajtjes afatgjatë

		REZULTATET E PRITSHME	TREGUESIT
Veprimi C.1.3	Krijimi i bashkëpunimeve me administratën vendore dhe kompaninë minerare për aksesueshmërinë e zonës	Përmirësimi i aksesueshmërisë së sitit	- Numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit; - Numri i nismave të përbashkëta me administratën vendore dhe kompaninë minerare; - Përmirësime në aksesueshmërinë e Sitit
Veprimi C.1.4	Organizimi i transportit për në Sit	Përmirësimi i aksesueshmërisë së sitit	- Organizimi me sukses i transportit për në Sit; - Numri i udhëtimeve me shërbimin e transportit; - Respektimi i orareve të transportit
Komponenti C.2:	Programet edukative		
Veprimi C.2.1	Workshope në terren dhe aktivitete përgatitore online	- Zhvillimi i materialit gjithëpërfshirës të seminarit që përputhet me nevojat e identifikuar dhe identifikimi i mësuesve, edukatorëve dhe kontribuesve	- Numri i seminareve të realizuara; - Numri i mësuesve dhe edukatorëve të angazhuar
Veprimi C.2.2	Program i dedikuar për mësuesit	- Buletini i dedikuar për nismat shkollore në Spaç, i rezervuar për mësuesit e shkollave - Shpërndarje e materialeve edukative - Takime të posaçme dhe seminare diskutimi	- Numri i abonentëve të buletinit; - Numri i mësuesve pjesëmarrës në takime dhe seminare; - Rritja e ndërgjegjësimit të mësuesve për nismat në Spaç
Veprimi C.2.3	Vizita me guidë	Angazhimi më i madh i vizitorëve, duke ofruar një përvojë të pasur dhe informuese për të gjithë vizitorët e muzeut	- Numri i vizitave me guidë të kryera; - Indeksi cilësor që vlerëson nivelin e angazhimit të vizitorëve - Reagime nga pjesëmarrësit
Veprimi C.2.4	Takime rastësore me ish të burgosur	Informim më i mirë i vizitorëve mbi ngjarjet historike dhe historitë njerëzore pas tyre	- Numri i takimeve me ish të burgosurit; - Reagime pozitive nga vizitorët
Komponenti C.3:	Bashkëpunim me aktorë të tjerë vendas		
Veprimi C.3.1	Aktivitete promovuese të	- Lehtësimi dhe mbështetja logjistike për institucionet e kujtesës, organizatat, artistët,	- Numri i aktiviteteve të mbështetura dhe organizatat, artistët dhe

		REZULTATET E PRITSHME	TREGUESIT
	iniciuara nga aktorët vendas	OJQ-të, etj për organizimin e aktiviteteve tashmë të krijuara; - Mbështetje për vizibilitetin dhe komunikimin e aktiviteteve të palëve të interesuara brenda komunitetit dhe më gjerë, e evidentuar edhe nga një numër më i madh pjesëmarrësish ose përfituesish;	institucionet të kujtesës të mbështetura; - Numri i përfituesve të arritur
Veprimi C.3.2	Zhvillimi i ekspozitave të përbashkëta midis Spaçit dhe muzeumeve të tjera dhe zonave muzeale	Rritja e nivelit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përkatëse dhe angazhimi në adresimin e aspekteve historike dhe sociale të shtypjes politike brenda konteksteve të ndryshme;	- Numri i muzeve pjesëmarrëse dhe siteve të tjera të kujtesës; - Numri i ekspozitave të përbashkëta të zhvilluara
Veprimi C.3.3	Organizimi i eventeve dhe nismave publike	Zbatimi i një programi publik të aktiviteteve për ndërgjegjësimin, edukimin dhe promovimin e dialogut për kujtesën	- Numri i eventeve publike të organizuara; - Shkalla e pjesëmarrjes; - Indeksi cilësor që vlerëson ndikimin edukativ të ngjarjeve publike
Komponenti C.4:	Rrjetëzimi në nivel ndërkombëtar		
Veprimi C.4.1	Pjesëmarrja në rrjetet ndërkombëtare formale dhe joformale	- Rritja e pjesëmarrjes në rrjetet ndërkombëtare; - Rritja e njohurive për Spaçin dhe vizibiliteti i fituar përmes institucioneve partnere dhe rrjeteve ndërkombëtare.	- Numri i rrjeteve formale dhe joformale të bashkuara; - Numri i shteteve të përfaqësuara në rrjete; - Numri i bashkëpunimeve që rezultojnë nga pjesëmarrja në rrjetet ndërkombëtare
Veprimi C.4.2	Aktivizimi i një shkolle verore ndërkombëtare për kujtimin e rezistencës	- Krijimi i kurrikulës për shkollën verore, duke përfshirë përmbajtjen e lëndëve, objektivat mësimore dhe një plan aktivitetsh; - Regjistrim i suksesshëm i një numri të synuar pjesëmarrësish, duke përfshirë studentë, studiues dhe edukatorë.	- Aktivizimi i suksesshëm i shkollës verore; - Numri i lëndëve të ofruara në kurrikulë; - Shkalla e suksesit të regjistrimit; - Indeksi cilësor që vlerëson kënaqësinë e pjesëmarrësve
Veprimi C.4.3	Angazhimi në aktivitete ndërkombëtare për mbledhjen e fondeve	Burimet e ndryshme të financimit	- Numri i fushatave për mbledhjen e fondeve; - Numri i donatorëve të fituar;

		REZULTATET E PRITSHME	TREGUESIT
			- Diversiteti i donatorëve; - Fundet e mbledhura

DRAFT

10. Anekset:

Aneksi A: Informacioni dhe të dhënat kartografike të ndërtesave

Spaçi ndodhet në Bashkinë e Mirditës, në një zonë malore në jugperëndim të malit të Munellës, maja më e lartë e të cilit, Maja e Kryqit 1,990 m (6,530 ft), shtrihet midis luginave të lumenjve Fani i Madh në veriperëndim dhe Fanit të Vogël në juglindje.

Pllaja e kampit ka pamje nga lumi i Fanit të Vogël (Koordinatat 41°54' 4" N 20°2' 51" E).



Figura 6: Zona e Burgut të Spaçit në kontekstin infrastrukturor dhe urbanistik

Detajet e ndërtesave

1- Ndërtesa e magazinës së sektorit, Pasuria nr. 685



2- Kapanone fjetje (5 katëshe), Pasuria nr. 680



3- Kapanone fjetje dhe kantina (5 katëshe), Pasuria nr. 682



4- Kabinë elektrike në ndërtesën e fjetjes 5 katëshe (pranë kapanonit të fjetjes + kantinës)



5- Zyrat e administratës (3 katëshe), (komanda e ish burgut). Pasuria nr. 671



6- Spitali plus dhoma e leximit Pasuria nr. 666



7- Ndërtesa e ambulancës, Pasuria nr. 670




Dhomë takimi i ish të burgosurve



8- Vend fjetje Pasuria nr. 674



Sipas vendimit të Ministrisë së Kulturës Nr. 241 datë 23/06 2015, zona e mbrojtur për objektin monument kulture të kategorisë II shpallet sipas hartës së mëposhtme:



Aneksi B: Vlerësimi i opsioneve të skenarëve të menaxhimit

Ky aneks përshkruan skenarët e mundshëm të menaxhimit për Spaçin, duke paraqitur një përmbledhje të aspekteve që dalin nga analiza e legjislacionit shqiptar, vlerësimit të implikimeve nga impakti i administrimit dhe menaxhimit, si dhe një hetim mbi zbatimin aktual të skenarëve të ndryshëm të administrimit dhe menaxhimit në vend dhe në nivel ndërkombëtar. Informacioni i paraqitur këtu është i pasuruar edhe nga intervistat e thelluara gjysmë të strukturuar të mbajtura me drejtorë ose organe administruese të muzeve dhe vendeve të kujtesës të zgjedhura si raste krahasimore. Për të ofruar një vlerësim gjithëpërfshirës të implikimeve më të rëndësishme të ndikimeve të skenarëve të ndryshëm të administrimit dhe menaxhimit, secili prej tyre do të trajtohet tërësisht duke prekur tre çështje kryesore: aspektet e vendimmarrjes dhe implikimet e tyre për skenarin e zgjedhur të menaxhimit, aspektet financiare dhe buxhetore, dhe shkallën në të cilën skenari i përzgjedhur mundëson përfshirjen pjesëmarrëse, veçanërisht midis ish të burgosurve. Objektivi i këtij studimi krahasues është të parashtrojë të gjitha konsideratat përkatëse që çojnë në propozimin për një strukturë funksionale drejtuese për ish-burgun e Spaçit.

Këtu janë paraqitur pesë skenarë, si më poshtë:

- Skenari 1: Administrim direkt nga Ministria e Kulturës
- Skenari 2: Administrim indirekt nga Fondacioni i Posaçëm
- Skenari 3: Administrim direkt nga Bashkia Mirditë, me ose pa partnerë të tjerë shtetërorë
- Skenari 4: Administrim indirekt nga partnerë të sektorit privat, të cilët mund të jenë vetë fondacione jofitimprurëse, të emëruar përmes një procesi tenderi të hapur
- Skenari 5: Administrim indirekt nga një fondacion i krijuar nga një institucion i specializuar i trashëgimisë kulturore.

Skenari 1: Administrim direkt nga Ministria e Kulturës

Aspekte legjislative

Ligji nr. 27/2018 *Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë*, strukturat organizative të specializuara në varësi të institucioneve shtetërore ose subjekteve të tjera publike me autonomi shkencore, organizative, financiare dhe me personel të specializuar teknikoshkencor, kanë të drejtën për administrim të drejtpërdrejtë të pasurisë së trashëgimisë kulturore. Institucionet publike mund të realizojnë administrimin direkt edhe në bashkëpunim me organe të tjera të administratës publike.

Aspektet e menaxhimit

Në këtë skenar, Ministria merr rolin qendror të krijimit dhe mbajtjes së strukturës organizative të muzeut. Kjo përfshin vendimet në lidhje me personelin, të tilla si përcaktimi i numrit të punonjësve të nevojshëm për role specifike, përcaktimi i strukturës së tyre të kompensimit dhe përcaktimi i fushës së tyre të përgjegjësive. Pasi të krijohet struktura, për çdo ndryshim të saj duhet të bëhet kërkesë zyrtare nga drejtori i muzeut drejtuar Kryeministrit. Ky proces shpesh përfshin burokraci administrative dhe afate të zgjatura kohore, të cilat mund të përbëjnë problem në situatat kur kërkohet veprim i menjëhershëm.

Një karakteristikë tjetër kryesore e kësaj strukture është se Ministria emëron drejtpërdrejt drejtorin e muzeut, i cili nga ana e tij merr përgjegjësinë për të rekrutuar individë për të përmbushur rolet e mandatuara nga Ministria. Në thelb, Ministria përcakton rolin dhe drejtori zgjedh personin që do ta kryejë atë rol, i cili shtrihet edhe në caktimin e bashkëpunëtorëve për funksione përtej funksionimit standard të muzeut. Pra, thënë ndryshe, pasi Drejtori merr përsipër rolin e tij, ai merr përgjegjësinë për mbikëqyrjen e personelit dhe funksionimin e përgjithshëm të muzeut. Gjithashtu, ai pritët të mbajnë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme me

Ministrinë e Kulturës. Kjo lidhje është jetike sepse Drejtorit do t'i duhet të kërkojë miratimin e Ministrisë për shumicën e iniciativave përtej funksioneve rutinë të muzeut, duke përfshirë botimet, ngjarjet dhe programet edukative.

Një karakteristikë e tretë e dukshme e kësaj strukture administrative ka të bëjë me rolin e Ministrisë si mbështetësi kryesor dhe më i rëndësishëm financiar i Muzeut. Ministria e Kulturës siguron mbulimin dhe sigurinë për shpenzimet thelbësore si pagat e personelit, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e përgjithshëm, ndërsa burime shtesë të të ardhurave krijohen nga shitja e biletave. Të ardhurat e krijuara nga shitja e biletave herë pas here riinvestohen në kategori të ndryshme programesh dhe aktivitete, kryesisht në iniciativa arsimore, gjithmonë subjekt i miratimit nga Ministria. Sipas legjislacionit shqiptar, në rast të menaxhimit direkt të ardhurat do të përdoren për pasurimin e trashëgimisë kulturore dhe vlerësimin nga Fondi Kombëtar i Kujdesit për Trashëgiminë Kulturore. Gjithashtu, muzeu ka fleksibilitetin për të marrë donacione, për t'u angazhuar në aktivitete për mbledhjen e fondeve dhe për të marrë pjesë në tenderët publikë për projekte specifike.

Nisur nga rasti vendas i marrë si referencë, si përshkruhet më poshtë, skenari i administrimit të drejtpërdrejtë tregon një nivel të moderuar të përfaqësimit të ish-të burgosurve, duke pasur parasysh angazhimin e demonstruar të Ministrisë për t'i angazhuar ata në krijimin e *Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia e Gjetheve"*.

Rasti kombëtar i referencës

Skenari i parë në shqyrtim, ai i Administrimit të Drejtpërdrejtë nga Ministria e Kulturës, mund të mbështetet në ekzistencën e strukturave të ngjashme drejtuese të muzeve dhe institucioneve të tjera shqiptare. Një rast kombëtar i rëndësishëm që shërben si referencë për këtë skenar është Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia e Gjetheve", që ndodhet në Tiranë. Ky institucion jofitimprurës funksionon nën pronësinë dhe administrimin e drejtpërdrejtë të Ministrisë së Kulturës së Shqipërisë. "Shtëpia e Gjetheve" hapi dyert e saj në maj 2017, duke shënuar pozicionimin e saj si muzeu më i ri në Shqipëri që përmban dëshmi të prekshme nga periudha e regjimit komunist në vend.

Në përputhje me informacionin e paraqitur më parë, Drejtori i "Shtëpisë së Gjetheve" emërohet drejtpërdrejt nga Ministria, e cila gjithashtu përshkruan strukturën specifike të personelit, duke përfshirë numrin e punonjësve, rolet e tyre dhe pagat përkatëse. Muzeu është pjesë e rrjeteve

institucionale kombëtare dhe ndërkombëtare, duke nxitur marrëveshje bashkëpunimi brenda dhe jashtë Shqipërisë. Për shembull, Shtëpia e Gjetheve është anëtare e Rrjetit Ballkanik të Muzeve dhe Organizatave Evropiane të Muzeve (NEMO), ndër të tjera. Këto lidhje mundësohen pjesërisht nga Ministria e Kulturës dhe kryesisht përkrahen dhe propozohen nga Drejtori i Muzeut. Në rastin e propozimeve të tilla, është përgjegjësi e drejtorit të konsultohet me Ministrinë e Kulturës për të siguruar që këto rrjete të përputhen me interesat e Muzeut dhe të marrin miratimin nga Ministria. Kjo është veçanërisht kritike kur kemi të bëjmë me rrjete të strukturuar zyrtarisht që mund të kërkojnë një tarifë pjesëmarrjeje.

Në përgjithësi, muzeu funksionon me një buxhet të paracaktuar, i cili ndahet në kategori të ndryshme për të mbuluar shpenzime të ndryshme operacionale, duke përfshirë kostot e personelit, sigurimin dhe shpenzimet e lidhura me të, kostot fikse të mirëmbajtjes dhe financimin e caktuar për krijimin e rrjeteve institucionale. Përveç këtyre burimeve zakonisht fikse dhe të paracaktuara të financimit, një pjesë e të ardhurave të muzeut rrjedhin nga shitja e biletave (afërsisht 30%).

Rasti ndërkombëtar i referencës

Një pikë referimi ndërkombëtare për t'u konsideruar është burgu kombëtar Memorial "Montluc" në Lyon, Francë, i krijuar fillimisht si një burg ushtarak në vitet 1920 dhe më vonë u ripërcaktua si një qendër internimi për luftëtarët e rezistencës, pengjet dhe ata që u nënshtrohen "masave racore", në pritje të dëbimit në kampet e përqendrimit dhe shfarosjes gjatë Luftës së Dytë Botërore, duke e bërë atë një vend emblematic të politikave gjermane të shtypjes dhe persekutimit. *Mémorial* është zyrtarisht në pronësi të Ministrisë së Forcave të Armatosura dhe është nën menaxhimin e drejtpërdrejtë të Zyrës Kombëtare për Luftëtarët dhe Viktimat e Luftës, një degë e së njëjtës Ministri. Për të siguruar funksionim efektiv, janë krijuar dy subjekte kyçe për të ofruar mbështetje dhe udhëzime. Një komitet drejtues, i përbërë kryesisht nga shoqata që përfaqësonin ish-luftëtarët e rezistencës dhe komunitetin hebre, u iniciua nga prefekti, përfaqësuesi i shtetit, për të mbikëqyrur aktivitetet e memorialit. Ndërsa zona u zhvillua, komiteti drejtues u zvogëlua gradualisht në madhësi, me vetëm pak shoqata të mbetura në bord. Rrjedhimisht, u krijua një organ i dytë për të përfshirë një spektër më të gjerë të perspektivave dhe ekspertizës historike, përkatësisht një Komitet Shkencor, i cili përfshin institucione, muze dhe memorialë që fokusohen në tematika të ngjashme, si dhe shërbime arkivore, Ministria e Arsimit për aspekte arsimore, dhe së fundmi edhe Ministria e Drejtësisë, me ekspertizë në historinë e burgjeve. Sot, këto dy organe luajnë një rol vendimtar në orientimin e institucionit dhe administratës për projekte të ndryshme.

Avantazhet

- Burim financiar i qëndrueshëm dhe i garantuar në fazën fillestare të planit të menaxhimit;
- Mundësi për rrjetëzim me institucionet kulturore të lidhura me Ministrinë, prestigj më i lartë dhe vizibilitet i shtuar; pjesëmarrja në rrjetet ndërkombëtare;
- Niveli i moderuar i përfaqësimit të vizionit të ish të burgosurve.

Disavantazhet

- Afatet e gjata kohore për shkak të procedurave formale burokratike.

Skenari 2: Administrim indirekt nga Fondacioni i Posaçëm

Aspekte legislative

Administrimi indirekt nga një fondacion i përkushtuar i përbërë nga Ministria e Kulturës dhe një Partner Strategjik përfaqëson një tjetër mundësi të mundshme për menaxhimin e Muzeut të Burgut të Spaçit. Sipas ligjit nr. 27/2018 *Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë*, mund të krijohen “Fondacione të Posaçme” si një formë e menaxhimit indirekt të pasurisë kulturore. Krijimi i fondacioneve të posaçme mund:

- të iniciohet nga partnerët privatë 'strategjikë' (me kualifikime specifike si p.sh. 5 vjet përvojë të mëparshme në projekte të trashëgimisë kulturore, bashkëpunim me qeverinë, aftësi financiare, etj); Rregullat për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të posaçme të trashëgimisë kulturore përcaktohen në marrëveshjen të posaçme të lidhur ndërmjet palëve.
- të tenderohen nga Ministria e Kulturës, pra kjo e fundit do të organizojë një konkurs për të ftuar një ose më shumë partnerë strategjikë për të paraqitur një propozim për menaxhimin indirekt të pasurisë.

Rregullat për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të posaçme të trashëgimisë kulturore përcaktohen në marrëveshjen të posaçme të lidhur ndërmjet palëve. Marrëveshja është objekt miratimi nga:

- (a) Këshilli i Ministrave në rastin e administrimit të pasurisë kulturore të paluajtshme me rëndësi kombëtare ose lokale, dhe
- (b) Parlamenti, në rast të pasurive kulturore të paluajtshme me rëndësi universale.

Tiparet e Fondacionit të Posaçëm

- Fondacionet e posaçme do të financohen nga themeluesit;
- Janë të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat;

- Janë të përjashtuara nga TVSH;
- Furnizimet janë të përjashtuara nga detyrimet doganore.
- Të ardhurat përdoren në bazë të marrëveshjes.
- Të drejtat e administrimit të pasurisë i kalojnë fondacionit.

Aspektet e menaxhimit

Sipas legjislacionit shqiptar, këto fondacione të posaçme për administrimin e pasurive kulturore të paluajtshme krijohen si persona juridikë jofitimprurës, të bashkëthemeluar nëpërmjet institucioneve shtetërore, të përfaqësuara nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe persona fizikë ose juridikë privatë, vendas ose të huaj. Pas themelimit, fondacioni merr përsipër përgjegjësitë e administrimit dhe menaxhimit për pasurinë në fjalë; megjithatë titulli i pronësisë i mbetet shtetit. Ky lloj administrimi përfshin një përpjekje bashkëpunuese midis pronarit dhe menaxherit të Muzeut, me shtrirjen dhe fushat e përgjegjësisë të përcaktuara paraprakisht në marrëveshjen e posaçme të lidhur ndërmjet palëve. Marrëveshja përshkruan specifikat e projektit të menaxhimit, shërbimet thelbësore të kërkuara për të siguruar akses publik në objekt, afatin kohor për zbatimin, standardet e pritshme të cilësisë për aktivitetet dhe shërbimet, dhe kërkesat për nivelin profesional të stafit.

Në planin administrativ, Ministria duhet të krijojë një njësi të brendshme përgjegjëse për menaxhimin e të gjitha funksioneve brenda Ministrisë dhe koordinimin e ndërveprimeve me Partnerin Strategjik. Përzgjedhja e Partnerit Strategjik kryhet në mënyrë tipike nëpërmjet një procedure konkurrimi publik, i cili vlerëson planin e tyre të vlerësimit afatmesëm deri në afatgjatë, në përputhje me objektivat e pronarit, të plotësuar nga një program kulturor i planifikuar vjetor. Fondacioni mund t'u japë palëve të treta pasurinë kulturore publike që ka nën administrim, për përdorim të drejtpërdrejtë (d.m.th. aktivitete kulturore, sociale, artistike) dhe/ose indirekt (d.m.th. riprodhimin e pasurive të caktuara që janë pjesë e pasurisë). Procedurat, kohëzgjatja e kontratës, tarifat e komisionit etj. përcaktohen nga organi vendimmarrës i fondacionit, në përputhje me procedurat e brendshme dhe statutin e fondacionit, duke garantuar ruajtjen e origjinalitetit dhe integritetit fizik të pasurisë kulturore.

Për sa i përket angazhimit financiar, meqenëse legjislacioni shqiptar lejon ndihmën buxhetore publike për fondacionin e krijuar, Ministria duhet të ndajë një buxhet vjetor për të mbështetur aktivitetet e valorizimit, duke pasur parasysh se të ardhurat fillestare nga burime si shitja e biletave dhe workshopet mund të jenë relativisht të ulëta. Kjo ndarje buxhetore mund të rregullohet me kalimin e kohës bazuar në një vlerësim të plotë të flukseve të tjera të të ardhurave, duke përfshirë mundësitë

e financimit ndërkombëtar. Një karakteristikë tjetër e parashikuar në legjislacionin shqiptar për këtë lloj fondacioni është e drejta e tij për një shkallë autonomie dhe pavarësie në administrimin e të ardhurave. Ky skenar kërkon një sistem monitorimi gjithëpërfshirës që përfshin koordinimin e monitorimit financiar përgjatë rrjedhave të ndryshme të të ardhurave në përputhje me aktivitetet e planifikuara integrale të programit kulturor të krijuar, si dhe monitorimin e pritshmërive dhe gjyqimeve në lidhje me aktivitetet e zbatuara.

Administrimi indirekt nëpërmjet një fondacioni të dedikuar mund të mundësojë një shkallë të lartë angazhimi dhe përfaqësimi të ish të burgosurve, të arritur nëpërmjet krijimit, sipas statutit, të organeve këshillimore të përbëra nga ish të burgosur.

Rasti kombëtar i referencës

Struktura administrative e përdorur në zonën arkeologjike të Butrintit, jep një shembull të administrimit indirekt nga një fondacion i dedikuar. I njohur si një nga vendet më të rëndësishme arkeologjike në Shqipëri, Butrinti ka një rezonancë të jashtëzakonshme kulturore dhe tërheqje vizuale, e cila vjen nga kombinimi i rrallë i monumenteve dhe një mjedisi natyror të paprekur. “Zona arkeologjike e Butrintit” menaxhohet nga Fondacioni i Menaxhimit të Butrintit, i cili është krijuar në përputhje me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë në vitin 2018, ndërmjet Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan të Zhvillimit.

Fondacioni i Menaxhimit të Butrintit merr përsipër përgjegjësi të ndryshme, duke përfshirë:

- Administrimi i zonës dhe menaxhimin e burimeve njerëzore, financiare dhe intelektuale;
- Aktivitete që synojnë ruajtjen, mbrojtjen, konservimin dhe promovimin e zonës;
- Organizimi i kurseve të trajnimit, seminareve, granteve të bursave, diskutimeve, konferencave dhe iniciativave arsimore;
- Përpjekjet për mbledhjen e fondeve, ndër aktivitete të tjera.

Rasti ndërkombëtar i referencës

Nuk u identifikua asnjë rast ndërkombëtar i muzeve ose siteve të kujtesës të menaxhuara përmes këtij modeli të administrimit indirekt.

Avantazhet

- Më tepër fleksibilitet dhe mundësi për të përshtatur masën e funksioneve të deleguara;
- Zbatimi i shpejtë pas procesit fillestar të miratimit të programit,

- Procese të thjeshtuara dhe të përshpejtuara të prokurimit publik dhe miratimit të shpenzimeve, pasi ato nuk janë nën efektin detyrues të legjislacionit publik;
- Zbatohet përjashtim nga tatim fitimi, TVSH-ja detyrimet doganore;
- Të ardhurat përdoren në bazë të marrëveshjes.

Disavantazhet

- Konfliktet e mundshme midis pronarit dhe entit administrues që rrjedhin nga mosmarrëveshjet në lidhje me konfliktet e përdorimit dhe menaxhimin e përgjithshëm të monumentit (p.sh., mbyllja e zonave specifike, periudhat e pasivitetit, mbylljet e lidhura me restaurimin, përdorimi i paautorizuar);
- Niveli i përfaqësimit të ish të burgosurve është i pasigurt dhe do të varet nga natyra dhe balanca e pushteteve me partnerin privat;
- Apelim i kufizuar për subjektet private të menaxhimit për shkak të faktorëve si vendndodhja dhe perspektiva e kufizuar ekonomike.

Skenari 3: Administrim direkt nga Bashkia Mirditë, me ose pa partnerë të tjerë shtetërorë

Aspekte legjislative

Opsioni i administrimit indirekt nga Bashkia Mirditë nuk duket se përputhet me legjislacionin shqiptar dhe nuk duket e realizueshme që Bashkia të marrë pjesë në një fondacion e posaçëm. Siç tregohet në vlerësimin e skenarit 2, fondacionet e posaçme mund të krijohen vetëm nga institucionet shtetërore, të përfaqësuara nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, ose nga persona fizikë ose juridikë privatë, vendas dhe të huaj. Krijimi i fondacioneve të posaçme duhet të iniciohet nga partnerë privatë 'strategjikë' që posedojnë kualifikime specifike, të tilla si një minimum prej 5 vitesh përvojë paraprake në projekte të trashëgimisë kulturore, një histori bashkëpunimi me qeverinë, aftësi financiare, etj.

Sipas legjislacionit shqiptar, bashkitë mund të jenë përgjegjëse për menaxhimin e drejtpërdrejtë të pasurive kulturore të paluajtshme dhe, në rastin e muzeve, një muze vendor mund të krijohet nëpërmjet një propozimi nga pushteti vendor, i ndjekur nga miratimi nga këshilli bashkiak dhe miratimi vijues nga Këshilli Kombëtar i Muzeve. Struktura organizative formalizohet me urdhër bashkiak.

Muzetë vendore, të ngjashëm me muzetë e tjerë publikë, mbështeten në financimin publik si burim kryesor financiar, por gjithashtu mund të kenë akses në burime financiare shtesë nga burime të ndryshme, duke përfshirë donacionet

Aspektet e menaxhimit

Administrimi nga Bashkia Mirditë, zbatohet vetëm në rastin e administrimit të drejtpërdrejtë, qoftë në mënyrë të pavarur apo në bashkëpunim me partnerët shtetërorë.

Prona publike kulturore mund të kalojë në administrimin e drejtpërdrejtë të qeverisjes vendore në kushte të caktuara. Së pari, vendndodhja gjeografike e pronës luan një rol kryesor, pasi ajo duhet të jetë në juridiksionin territorial të institucionit publik përkatës. Së dyti, transferimi duhet të kushtëzohet nga aftësia e qeverisjes vendore në fjalë për të siguruar ruajtjen, vlerësimin dhe menaxhimin efikas të pasurive kulturore. Organi vendor i caktuar për të mbikëqyrur pasurinë duhet të ketë një fuqi punëtore shumë të kualifikuar, si dhe burime të përshtatshme teknike dhe financiare për të ekzekutuar në mënyrë efektive mbrojtjen, vlerësimin dhe menaxhimin e saj. Gjithashtu, organi administrues duhet të angazhohet për ofrimin e shërbimeve thelbësore publike dhe sigurimin e aksesit publik në pasurinë kulturore. Për më tepër, transferimi i suksesshëm kërkon një zotim për t'iu përmbajtur një plani menaxhimi të miratuar nga Ministria e Kulturës ose nga Këshilli i Ministrave, në varësi të autoritetit qeverisës. Për të zyrtarizuar këtë proces, zakonisht lidhet një marrëveshje detyruese ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe njësisë së caktuar të qeverisjes vendore. Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, transferimi i nënshtrohet miratimit nga Këshilli i Ministrave.

Për sa i përket angazhimit financiar, njësia e qeverisjes vendore (Bashkia) është përgjegjëse për financimin e zhvillimit të pasurisë kulturore, duke përdorur burimet e veta të akorduara nga buxheti i shtetit, të ardhurat e krijuara nga taksat vendore ose siç përcaktohet nga marrëveshjet me Ministrinë e Kulturës. Në rastin e administrimit të përbashkët, qeverisja vendore dhe organi publik qendror do të përcaktojnë në bashkëpunim marrëveshjet e financimit.

Me kushtet e renditura më sipër, vlerësimi i mëposhtëm i përputhshmërisë i përket rastit të transferimit të menaxhimit të Spaçit në Bashkinë Mirditë:

- Vendndodhja gjeografike e pronës luan një rol kryesor: përputhet;
- Fuqia punëtore me kualifikim të lartë brenda qeverisjes vendore: përputhshmëri e pasigurt;
- Burime adekuate teknike dhe financiare nga qeverisja vendore: përputhshmëri e pasigurt;
- Shërbimet publike thelbësore dhe sigurimi i aksesit publik në pasurinë kulturore: mund të realizohet;

- Plan menaxhimi: mund të realizohet.

Avantazhet

- Zbatimi i shpejtë pas procesit fillestar të miratimit të programit,
- Mundësi e lartë angazhimi nga ana e Bashkisë për shkak të rolit kryesor të pasurisë për zhvillimin e territorit.

Disavantazhet

- Kufizimet financiare për shkak të buxhetit më të vogël të bashkisë;
- Mungesa e personelit brenda Bashkisë me aftësi dhe ekspertizë të specializuar menaxhuese kulturore.

Rasti kombëtar i referencës

“Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës” është një vend përkujtimor në Shqipëri që përkujton viktimat e regjimit komunist në Shkodër. Ndërtesa u ngrit fillimisht në shekullin XIX si pronë private, më pas Etërit françeskanë, në vitin 1930, blenë pronën dhe hapën këtu një Kolegj për trajnimin e priftërinjve të famullisë. Në vitin 1946 ndërtesa u konfiskua nga komunistët dhe u shndërrua në Degën e Brendshme (Degët lokale të Ministrisë së Brendshme) dhe e ruajti këtë rol deri në vitet '90. Krijimi i Vëndit të Dëshmisë dhe Kujtesës përfshiu bashkëpunimin e aktorëve të shumtë, me mbështetjen financiare kryesore nga Ministria e Kulturës dhe Bashkia Shkodër. Ndërsa Bashkia menaxhon dhe financon funksionimin e muzeut, duke mbuluar shpenzimet, pagat dhe kostot e furnizuesit, vetë prona mbetet në pronësi private, që i përket Kishës Katolike.

Struktura organizative përcaktohet nga një institucion që operon brenda Bashkisë Shkodër, i cili mbikëqyr jo vetëm “Vendin e Dëshmisë”, por edhe pesë institucione të tjera kulturore, si Muzeu Historik i Qytetit, Kalaja e Rozafës dhe Biblioteka. Rolet kyçe brenda muzeut, si drejtori, llogaritari dhe drejtuesit e departamenteve, emërohen nga ky institucion i lidhur. Nga ana tjetër, punonjësit e rregullt emërohen drejtpërdrejt nga bashkia, para së cilës ata mbajnë përgjegjësi. Rolet dhe përgjegjësitë brenda muzeut janë të ndryshme dhe përfshijnë një sërë funksionesh, duke filluar nga pritja e vizitorëve deri te mbështetja teknike dhe kërkimet historike. Në rastet kur muzeu kërkon personel shtesë, Drejtori ka autoritetin të pyesë institucionin e lidhur në lidhje me mundësinë e rekrutimit të individëve për role specifike. Më pas, institucioni nis procesin e kërkesës pranë bashkisë për shqyrtim dhe miratim.

Rasti ndërkombëtar i referencës

Një pikë referimi ndërkombëtare për t'u konsideruar për këtë skenar është “La Risiera di San Sabba”, e vendosur në Trieste, Itali, e cila fillimisht funksionoi si një objekt industrial për përpunimin e orizit, më vonë shërbeu si një kazermë ushtarake, dhe më pas, pas pushtimit të territorit nga forcat gjermane, u përdor si kamp burgu i përkohshëm për ushtarët italianë të kapur pas 8 shtatorit 1943 (Stalag 339). Më vonë u shndërrua në një Polizeihafthlager (Kampi i Paraburgimit të Policisë), një element tipik i sistemit nazist të kampit të përqendrimit. *La Risiera di San Sabba* u shpall monument kombëtar në vitin 1965, dhe tani është në pronësi dhe menaxhim të Bashkisë së Triestes. Ndërsa menaxhimi i drejtpërdrejtë nga Bashkia shërben si një pikë referimi interesante, është e rëndësishme të theksohet se Trieste, si kryeqytet rajonal, disponon burime më të mëdha financiare për menaxhimin e zonës në krahasim me ato të Bashkisë Mirditë.

Skenari 4: Administrim indirekt nga partnerë të sektorit privat, të cilët mund të jenë vetë fondacione jofitimprurëse, të emëruar përmes një procesi tenderi të hapur

Aspekte legjislative

Personat fizikë dhe juridikë, publikë apo privatë, mund të lidhin një marrëveshje me institucionet publike për administrimin indirekt të një pasurie kulturore, bazuar në një procedurë konkurruese. Ish-burgu i Spaçit është shpallur Monument Kulture në vitin 2017; edhe pse në atë kohë procedura nuk parashikonte një kategorizim të pasurisë kulturore me rëndësi "lokale", "kombëtare" apo "universale", një vlerësim i ardhshëm nga organi përkatës ka të ngjarë ta klasifikojë atë si të rëndësishme "kombëtare", duke e bërë këtë formë të menaxhimit të drejtpërdrejtë të pazbatueshme për pasurinë kulturore, sipas Vendimit nr. 560 datë 29/07/2022 të Këshillit të Ministrave.

Aspektet e menaxhimit

KKMPK do të miratojë një vendim për menaxhimin indirekt të pasurisë kulturore, duke përcaktuar kriteret e vlerësimit dhe duke marrë miratimin nga Ministria e Kulturës për hapjen e procedurës publike.

Në kuadër të procedurës publike, palët e interesuara do të duhet të dorëzojnë një dosje në përputhje me aktivitetet e lejuara dhe administrimin e pronës dhe në përputhje me kushtet e marrëveshjes. Përmbajtja e dosjes do të duhet të demonstrojë pajtueshmërinë me regjistrimin, kapacitetin financiar, menaxhimin e përgjithshëm dhe menaxhimin e mëparshëm të pasurive kulturore, si dhe një plan për konservimin, restaurimin dhe ruajtjen e pronës, propozimin e aktiviteteve që do të ndërmerren dhe plan të detajuar biznesi.

Pasi të identifikohet ofertuesi i preferuar, përgatitet një marrëveshje që përcakton përmbajtjen e projektit të menaxhimit, shërbimet thelbësore që duhet të garantohen për përdorimin publik të objektit, kushtet e realizimit, nivelet e cilësisë së aktiviteteve dhe shërbimeve që do të ofrohen dhe kërkesat për nivelin profesional të stafit. Marrëveshja mund të zgjasë deri në 10 vjet dhe mund të rinovohet pasi të vërtetohet se ka arritur objektivat.

Kjo zgjidhje nënkupton zbatimin e një sistemi të sofistikuar monitorimi për të vlerësuar efikasitetin dhe efektivitetin e partnerit privat, si dhe respektimin e regjimit të ruajtjes dhe mbrojtjes së vlerave të veçanta kulturore.

Rasti kombëtar i referencës

Rasti që vijon nuk paraqet një rast të një objekti kulturor të dhënë për përdorim për qëllime rijetësimi, por është një shembull i menaxhimit nga një subjekt privat që mund të ndiqet në nivel kombëtar.

Projekti “BUNK’ART” nisi në nëntor 2014 kur BUNK’ART 1, një video-ekspozitë muzeale, u hap për publikun brenda bunkerit atomik në pronësi më parë të diktatorit Enver Hoxha, që ndodhet në periferi të Tiranës. Kjo përpjekje vazhdoi me inaugurimin e BUNK ART 2 më 19 nëntor 2016, i vendosur në qendër të kryeqytetit.

Menaxhimi i kësaj zone përfshin aktorë të ndryshëm lokalë. Ministria e Mbrojtjes zotëron zakonisht bunkerë dhe prona të ngjashme, ndërsa Bashkia e Tiranës është përgjegjëse për rregullimin dhe planifikimin e territorit brenda Bashkisë. Zhvillimi i BUNKART I rezultoi nga një përpjekje bashkëpunimi midis qeverisë shqiptare, veçanërisht Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Mbrojtjes, të cilat punuan së bashku për të lehtësuar përdorimin e duhur të kësaj pasurie. Zona tani menaxhohet dhe administrohet nga një organizatë artistike jofitimprurëse e quajtur “Qendra Ura”.

Rasti ndërkombëtar i referencës

Një rast ndërkombëtar për t’u marrë në konsideratë në këtë kontekst është “Memoriali i Viktimave të Komunizmit dhe Rezistencës”, një institucion unik në Bukuresht që shërben si një institut kërkimi dhe një muze edukativ. Ky kompleks përfshin Muzeun Sigjet dhe Qendrën Ndërkombëtare për Studime mbi Komunizmin, krahas rolit të tij si organizator i Shkollës Verore.

“Memoriali i Viktimave të Komunizmit dhe Rezistencës” është nën administrimin e Fondacionit Academia Civică, një organizatë e shoqërisë civile që mori përsipër rrënojat e ish-burgut në 1993 me misionin për ta shndërruar atë në një muze. Ndërsa autoritetet lokale zotërojnë zonën, Fondacioni Academia Civică menaxhon në mënyrë aktive operacionet e tij.

Për themelimin e muzeut, fondacionit iu desh të siguronte fondet e nevojshme për rehabilitimin e ndërtesës, të cilat kryesisht ishin siguruar përmes donacioneve. Aktualisht, Fondacioni Academia Civică merr mbështetje financiare nga buxheti publik - që përbën rreth 40% - , pasi Memoriali është klasifikuar si zonë me rëndësi kombëtare. Intervistat me personelin e Memorialit zbulojnë se marrëdhënia e tyre me autoritetet vendore nuk karakterizohet nga detyrime të vazhdueshme raportimi ose mbikëqyrje të rreptë.

Avantazhet

- Efikasiteti dhe inkurajimi për qasjet sipërmarrëse;
- Zbatimi i shpejtë i aktiviteteve të reja.

Disavantazhet

- Apelim i kufizuar për subjektet private të menaxhimit për shkak të faktorëve si vendndodhja dhe perspektiva e kufizuar ekonomike.
- Konfliktet e mundshme midis pronarit dhe entit administrues që rrjedhin nga mosmarrëveshjet në lidhje me konfliktet e përdorimit dhe menaxhimin e përgjithshëm të monumentit (p.sh., mbyllja e zonave specifike, periudhat e pasivitetit, mbylljet e lidhura me restaurimin, përdorimi i paautorizuar);
- Rreziku i mospërputhjes midis objektivave kulturore dhe ekonomike, duke çuar në mbikomercializimin e zonës;
- Përfaqësim i kufizuar i vizionit të ish të burgosurve dhe shkëputje nga komuniteti lokal.

Skenari 5: Administrim indirekt nga një fondacion i krijuar nga një institucion i specializuar i trashëgimisë kulturore.

Aspekte legjislative

Administrimi indirekt mund të ndërmerret nga një fondacion i dedikuar i krijuar nga një prej institucioneve të specializuara të trashëgimisë kulturore (Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore; Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore; drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore; Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale; Institucionet e Rrjetit Arkivor Kombëtar; Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë; Instituti i Studimeve të Artit dhe Antropologjisë Kulturore; Instituti i Arkeologjisë). Gjithashtu, edhe vet Ministria e Kulturës mund të themelojë një fondacion.

Aspektet e menaxhimit

Administrimi i aktivitet transferohet nga pronari të fondacioni i krijuar për ta administruar në mënyrë indirekte.

Ndërtimi i një itinerari për vizitorët	- Shpenzimet fillestare që kryhen vetëm një herë; - Mirëmbajtja e rregullt e itinerarit, duke përfshirë pastrimin dhe mirëmbajtjen parandaluese për të ruajtur hartat e vendndodhjes, shtigjet e shtruara dhe instalimet e mundshme të projektuara për të shenjuar itinerarin; - Shpenzimet që lidhen me sigurimin e aksesueshmërisë për individët me aftësi të kufizuara, duke përfshirë ofrimin e një game të gjerë itinerarësh të aksesueshëm të përshtatur për nevojat e ndryshme të aftësisë së kufizuar.	- Të ardhurat që rrjedhin nga ofrimi i tureve virtuale me pagesë ose përvojave interaktive për aksesin e pjesëmarrësve; - Të ardhurat e krijuara nga tarifat e hyrjes
Sigurimi i një niveli bazë të interpretimit në vend (nëpërmjet instalimeve interpretuese dhe paneleve orientuese)	- Shpenzimet fillestare që kryhen vetëm një herë, duke përfshirë kostot që lidhen me kërkimin dhe zhvillimin e përmbajtjes interpretuese, vendosjen e instalimeve të dizajnuara për të shënuar itinerarin, shpenzimet që lidhen me përkthimin e materialeve interpretuese në shumë gjuhë, kostot për krijimin e versioneve të aksesueshme të përmbajtjes interpretuese, duke përfshirë materialet braille, audio përshkrimet dhe interpretimi i gjuhës së shenjave etj.; - Shpenzimet për mbledhjen e komenteve të vizitorëve dhe kryerjen e anketave për të përmirësuar përvojën	- Të ardhurat e krijuara nga tarifat e hyrjes; - Të ardhurat e krijuara nga ofrimi i udhëtimeve me guidë të udhëhequra nga përkthyes ose guidë për të cilat pjesëmarrësit paguajnë një tarifë të veçantë; - Sigurimi i turneve audio me qira që përmirësojnë përvojën e vizitorëve përmes interpretimit të thelluar; - Krijimi i programeve të anëtarësimit që ofrojnë përfitime ekskluzive, të tilla si akses falas ose me zbritje në aktivitetet interpretuese, në këmbim të një tarife anëtarësimi të përsëritur; - Inkurajimi i vizitorëve për të bërë donacione vullnetare për të mbështetur programet interpretuese dhe për të përmirësuar përvojën e vizitorëve.

	interpretuese; - Shpenzimet e vazhdueshme për mbajtjen e materialeve interpretuese të përditësuara dhe të sakta dhe për mirëmbajtjen e pajisjeve interaktive, pajisjeve audio dhe sinjalistikës.	
Instalimi i elementeve të sigurisë	- Shpenzime fillestare që kryhen vetëm një herë: kostot lidhur me përmbushjen e kërkesave ligjore dhe rregullatore në lidhje me standardet e sigurisë, të cilat mund të përfshijnë konsultimin e ekspertëve, kryerjen e inspektimeve dhe marrjen e certifikatave - Mirëmbajtja e rregullt e pajisjeve dhe instalimeve të sigurisë për të siguruar që ato të mbeten funksionale dhe efektive - Kryerja e programeve të trajnimit të sigurisë për stafin që mund të kërkojë punësimin e trajnerëve dhe krijimin e materialeve edukative	NA
Ngritja e një qendre shumëfunktionale vizitorësh	- Shpenzimet fillestare që kryhen vetëm një herë - Kostot që lidhen me çështjet e personelit, duke përfshirë punësimin e mësuesve dhe instruktorëve të kualifikuar - Kostot e tjera operative, duke përfshirë shërbimet komunale, mirëmbajtjen, pastrimin dhe shpenzimet e tjera operative të përditshme	- Të ardhurat që lidhen me organizimin e eventeve si konferenca, seminare, takime të korporatave dhe festa private, të cilat mund të jepen me qira kundrejt një tarife; - Të ardhurat që lidhen me inkurajimin e vizitorëve për të bërë donacione vullnetare për të mbështetur funksionimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të qendrës së vizitorëve.

Krijimi i një përvoje kreative për vizitorët 'zërat e Spaçit', (d.m.th. ture me guida nga ish të burgosurit, aplikacion i vetëdrejtuar për Burgun e Spaçit, panele të pasqyrës historike të vendosura në vend)	- Shpenzimet që lidhen me rekrutimin dhe trajnimin e udhërrëfyesve dhe përkthyesve	-Ofrimi i tureve me guidë të udhëhequra nga ish të burgosur ose udhërrëfyes të ditur, duke u ngarkuar pjesëmarrësve një tarifë për një perspektivë gjithëpërfshirëse dhe unike; - Të ardhurat lidhur me vendosjen e niveleve të anëtarësimit që japin akses në ture ekskluzive me guidë, përmbajtje speciale të aplikacioneve etj.; - Ofrimi i tureve virtuale ose përvojave në internet për audiencën nga distanca, duke ngarkuar tarifë për aksesin në përmbajtjen dixhitale.
Rindërtimi i elementeve kryesore (d.m.th. gardhe me tela me gjemba, kullat e vrojtimit, hapësirat e të burgosurve, Porta kryesore e Burgut)	- Shpenzimet fillestare që kryhen vetëm një herë, duke përfshirë kostot për materialet, shpenzimet për arkitektët, projektuesit dhe inxhinierët për projektimin dhe planifikimin e rindërtimit të saktë të elementit historik etj. - Shpenzimet për mirëmbajtjen e vazhdueshme, riparimet dhe përpjekjet konservuese për të mbajtur elementët e rindërtuar në gjendje të mirë.	NA
Ngritja e një qendre trajnimi	- Shpenzimet fillestare që kryhen vetëm një herë - Kostot që lidhen me çështjet e personelit, duke përfshirë punësimin e mësuesve dhe instruktorëve të kualifikuar - Kostot e tjera operative, duke përfshirë shërbimet komunale, mirëmbajtjen, pastrimin dhe shpenzimet e tjera operative të përditshme	- Të ardhurat e lidhura me dhënien me qira të objekteve të qendrës së trajnimit për një sërë ngjarjesh, të tilla si konferenca, workshope, seminare - Të ardhurat e lidhura me pagesën e tarifave të shkollimit ose regjistrimit të pjesëmarrësve për ndjekjen e programeve të përzgjedhura të trajnimit, seminareve dhe kurseve - Të ardhurat e mundshme të lidhura me partneritetin me shkollat, kolegjet ose universitetet për të ofruar programe të përbashkëta trajnimi

		- Të ardhurat që mund të lidhen me kërkimin e marrëveshjeve të sponsorizimit ose aplikimin për grante nga institucionet arsimore ose kulturore për të mbështetur aktivitetet e qendrës së trajnimit - Mundësi shtesë për të ardhura, që lidhen me aplikimin për grante përmes fondeve evropiane (p.sh., Creative Europe, Erasmus +, European Solidarity Corps...) - Të ardhurat që mund të lidhen me kërkimin e marrëveshjeve të sponsorizimit ose aplikimin për grante nga institucionet arsimore ose kulturore për të mbështetur aktivitetet e qendrës së trajnimit
Aktivizimi i shkollës verore ndërkombëtare	- Shpenzimet fillestare që kryhen vetëm një herë, duke përfshirë kostot që lidhen me hartimin dhe zhvillimin e kurrikulës, kurseve dhe materialeve edukative për shkollën verore; - Pagat për instruktorët, profesorët, asistentët e mësimdhënies dhe stafin administrativ të përfshirë në drejtimin e shkollës verore, dhe tarifën dhe shpenzimet për folësit e ftuar, ekspertëve për të ofruar leksione, seminare dhe sesione speciale; - Kostot për stafin administrativ, sistemet e regjistrimit dhe softuerin për të menaxhuar aplikimet, regjistrimin dhe komunikimin, si dhe ndihmën e studentëve ndërkombëtarë me aplikimet për viza, proceset e	- Të ardhurat që lidhen me tarifën e shkollimit të studentëve për pjesëmarrjen në kurset, programet dhe aktivitetet edukative të shkollës verore; - Bashkëpunimi me universitete, institucione arsimore ose organizata që paguajnë tarifë për të qenë pjesë e rrjetit të shkollave verore; - Mundësi shtesë për të ardhura, që lidhen me aplikimin për grante përmes fondeve evropiane (p.sh., Creative Europe, Erasmus +, European Solidarity Corps...) - Partneriteti me ofruesit e akomodimit, agjencitë e udhëtimit ose bizneset e tjera dhe marrja e një komisioni për referime.

	imigrimit dhe tarifave përkatëse; - Ndarja e fondeve për bursa ose paketa ndihme financiare për ta bërë programin të aksesueshëm për një gamë të ndryshme studentësh	
Ngritja e akomodimeve	- Shpenzimet fillestare që kryhen vetëm një herë, duke përfshirë kostot që lidhen me projektimin dhe planifikimin arkitektonik dhe instalimin e shërbimeve, të tilla si sistemet e ujit, energjisë elektrike dhe kanalizimeve; - Kostot për masat e sigurisë, duke përfshirë instalimin e veçorive të sigurisë si sistemet e sigurisë nga zjarri dhe daljet e emergjencës; - Shpenzimet lidhur me personelin, duke përfshirë rekrutimin e personelit për pozicione të tilla si, recepsionistë akomodimi dhe personel pastrimi, së bashku me kostot përkatëse të personelit; - Shpenzime të tjera operacionale, duke përfshirë shërbimet komunale, mirëmbajtjen, pastrimin dhe shpenzimet e tjera operacionale të përditshme.	- Të ardhurat e krijuara nga tarifave për shërbimet e akomodimit të ofruara për vizitorët; - Të ardhura të krijuara nga organizimi i ngjarjeve, konferencave ose rasteve të veçanta brenda akomodimit.
Organizimi i "ditëve të transparencës dhe parrezisë*" në Spaç	- Shpenzimet për zbatimin e masave të sigurisë, duke përfshirë personelin, pajisjet e mbikëqyrjes dhe shërbimet e reagimit në rast emergjence, për të garantuar sigurinë e të pranishmëve;	- Mbështetja financiare nga sponsorët dhe partnerët; - Të ardhura të krijuara nga dhënia me qira e Spaçit si një vend për ngjarje, shfaqje apo funksione private.

	- Kostot që lidhen me marrjen e lejeve dhe miratimeve të nevojshme nga autoritetet vendore për organizimin e ngjarjeve; - Shpenzimet për ngritjen e infrastrukturës së përkohshme.	
--	---	--

DRAFT

Aneksi G: Plani i biznesit

Ky kapitull paraqet kuadrin e përgjithshëm ekonomik për zbatimin e zgjidhjes së përzgjedhur për Spaçin, në formën e një plani biznesi pesëvjeçar.

Në paragrafët e mëposhtëm paraqiten:

1. Përmbledhja e planit të biznesit
2. Investimet e planifikuara për ngritjen e sitit (siti i Spaçit dhe godina e muzeut) dhe kostot e shfrytëzimit
3. Identifikimi i të ardhurave të modelit të zgjedhur të menaxhimit.

Të dhënat ekonomike të paraqitura në këtë dokument lidhen konkretisht me ndërhyrjet e parashikuara në planin e propozuar. Këto të dhëna, edhe pse të sakta, janë **parashikime** të cilat janë subjekt i luhatjeve, edhe në kushtet e situatës aktuale të pasigurisë së shkaktuar nga luftërat. Për më tepër, kostot e përgatitura nuk mund të marrin në konsideratë evolucionin e koston së jetesës dhe inflacionit, pasi ato karakterizohen nga paqëndrueshmëri në rritje.

Arritja e objektivave të përcaktuara për periudhën pesëvjeçare do të varet në një masë të madhe nga zbatimi organik i Planit: masat janë zhvilluar në mënyrë sinergjike dhe, për të siguruar efektivitetin e tyre, ato duhet të merren parasysh dhe zhvillohen brenda një kuadri të integruar që merr parasysh të gjitha lidhjet dhe ndërvaresitë.

1. Përmbledhja e planit të biznesit

Nisur nga dëshmitë që rezultojnë nga planifikimi i biznesit, mund të themi se **siti nuk do të jetë fitimprurës financiarisht**, ndaj nuk do të jetë tërheqës për investim nga partnerë privat (pasi investimi nuk është i qëndrueshëm as në afatgjatë) dhe as i vetëqëndrueshëm nëpërmjet të ardhurave, nga biletat ose nga aktivitetet dhe shërbimet e kryera në vend (shëtitje me guidë, shitje librash, tarifa për regjistrimin fotografik dhe video, ...).

Zbatimi i veprimeve të parashikuara në Planin Strategjik do të gjenerojë **4.230.800** euro kosto, krahasuar me të ardhurat potenciale tregtare prej **1.097.000** euro.

Duke marrë parasysh tre fazat e nevojshme për të arritur funksionimin e plotë të kantierit, investimi total arrin në **3.695.900** euro. Këto kryhen në tre vitet e para, dhe nga viti i katërt e në vazhdim siti ka vetëm shpenzime shfrytëzimi. Shpenzimet e shfrytëzimit do të rriten me kalimin e kohës për shkak të rritjes së numrit të personelit, aktiviteteve të ofruara dhe burimeve të nevojshme për

mirëmbajtjen parandaluese dhe konservimin dhe, rreth vitit të katërt, ato do të stabilizohen në rreth 140.000 euro në vit.

Tabela e mëposhtme paraqet kostot e parapara; rreshti i fundit paraqet një shumë kontigjence/ndjeshmërie që duhet lënë mënjanë për të përballuar shpenzimet e papritura, për shkak të gabimeve të paqëllimita në vlerësim, vonesave, faktorëve ekzogjenë që ndikojnë në aktivitetet e parashikuara.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Total
Investimet	2.321.900 €	944.000 €	430.000 €			3.695.900 €
Kosto operacionale	72.300 €	89.000 €	90.100 €	141.200 €	142.300 €	534.900 €
Total	2.394.200 €	1.033.000 €	520.100 €	141.200 €	142.300 €	4.230.800 €
Kontigjence	359.130 €	154.950 €	78.015 €	21.180 €	21.345 €	634.620 €

Për ta përmbledhur, burimet e disponueshme nga të ardhurat nga fondet, sponsorët, biletat dhe shërbimet janë paraqitur më poshtë:

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Total
Burimet nga fondet evropiane	-	-	300.000 €	300.000 €	400.000 €	1.000.000 €
Fonde nga sponsorët	5.000 €	5.000 €	5.000 €	5.000 €	5.000 €	25.000 €
Biletat dhe shërbimet	-	-	10.000 €	31.000 €	31.000 €	72.000 €
Të ardhurat total	5.000 €	5.000 €	315.000 €	336.000 €	436.000 €	1.097.000 €

Nga këto parashikime fillestare është e qartë se **as investimi e as shpenzimet e shfrytëzimit nuk mund të mbulohen nga flukset e mundshme të të ardhurave.**

Deficiti relativ duhet të mbulohet nga fondet e garancisë nga qeveria ose nga mbledhja e fondeve në nivel ndërkombëtar, siç përshkruhet më poshtë, dhe duke përfshirë nivelet e ndryshme të administratës publike, si ministritë e tjera të interesuara dhe Bashkia Mirditë, nëpërmjet marrëveshjeve që mund të ofrojë mbështetje financiare ose në natyrë. Kjo është një situatë jo e ndryshme nga ajo me të cilën përballen shumica e muzeve dhe siteve kulturore në nivel

ndërkombëtar: shumë pak prej tyre janë ekonomikisht të qëndrueshëm vetëm falë të ardhurave tregtare (të garantuara nga të ardhurat B2B ose B2C), ndërkohë që pothuajse të gjithë kanë fondet publike dhe kontributet nga tenderat si burimet kryesore të financimit të tyre.

2. Investimet e planifikuara për ngritjen e sitit (siti i Spaçit dhe godina e muzeut) dhe kostot e shfrytëzimit

Në planin e biznesit që vijon do të bëjmë dallimin midis kostove të investimit, pra të gjitha kostove të kryera vetëm një herë në fazën fillestare të jetës së institucionit të ri kulturor dhe kostove korrente, ato që lidhen me jetën e zakonshme të organizatës.

A. Afatshkurtër: Faza start-up (Viti I)

Hapja e një institucioni të ri kulturor, qoftë publik apo privat, kërkon investim: alokim afatgjatë të burimeve financiare për aktivet e luajtshme dhe të paluajtshme, në qendër të planifikimit strategjik. Plani i investimeve shërben si bazë për llogaritjen e investimeve dhe parashikimin e përfitimit ose nevojën për ndërhyrje publike për të mbështetur aktivitetin e organizatës. Ndaj, renditja e të gjitha kostove që lidhen me investimin është parakusht për vlerësimin e fizibilitetit të tij. Megjithatë, duhet theksuar se, duke filluar nga faza e fillimit, disa nga kostot e identifikuar janë shpenzime korrente dhe jo investime, pasi kanë të bëjnë me funksionimin e institucionit. Kjo zbatohet veçanërisht për kostot e stafit.

Kostot formale të fillimit përfshijnë të gjitha shpenzimet e bëra për përgatitjen e themelimit, të tilla si kostot e konsulencës dhe tarifat për regjistrimet, lejet ose aktet e noterizuara. Përveç kësaj, investimi zakonisht i referohet shpenzimeve për aktivet e luajtshme dhe të paluajtshme. Bëhet dallimi ndërmjet kapitalit fiks dhe kapitalit qarkullues. Kapitali fiks përfshin të gjitha aktivet e fituara gjatë një investimi për përdorim të përhershëm në biznes, të tilla si aktivet materiale, makineritë ose automjetet, por edhe aktivet jo-materiale si licencat dhe patentat. Aktivet si mallrat, materialet ose lëndët e para, të cilat janë të destinuara për shitje, konsum ose përpunim dhe për këtë arsye qëndrojnë në ndërmarrje vetëm për një periudhë të shkurtër kohore, janë pjesë e kapitalit qarkullues. Për këtë arsye, plani përfshin kostot për të rikthyer një pjesë të kapitalit qarkullues që do të “konsumohet” në vitet pas nisjes.

Pritet që faza start-up të zgjasë një vit, në përputhje me nevojën për të koordinuar shumë aktivitete të ndryshme, delikate dhe strategjike. Në fakt, bëhet fjalë për fillimin e konsolidimit dhe sigurimit të sitit, për përzgjedhjen e zonës për muzeun e ri dhe përsosjen e procedurave të përfshira, për ngritjen e Fondacionit, si një organ i ri, si dhe në drejtim të identifikimit të stafit dhe alokimit të hapësirës dhe burimeve për ngritjen e kapaciteteve. Investimet e planifikuara, të cilat përfshihen në kostot në tabelat e mëposhtme, kanë për qëllim:

- themelimin e subjektit që do të menaxhojë zbatimin e punimeve dhe menaxhimin operacional të sitit
- garantimin e vizitave të sigurta në sit
- të ofrojnë bazën për realizimin

Këto janë, pra, investime që do ta bëjnë institucionin e ri aktiv, funksional dhe të hapur për publikun, kushtet minimale për të kaluar në fazat e ardhshme të punës.

A. Afatshkurtër: Faza start-up	Viti I
A.1 Masat emergjente të konsolidimit dhe sigurisë	2.291.300 €
A.1.1. Kryerja e një vlerësimi të detajuar të gjendjes së sitit	200.000 €
A.1.2 Kryerja e ndërhyrjeve strukturore në pronë	1.624.600 €
A.1.3 Instalimi i elementëve të sigurisë	444.000 €
A.1.4 Përmirësimi i rrugëve hyrëse dhe krijimi i një vendi parkimi	22.700 €
A.2. Përzgjedhja e zonës për muzeun e ardhshëm	27.000 €
A.2.1 Planvendosja e pasurive të mundshme	5.000 €
A.2.2 Sqarimi i të drejtave të pronësisë dhe kostove të transferimit	22.000 €
A.3. Krijimi i fondacionit	78.900 €
A.3.1 Zhvillimi i protokollit të marrëveshjes ndërmjet anëtarëve themelues dhe themelimi	2.000 €
A.3.2 Përzgjedhja e Drejtorit dhe paga e Drejtorit	30.000 €
A.3.3 Krijimi i bordeve (Bordi i administrimit, i nderit, shkencor): Kostot e përfshira në A.3.1	-
A.3.4 Punësimi i personelit për detyrat fillestare, duke përfshirë personelin administrativ për tenderët, arkitektët për të mbikëqyrur punimet e konsolidimit dhe mirëmbajtjes	44.500 €

A.3.5 Identifikimi i vendndodhjes për zyrat operative, të cilat mund të shërbejnë gjithashtu si një zyrë e përkohshme në pritje të hapjes së muzeut (dhe qiraja)	2.400 €
A.3.6 Planifikimi i iniciativave për ngritjen e kapaciteteve Detyra e drejtorit, kostot e përfshira në A.3.2	-
Totali i fazës start-up	2.394.200 €

Investimet kryesore janë ato që lidhen me konsolidimin emergjent dhe masat e sigurisë. Kostot në lidhje me Veprimin A.1 janë llogaritur në bazë të:

- përqindjeve të alokuara në plan në lidhje me buxhetin e përgjithshëm të ndërhyrjes;
- kostot aktuale të tregut në Shqipëri për konsolidimin strukturor, ndriçimin, rrethimin, etj. për të gjashtë ndërtesat;
- kontrata të ngjashme të shpallura në Agjencinë e Prokurimit Publik në Shqipëri.

Kostot janë llogaritur si më poshtë:

Lloji i ndërhyrjes	njësitë	Kosto për njësi (€)	Totali (€)
Konsolidimi strukturor (m ³)	3.248	80 €	259.810 €
Mbrojtja e çatisë (m ²)	1.265	25 €	31.615 €
Konsolidimi i dyshemesë (m ²)	4.903	150 €	735.490 €
Sistemi i kullimit të ujërave të shiut (m ²)	1.897	30 €	56.920 €
Transporti (udhëtimi)	450	600 €	270.000 €
Shtigjet (lm)	1.500	20 €	30.000 €
Ndriçim		50.000 €	50.000 €
Rrethimi (ml)	2.000	120 €	240.000 €
Ligjore dhe sigurime		50.000 €	50.000 €
			1.723.835 €
TVSH 20%			344.767 €
TOTALI			2.068.602 €

Për kostot e Masës A.2 u mor në konsideratë koha e punës së stafit të Ministrisë së Kulturës dhe konsulentëve të mundshëm dhe çmimet e një blerjeje të mundshme të tokës. Të dhënat zyrtare të çmimit mesatar për metër katror tokë në Bashkinë Mirditë në nëntor 2023 janë 2430 lekë/m² ose 22.5 euro. Të dhënat nga tregu privat i pasurive të paluajtshme janë 50 euro për m².

Përfundimisht, për themelimin e Fondacionit, u morën parasysh si kostot e investimit (kostot e personelit të Ministrisë, këshillimi ligjor, procedura e përzgjedhjes) dhe kostot e përsëritura që lidhen me stafin e muzeut që tashmë punon në këtë fazë të parë ("kostot operative"). Duke qenë se nuk ka një fond minimal të kërkuar për fondacionet e sapokrijuara në Shqipëri, ky investim nuk u mor në konsideratë.

Kostoja totale e fazës start-up është 2.394.200 euro, e përbërë nga 2.321.900 euro investim dhe 72.300 euro shpenzime rrjedhëse, e llogaritur duke pasur parasysh drejtorin, 2 specialistë dhe një sekretare. Më poshtë është një tabelë e kostove vjetore për profesionist, bazuar në koston aktuale (paga dhe sigurimet shoqërore) të stafit të muzeut në Shqipëri.

Pozicioni	Paga vjetore (€)
Drejtori	27.800 €
Specialist	16.700 €
sekretar, arkiva, ...	11.100 €

B. Afatmesëm: Faza e zhvillimit (Viti 2 dhe 3)

Nevoja për investime nuk përfundon me fazën start-up. Në fakt, në bazë të propozimit të vlerësimit dhe menaxhimit, janë të nevojshme disa ndërhyrje për ta bërë sitin plotësisht të dukshëm dhe të përdorshëm:

- Ndërhyrja për të përmirësuar mjediset dhe mjetet e interpretimit dhe përvojën e vizitorëve në Spaç: pasi siti të jetë i sigurt, është e nevojshme të zbatohen të gjitha mjetet që lejojnë të kuptohet dhe përdoret.
- Projektimi dhe zhvillimi i muzeut: si një vend i mëtejshëm i dedikuar për të kuptuar sitin dhe periudhën historike të cilës i referohet.
- Ngritja e kapaciteteve për të gjithë aktorët e përfshirë: për të rritur efektivitetin e masave të marra.

B. Afatmesëm: Faza e zhvillimit	Viti 2	Viti 3	Total
B.1. Interpretimi dhe përvoja e vizitorëve në Spaç	137.000 €	70.000 €	207.000 €
B.1.1 Kryerja e tenderit ndërkombëtar	7.000 €		7.000 €
B.1.2 Përzgjedhja e projektit përmes procesit konsultativ (kostot e stafit)	-	-	-
B.1.3 Vendosija e mjeteve informuese në sit	40.000 €	40.000 €	80.000 €
B.1.4 Rikrijimi i hapësirave/elementeve kyç	90.000 €		90.000 €
B.1.5 Krijimi i udhëzuesve audio dhe aplikacioni i realitetit të shtuar		30.000 €	30.000 €
B.2 Projektimi dhe zhvillimi i Muzeut	866.000 €	390.100 €	1.256.100 €
B.2.1 Kryerja e tenderit ndërkombëtar	7.000 €		7.000 €
B.2.2 Përzgjedhja e projektit përmes procesit konsultativ (kostot e stafit)	-	-	-
B.2.3 Ndërhjert infrastrukture	600.000 €		600.000 €
B.2.4 Zhvillimi i koleksionit të Muzeut	100.000 €	300.000 €	400.000 €
B.2.5 Punësimi i stafit shtesë (me kostot totale)	89.000 €	90.100 €	179.100 €
B.2.6 Zhvillimi i strategjisë së detajuar të muzeut, në koherencë me Planin e Menaxhimit	70.000 €		70.000 €
B.3. Ngritja e kapaciteteve	30.000 €	60.000 €	90.000 €
B.3.1 Aktivitete për ngritjen e kapaciteteve për stafin e Fondacionit	30.000 €		30.000 €
B.3.2 Aktivitete për ngritjen e kapaciteteve për stafin lokal të angazhuar në shërbimet për vizitorët, aktivitetet edukative dhe ngjarjet kulturore		30.000 €	30.000 €
B.3.3 Aktivitete për ngritjen e kapaciteteve për subjektet turistike vendase		30.000 €	30.000 €
Totali i fazës së zhvillimit	1.033.000 €	520.100 €	1.553.100 €

Për sa i përket zbatimit të instrumenteve të interpretimit dhe përvojës së vizitorëve, disa nga kostot janë kostot e punës së stafit dhe këshillimeve të jashtme ligjore. Nga ana tjetër, kostot e infrastrukturës dhe pajisjeve llogariten në bazë të kostove të kryera ndërkombëtarisht për objektet që mund të jenë të ngjashme me ato të kërkuara për sitin.

Gjithashtu, ka kosto që lidhen me ndërtesën e re të muzeut, duke supozuar se kemi një muze prej rreth 750 m² dhe një kosto aktuale ndërtimi në Shqipëri prej 800 €/m², dhe zhvillimin e koleksionit. Kjo e fundit është llogaritur mbi bazën e zhvillimit të koleksioneve muzeale si Muzeu Marubi dhe Muzeu Shtëpia e Gjethëve, të cilat janë ende në zhvillim e sipër. Mirëmbajtja vjetore (në Vitin e 3-të, 8.000 € në vit) është kostoja mesatare e mirëmbajtjes për muze të ngjashëm.

Përfundimisht, kostot e personelit lidhen me punësimin e 1 drejtori dhe 3 specialistëve dhe një sekretareje, me paga që korrespondojnë me pagën dhe sigurimet shoqërore sipas këtyre pozicioneve në Shqipëri, nga viti në vit, rritje page e llogaritur nga vjetërsia, + 1.2%. (e njëjta gjë në vitet e ardhshme).

Faza e zhvillimit, e cila do të zgjasë dy vjet dhe do ta sjellë sitin në funksionim të plotë, do të kërkojë një investim të mëtejshëm prej 1,374,000 € dhe kosto operative prej 179,100 €, për një total prej 1,553,100 €.

C. Afatgjatë: Faza e shfrytëzimit (Viti 4 dhe 5)

Në terma afatgjatë, të gjitha kostot që lidhen me funksionimin e sitit marrin parasysh:

- mirëmbajtjen dhe konservimin parandalues të zonës, e cila kërkon një buxhet specifik çdo vit, të llogaritur në bazë të standardeve dhe kostove ndërkombëtare në Shqipëri;
- organizimi i disa shërbimeve që lidhen me vizitën dhe krijimi i rrjeteve bashkëpunuese për projekte dhe programe për përmirësimin e sitit. Ndër shërbimet, shërbimi i transportit fillon nga viti i katërt, por mund të afrohet në vitin e dytë nëse ka rritje të numrit të vizitorëve falë aktivitetit të komunikimit.

Për sa i përket stafit, në kuadër të strukturës së propozuar të menaxhimit, funksionet e mëposhtme konsiderohen të mbuluara:

- Menaxhimi shkencor: përgjegjës për koordinimin e kontributeve shkencore për Spaçin, ndërtimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, ...
- Menaxhimi: përgjegjës për zbatimin e strategjisë së biznesit të kompleksit, raportimin direkt te pronari, koordinimin e punës në fusha të ndryshme.
- Edukimi dhe aktivitetet: përgjegjëse për konceptimin dhe organizimin e aktiviteteve edukative, tureve me guidë dhe aktiviteteve të mbajtura në kompleks
- Komunikimi: menaxhon komunikimin dhe është përgjegjës për marrëdhëniet e jashtme dhe shtypin

- Librari dhe dyqan dhuratash: menaxhon shërbimet
- Stafi pritës

Duke pasur parasysh strukturën e përgjithshme të muzeut dhe audiencën e synuar (shih më poshtë), specialistë individualë mund të kryejnë më shumë se një funksion dhe disa funksione madje mund të kontraktohen në baza afatgjata (p.sh. me organizatat e përfshira në programe arsimore ose ture me guidë).

Gjithashtu këshillohet të negociohet me Bashkinë Mirditë financimi në natyrë, sipas marrëveshjes së parashikuar të bashkëpunimit, të disa funksioneve dhe në veçanti: shërbimi i pastrimit dhe kopshtarisë, shërbimi i mbikëqyrjes ditën dhe natën, prodhimi i materialeve të komunikimit, prodhimi i materialeve botuese.

Ky simulim u bazua në kostot e vendndodhjeve/institucioneve të ngjashme për sa i përket strukturës dhe aktivitetit, që operojnë në Shqipëri dhe duke marrë parasysh

- nevojën për të qenë atraktiv për sa i përket pagave për punonjësit (duke marrë parasysh vendndodhjen shumë të decentralizuar të objektit)
- rritjen e mundshme të stafit me kalimin e kohës, veçanërisht atyre të caktuar në laboratorë dhe aktivitete mësimore
- nevojën, ndër vite, për të ndërhyrë në nivelin e shpenzimeve afatshkurtra (materiale) dhe të mirëmbajtjes së strukturës muzeale.

C. Afatgjatë: Faza operacionale	Viti 4	Viti 5	Total
C.1. Mirëmbajtja dhe aksesueshmëria e zonës muzeale	34.000 €	34.000 €	68.000 €
C.1.1 Mirëmbajtja e Zonës	15.000 €	15.000 €	30.000 €
C.1.2 Ndërhyrjet konservuese parandaluese	15.000 €	15.000 €	30.000 €
C.1.3 Krijimi i bashkëpunimeve me administratën vendore dhe kompaninë minerare për aksesueshmërinë e zonës	- €	- €	-
C.1.4 Organizimi i transportit për në Sit	4.000 €	4.000 €	8.000 €
C.2. Programet edukative	10.000 €	10.000 €	20.000 €
C.2.1 Workshope në terren dhe aktivitete përgatitore online	2.000 €	2.000 €	4.000 €
C.2.1 Program i dedikuar për mësuesit	2.000 €	2.000 €	4.000 €
C.2.3 Vizita me guidë	3.000 €	3.000 €	6.000 €

C.2.4 Takime rastësore me ish të burgosur	3.000 €	3.000 €	6.000 €
C.3. Bashkëpunim me aktorë të tjerë vendas	6.000 €	6.000 €	12.000 €
C.3.1 Aktivitete promovuese të iniciuara nga aktorët vendas	2.000 €	2.000 €	4.000 €
C.3.2 Zhvillimi i ekspozitave të përbashkëta midis Spaçit dhe muzeumeve të tjera dhe zonave muzeale	3.000 €	3.000 €	6.000 €
C.3.3 Organizimi i eventeve dhe nismave publike	1.000 €	1.000 €	2.000 €
Paga dhe sigurime shoqërore	91.200 €	92.300 €	183.500 €
Totali i fazës së shfrytëzimit	141.200 €	142.300 €	283.500 €

D. Aspekte përfundimtare mbi kostot e investimit dhe të shfrytëzimit

Duke marrë parasysh tre fazat e nevojshme për të arritur funksionimin e plotë të kantierit, investimi total arrin në **3.695.900** euro. Këto kryhen në tre vitet e para, dhe nga viti i katërt e në vazhdim siti ka vetëm shpenzime shfrytëzimi. Shpenzimet e shfrytëzimit do të rriten me kalimin e kohës për shkak të rritjes së numrit të personelit, aktiviteteve të ofruara dhe burimeve të nevojshme për mirëmbajtjen parandaluese dhe konservimin dhe, rreth vitit të katërt, ato do të stabilizohen në rreth 140.000 euro.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Total
Investimet	2.321.900 €	944.000 €	430.000 €			3.695.900 €
Kosto operacionale	72.300 €	89.000 €	90.100 €	141.200 €	142.300 €	534.900 €
Total	2.394.200 €	1.033.000 €	520.100 €	141.200 €	142.300 €	4.230.800 €

Për ta përmbledhur, investimi dhe kostot e funksionimit mund të ripërfundojnë në zonën në shqyrtim (Vendi i kujtesës ose Muzeu) si më poshtë:

	Investimet			Kosto operacionale		
	Siti	Muzeu	të dy vendet	Siti	Muzeu	Both
A. Afatshkurtër: Faza e fillimit	2.291.300 €	27.000 €	78.900 €			
B. Afatmesëm: Faza e zhvillimit	207.000 €	1.256.100 €	90.000 €			
C. Afatgjatë: Faza operative				68.000 €		215.500 €
Total	2.498.300 €	1.283.100 €	168.900 €	68.000 €	0 €	215.000 €

3. Identifikimi i të ardhurave të modelit të zgjedhur të menaxhimit

Duke pasur parasysh kostot e investimit dhe shfrytëzimit, është e nevojshme të kuptohet se cilat të ardhura mund të ndihmojnë në mbulimin e kostove. Zërat kryesorë të të ardhurave mund të identifikohen si më poshtë:

1. burimet nga buxheti i shtetit të transferuara në mjetin e menaxhimit
2. burime financiare ose në natyrë nga buxheti vendor i Bashkisë Mirditë
3. Fondet evropiane
4. Fonde nga ambasadat e shteteve të huaja në Shqipëri
5. Fonde nga sponsorët
6. Të ardhura nga biletat dhe aktivitetet.

Për secilin prej këtyre zërave mund të bëhen simulime për të përcaktuar se cilat duhet të jenë kontributet e organeve publike për të balancuar buxhetin, nëse është e nevojshme.

Burimet nga fondet evropiane mund të vijnë nga: projekte të prezantuara nga Ministria e Kulturës, projekte të prezantuara nga Bashkia Mirditë dhe projekte të prezantuara drejtpërdrejt nga Fondacioni. Për të përcaktuar se cila mund të jetë pesha e këtyre fondeve në buxhet, duhet të merret parasysh: mundësia e mbulimit vetëm pjesërisht të kostove të strukturës dhe stafit; fakti që koha e alokimit mund të jetë e gjatë, përveç nëse subjektet që janë tashmë të pranishme (Ministria e Kulturës, Bashkia Mirditë, por edhe CHwB Albania) nuk i përgjigjen thirrjeve 2023/2024 deri tani. Ndaj mund të simulohet se do të ketë të ardhura nga këta zëra nga viti 3 e në vazhdim dhe se jo më shumë se 10% e shumës së alokuar do të mbulojë shpenzimet operative. Pra, duke identifikuar një shumë totale të mundshme prej 1.000.000 euro të alokuar për projekte, rreth 30.000 euro/vit

mund të përdoren për të mbuluar kostot e strukturës, më pak se një e pesta e kostove totale operative të një viti plotësisht funksional.

Për sa i përket pjesës së mbetur të këtyre të ardhurave potenciale, një pjesë mund të përdoret për të mbuluar investimet në vitin e tretë, një pjesë duhet të përdoret për aktivitete specifike që aktualisht nuk janë ndër ato të parashikuara, por që rezultojnë nga planifikimi ekzekutiv në vitin e dytë.

Për sa i përket fondeve nga sponsorët, edhe në këtë rast është e vështirë për ta të mbulojnë shpenzimet korrente apo të personelit. Në praktikën ndërkombëtare, në fakt, sponsorët tërhiqen më shumë nga mundësia e lidhjes së burimeve të vëna në dispozicion me punimet ose ngjarjet konservuese dhe restauruese. Ndaj, vetëm një pjesë e kufizuar e mbledhjes së fondeve nga individë/firma private mund të shkojë për mbulimin e kostove strukturore. Mund të supozojmë se shuma totale e burimeve që vijnë nga sponsorët mund të jetë rreth 5.000 euro në vit ose më pak. Këto parashikime nuk marrin parasysh punën e rëndësishme që CHwB Albania mund të kryejë me Ministrinë e Kulturës për të vendosur marrëdhënie me sponsorët ndërkombëtarë të interesuar për projektin përkujtimor.

Për të kuptuar, si përfundim, se cila mund të jetë pesha e të ardhurave nga biletat, aktivitetet dhe shërbimet shtesë, fillimisht është e nevojshme të bëhet një vlerësim i vizitorëve të mundshëm.

Nga analiza para projektit mund të konstatohet se grupi i synuar i mundshëm nuk është i gjerë: një pjesë e rëndësishme e qytetarëve shprehën mungesë interesi për periudhën historike dhe historinë e Spaçit dhe aktualisht motivimet e turistëve për të vizituar Shqipërinë lidhen vetëm me detin, rërën dhe diellin, si dhe me trashëgiminë kulturore të Tiranës dhe qyteteve kryesore historike. Spaçi ndodhet në një pozicion të decentralizuar në raport me flukset aktuale turistike. Aktualisht ka një pjesë të turistëve në zonën e errët të turizmit, e cila, bazuar në takimet e zhvilluara me grupet e interesit dhe analizat e bëra, nuk është për t'u favorizuar.

Ndaj, vizitorët e mundshëm mund të ndahen në kategoritë e mëposhtme:

- Grupet e shkollave lokale/kombëtare
- Familje, grupe të organizuara lokale/kombëtare
- Grupe të organizuara të huaja, turistë kulturorë individualë

të cilët kanë interes për historinë e fundit ose ndërgjegjësim për rëndësinë e ruajtjes së kësaj trashëgimie si një paralajmërim për brezat e ardhshëm.

Duke pasur parasysh se:

- Hyrja në zonë do të jetë falas,
- Për të hyrë në muze duhet të blihet biletë e plotë për të rriturit mbi 25 vjeç (7 euro) dhe biletë e pjesshme për të rinjtë e moshës 18 deri në 25 vjeç (3 euro); hyrja për fëmijët dhe të rinjtë nën 18 vjeç dhe për ish të burgosurit do të jetë falas.
- Shkollave do t'u ofrohen workshope në terren, aktivitete përgatitore në internet, si dhe raste takimesh dhe dëshmish të drejtpërdrejta me ish të burgosurit.
- Udhëtimet me guidë në Muzeun dhe ish-burgun e Spaçit, duke përfshirë transportin deri në zonë, do të jenë kundrejt pagesës.

Të ardhurat e mundshme që lidhen me vizitorët do të jenë mjaft të ulëta.

Në vitin 2022, muzetë, kështjellat dhe parqet arkeologjike për të cilat disponohen statistika aksesi numëronin rreth 690 000 vizitorë (Instat Shqipëri). Pas muzeve me më shumë se 25 000 vizitorë, ka zona me më pak se 10 000 vizitorë/vit. Simulimi i numrit të vizitorëve në kompleks është mjaft i vështirë, për tre arsye kryesore:

- 1) nuk ka vende ngushtësisht të krahasueshme, muzetë ose vendet e tjera për të cilat disponohen të dhëna ndodhen në Tiranë ose në qytete mjaft të vizituara nga turistët,
- 2) Vendet e ngjashme ndërkombëtare, lidhen me ngjarje që përfshijnë kontinente dhe popullata të tëra, duke qenë kështu më të njohura ndërkombëtarisht dhe të lidhura ngushtë me historitë familjare të shumë njerëzve,
- 3) flukset do të varen shumë nga aktivitetet e komunikimit nga njëra anë dhe bashkëpunimi me të gjithë aktorët nga ana tjetër.

Projeksionet që rezultojnë nga të gjitha këto aspekte vlerësojnë flukset totale, pasi siti të jetë plotësisht funksional, prej përafërsisht 10.000 vizitorësh në vit. Nga këta, rreth gjysma do të jenë studentëve, pra që nuk paguajnë, rreth 20 për qind të moshës me pagesë të reduktuar ose falas. Në mënyrë optimiste, ne mund të llogarisim të ardhura totale nga shitja e biletave në një shumë rreth 31 000 euro/vit, kur janë plotësisht funksionale, të cilave mund t'i shtojmë 20 000 lekë/vit nga turet me guidë dhe libraritë (bazuar në gatishmërinë për të paguar për këto shërbime në nivel ndërkombëtar).

Për ta përmbledhur, burimet e disponueshme nga të ardhurat nga fondet, sponsorët, biletat dhe shërbimet janë paraqitur më poshtë:

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Total
Burimet nga fondet evropiane	-	-	300.000 €	300.000 €	400.000 €	1.000.000 €
Fonde nga sponsorët	5.000 €	5.000 €	5.000 €	5.000 €	5.000 €	25.000 €
Biletat dhe shërbimet	-	-	10.000 €	31.000 €	31.000 €	72.000 €
Të ardhurat total	5.000 €	5.000 €	315.000 €	336.000 €	436.000 €	1.097.000 €

Nga këto parashikime fillestare është e qartë se as investimi e as shpenzimet e shfrytëzimit nuk mund të mbulohen nga flukset e mundshme të të ardhurave. Këto aspekte bëhen më të kuptueshme kur merret parasysh natyra e kostove që mund të mbulohen nga burime të ndryshme.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Total
Investimet	2.321.900 €	944.000 €	430.000 €			3.695.900 €
Kosto operacionale	72.300 €	89.000 €	90.100 €	141.200 €	142.300 €	534.900 €
Total	2.394.200 €	1.033.000 €	520.100 €	141.200 €	142.300 €	4.230.800 €
Burimet për të mbuluar investimet	5.000 €	5.000 €	275.000 €	275.000 €	365.000 €	925.000 €
Burimet për të mbuluar kostot operative	- €	- €	40.000 €	61.000 €	71.000 €	172.000 €
Total	5.000 €	5.000 €	315.000 €	336.000 €	436.000 €	1.097.000 €
Pjesa e investimeve të mbrojtura	0.2	0.5	64.0			25.0
Pjesa e kostove operative të mbrojtura			44.4	43.2	49.9	32.2

Pjesa e kostove të mbrojtura	0.2	0.5	60.6	238.0	306.4	25.9
------------------------------	-----	-----	------	-------	-------	------

Në fakt, siç shihet, burimet e lidhura me format e ndryshme të të ardhurave mund të mbulojnë vetëm maksimumi 25% të investimeve, pa marrë parasysh asnjë fond tjetër që mund të mblidhet nga sponsorët. Për sa i përket kostove operative, të ardhurat mbulojnë pothuajse 45% të kostove të një viti tipik në terma afatgjatë. Megjithatë, të ardhurat e vizitorëve nuk do të jenë në gjendje të mbulojnë kostot operative as në terma afatgjatë, pasi ato mbulojnë më pak se një të katërtën e nevojave të sitit dhe muzeut, nëse përjashtojmë fondet nga alokimi i kontributeve që mund të përdoren për kostot operative.

Ndaj, nga pikëpamja financiare, funksionimi nuk mund të varet nga aftësia për të mbuluar kostot e investimit dhe shfrytëzimit, madje as kostot afatgjata të shfrytëzimit, dhe kërkon një kontribut nga organet publike përgjegjëse për zbatimin dhe menaxhimin e tij vijues.

Kështu, fondet që do të sigurohen nga shteti dhe administrata vendore për funksionimin e projektit kapin vlerën 2.770.900 euro për investim (përfshirë fondet që mund të disponohen për këtë qëllim në vitet pas vitit të dytë), 362.900 euro për shpenzimet operative gjatë pesë viteve (edhe pse në afat të gjatë ato do të jenë ndërmjet 70.000 dhe 110.000 euro në vit), pra gjithsej 3.133.800 euro.

Aneksi H: Analiza krahasuese.

Është kryer një analizë krahasuese e rasteve ndërkombëtare për të shqyrtuar se si vende të tjera në mbarë botën i kanë shndërruar ish-burgjet në muze, memorialë ose qendra kulturore për të ruajtur kujtesën e ngjarjeve të së kaluarës duke promovuar ndërgjegjësimin për trashëgiminë historike si një element i zhvillimit kulturor dhe social. Informacioni u mbledh përmes intervistave të thelluara me drejtorët në tre raste, si dhe përmes analizave në zyrë për 8 raste të tjera.

Tre rastet e mëposhtme ndërkombëtare do të kenë raportet e tyre të intervistave të paraqitura më poshtë:

1. Muzeu Ndërkombëtar Patarei për Viktimat e Komunizmit: intervista u zhvillua me kuratorin e muzeut Martin Andreller më 13 shtator;
2. Burgu kombëtar përkujtimor de Montluc: intervista u krye me drejtorin e tij Aurélie Dessert më 14 shtator;
3. Burgu i Sighet: intervista u zhvillua me Drejtorin Ekzekutiv të Fundatja Academia Civică më 15 shtator;

Rastet e mëposhtme u shqyrtuan përmes analizimit të dokumentacionit:

4. Rivesaltes Camp Memorial, Francë;
5. La Risiera di San Sabba, Itali;
6. ESMA - Escuela Superior de Mecánica de la Armada, Argjentinë
7. Kilmainham Gaol, Irlandë;
8. Robben Island, Afrika e Jugut;
9. Auschwitz-Birkenau, Poloni;
10. Tuol Sleng Genocide Museum, Kamboxhia;
11. Hohenschönhausen Memorial, Gjermani.

I. Muzeu Ndërkombëtar Patarei për Viktimat e Komunizmit

Raport nga intervista me kuratorin Martin Andreller

Mbi procesin konsultativ

Koncepti i shndërrimit të burgut të Patareit në një muze u shfaq për herë të parë në vitin 1989. Ai vazhdoi të funksiononte si burg deri në fillim të viteve 2000, pas së cilës u la i braktisur dhe përdorej për turizëm, duke tërhequr kryesisht vizitorë të interesuar për të eksploruar rëndësinë e tij historike. Ashtu si Spaçi, edhe burgu i Patareit kishte probleme me vjedhjet, muret dhe objektet e brendshme të projektimit të cilat u vodhën në pjesën e parë të vitit 2000 kur nuk kishte aktivitete

të vazhdueshme. Në vitin 2010, nocioni i transformimit të Patareit në një vend multikulturor mori formë, me propozime që varionin nga shndërrimi i tij në një muze në një institut artesh. Megjithatë, këto ide hasën kundërshtimin nga autoritetet dhe projekti nuk u realizua. Përafërsisht shtatë vjet më parë, diskutimet në lidhje me këtë sit, morën një vrull të ri dhe në fund, autoritetet qendrore morën vendimin që ai të shndërrohej në një muze. Ky muze nuk do të fokusohej vetëm në historinë e Estonisë, por do të përfshinte edhe historinë ndërkombëtare të pushtimit komunist. U bënë konsultime me muze të tjerë dhe institute të kujtesës në vende të tjera, Gjermani, Lituani dhe disa të tjera. Instituti Estonez i Kujtesës Historike synoi të krijonte një muze që do të tregonte historinë e shekullit të 20-të. Vetë vendi, ish-burgu, posedonte aftësinë e natyrshme për të përcjellë këtë rrëfim historik. Gjatë gjithë procesit të planifikimit u mor një vendim i qëllimshëm për të mos shtuar shumë elementë të tjerë, si p.sh. ekranet dixhitale, duke qenë se vetë mjedisi në vetvete, me organizimin e tij të mëparshëm si burg, do të ngjallte një reagim të fuqishëm emocional te vizitorët. Gjatë gjithë konsultimeve të ndërmarra me aktorë ndërkombëtarë, u mbajtën 14 prezantime nga aktorë ndërkombëtarë, duke ofruar njohuri dhe sugjerime që formësuan temat që duhet të përfshijë muzeu. Marrja e njohurive dhe perspektivave nga palët e interesuara me prejardhje dhe kontekste të ndryshme ndikoi ndjeshëm në vizionin e tyre për projektimin e muzeut. Muzeu është projektuar për të përfshirë tre shtresa të historisë: origjinën e ndërtesës si burg, historinë e Estonisë dhe historinë ndërkombëtare të pushtimit komunist. Kjo e fundit përbën një pjesë të konsiderueshme, rreth 40%, të hapësirës së ekspozitës. Për më tepër, një e katërta e muzeut të ardhshëm i kushtohet ekspozitave të përkohshme.

Mbrojtja e ndërtesës është thelbësore për të parandaluar përkeqësimin, por është e rëndësishme të pranohet se gjendja aktuale e konservimit e ruan historinë siç ka qenë. Në vend të rindërtimit të plotë, Instituti Estonez i Kujtesës Historike synon të ruajë dhe të shfaqë koleksionin me pengesa minimale mbrojtëse, duke i lejuar vizitorët të zhyten në objektet dhe rrethinat e tyre.

Mbi rolin e ish të burgosurve dhe administratës së ardhshme

Ish të burgosurit ishin deri diku të informuar për propozimet për të ardhmen e burgut të Patareit. Përderisa nuk ka një bord të veçantë këshillues, ekspertë të shumtë janë konsultuar gjatë procesit, edhe pse një bord formal shkencor nuk është krijuar. Instituti Estonez i Kujtesës Historike mban përgjegjësinë për krijimin e muzeut. Ata planifikojnë të krijojnë një subjekt juridik të veçantë për të menaxhuar muzeun, potencialisht në formën e një fondacioni bashkëpunues që përfshin Ministrinë e Drejtësisë, megjithëse Ministria e Drejtësisë nuk kërkon të marrë pronësinë e muzeut.

Mbi krijimin e muzeut

Rrugëtimi drejt krijimit të muzeut filloi në maj 2017 kur qeveria mori vendimin për t'ua shitur Patarein investitorëve privatë. Procesi i shitjes ishte i ndërlikuar, pasi kërkoheshin miratime të ndryshme për shkak të statusit të Patareit si një vend i trashëgimisë natyrore. Si pjesë e marrëveshjes, investitori privat u angazhua për t'i dorëzuar qeverisë pjesën e muzeut me punën e përfunduar të ndërtimit. Megjithatë investitori privat është përgjegjës për shpenzimet e restaurimit, ata nuk kanë autoritetin përfundimtar mbi vendimet që lidhen me muzeun. Gjatë dekadës së ardhshme, shteti do të marrë me qira pjesën e muzeut nga investitori privat, duke kryer pagesat përkatëse.

2. Burgu kombëtar përkujtimor de Montluc

Raport nga intervista me Drejtoreshën Aurélie Dessert

Mbi krijimin e muzeut

